

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

25 QERSHOR 2017

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

KOALICIONI I VEZHguesve VENDORE

RRETH KVV

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) është një aleancë organizatash jo-qeveritare dhe jo-politike, thelbi i aktivitetit të të cilave është zhvillimi i demokracisë në Shqipëri dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, e veçanërisht monitorimi i proceseve zgjedhore. Prej fillimit të funksionimit, në vitin 2005, rrjeti i organizatave përbërëse të tij është zgjeruar në disa dhjetra pjesëmarrës.

KVV e konsideron monitorimin e proceseve zgjedhore nga grupimet qytetare si instrumentin më të përshtatshëm që ndihmon në sigurimin e transparencës, integritetit dhe besueshmërisë së zgjedhjeve. KVV mbështet me forcë bindjen se përfshirja e kapaciteteve vendase në ndjekje të proceseve ndihmon më shumë se vetë mbarëvajtjen e zgjedhjeve. Faktorizimi i kapaciteteve civile vendase në vëzhgimin e proceseve, ndër të tjera, shërbën si një ndihmesë më shumë në sigurimin e llogaridhënies së zyrtarëve publikë ndaj qytetarëve.

Tre organizatat drejtuese të KVV-së janë Shoqata për Kulturë Demokratike, KRIIK Albania dhe Shoqata për Gratë dhe Fëmijët, si tre nga organizatat vendore me më shumë eksperiencë. Në zbatim të filozofisë së veprimit, ato shpallin aksionet e rradhës në varësi të procesit zgjedhor apo atij institucional. Ftesë kjo për çdo organizatë joqeveritare e interesuar të bëhet pjesë e aksionit, duke rivlerësuar kështu në mënyrë periodike, të hapur dhe transparente vlerat më të mira të funksionimit si rrjet.

Boshti i vlerave të këtij ndërveprimi janë pavarësia, objektiviteti, ekspertiza dhe bashkëpunimi mes organizatave të shoqërisë civile. Ndërsa veprimtaria e Koalicionit në aksionin monitorues zgjedhor drejtohet nga “Deklarata Globale e Parimeve për Vëzhgimin dhe Monitorimin Jo-Partizan të Zgjedhjeve nga Organizatat Qytetare” dhe sjellja e vëzhguesve të tij bazohet në “Kodin e Sjelljes për Vëzhguesit Qytetarë Jo-Partizanë”.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

**ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË
25 QERSHOR 2017**

Nëntor 2016 – Korrik 2017

**AKSIONI I VËZHGIMIT PËR ZGJEDHJET PËR
KUVENDIN E SHQIPËRISË TË 25 QERSHORIT 2017**

u realizua nga:



KOALICIONI I VËZHguesve VENDORË

© KOALICIONI I VËZHguesVE VENDORË

Të drejtat e botimit të këtij Dokumenti janë të rezervuara.

Pjesë të këtij materiali mund të përdoren lirisht, në një rast të tillë lutemi citoni burimin



Ky Raport u bë i mundur falë mbështetjes bujare të popullit amerikan, nëpërmjet Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), me mbështetje teknike nga Democracy International (DI)

Përmbajtja e këtij Raporti është përgjegjësi vetëm e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara

PËRMBAJTJA

Hyrje e dokumentit	9
I. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE DHE VLERËSIMI	11
II. SITUATA POLITIKE	16
A. Situata konfliktuale pas amendimeve kushtetuese	16
B. Arritja e dakordësisë politike mazhorancë-minorancë parlamentare	18
III. KUADRI LIGJOR ZGJEDHOR	20
A. Administrimi zgjedhor	21
1) Sistemi elektoral shqiptar	21
2) Infrastruktura zgjedhore	21
3) Përgatitja dhe hartimi i Listës së Zgjedhësve	22
4) Aktet nënligjorë të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve	23
B. Drejtësia zgjedhore	24
1) Penalizimi i veprave që çenojnë zgjedhjet	24
2) Sistemi zgjedhor i ankimim-apelimeve	24
C. Financat e subjekteve zgjedhore	25
D. Reformimi i kuadrit ligjor zgjedhor	26
1) Reformimi i thellë dhe harmonizimi i kuadrit ligjor	26
2) Transparenca e procesit zgjedhor	26
IV. ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR	27
A. Ecuria e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve	28
1) Deformimi i kompozimit të anëtarësisë së KQZ-së	28
2) Vendimmarrja e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve	29
3) Respektimi i afateve proceduriale	29
4) Precedenti pozitiv i caktimit të mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe i zonave të administrimit zgjedhor	30
B. Ecuria e punës së Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor	31
1) Konstituimi dhe ecuria e KZAZ-ve	31
2) Transparenca në ecurinë e punës së KZAZ-ve	32
3) Infrastruktura e mundësuar nga KQZ-ja për KZAZ-të	33
C. Ecuria e punës së Komisioneve të Qendrave të Votimit	34

V. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE	35
A. Të dhëna për procesin	35
B. Njoftimi me shkrim dhe saktësimi i përbërësve zgjedhorë	36
VI. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE	37
A. Deri në arritjen e marrëveshjes së 18 Majit 2017	37
B. Pas arritjes së marrëveshjes së 18 Majit 2017	37
VII. FUSHATA ZGJEDHORE	39
A. Problematika të traditës në proceset zgjedhore	39
1) Fushata e parakohshme zgjedhore	39
2) Mungesa e platformave elektorale dhe e diskutimit mbi ofertat elektorale	40
B. Precedentë të rinj të fushatës zgjedhore	41
VIII. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE	43
A. Transparenca financiare	43
B. Mekanizmi i kontrollit	43
IX. MEDIA	44
A. Amendimet dhe mangësitë e kuadrit ligjor	44
B. Raportimet e Bordit të Monitorimit të Mediave	45
C. Përdorimi i kasetave dhe roli kritik i mediave	47
X. PROCESI I ANKIMIMEVE	48
A. Procesi i ankimeve para ditës së zgjedhjeve	49
1) Kontestime mbi afatin ligjor të regjistrimit të subjekteve zgjedhore	49
2) Përcaktimi i subjekteve zgjedhore parlamentare dhe joparlamentare	50
3) Kontestime për përcaktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve	51
4) Zëvendësimi kryesisht i anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve	52
B. Procesi i ankimeve pas ditës së zgjedhjeve	52
XI. INSTITUCIONE TË ANGAZHUARA DHE DENONCIMET	53
A. Institucionet e angazhuara në proces	53
1) Veprimtaria e grupit Task-Force	53
2) Institucione të tjera të angazhuara	54
B. Denoncimet për drejtim të votës	55

1) Mekanizmat alternativë të denoncimit	55
2) Mekanizmat ekzekutivë të hetimit	57
C. Gjetje nga vëzhgimi i qeverisjes vendore	58
1) Vendimmarrja e Këshillave Bashkiakë	58
2) Zbatueshmëria e ligjit për subjektet zgjedhore	59
XII. PJESËMARRJA E GRUPEVE SHOQËRORE NË PROCESIN ZGJEDHOR	60
A. Grupet shoqërore të marginalizuara	60
B. Pjesëmarrja e grave në procesin zgjedhor	61
XIII. VËZHguesIT PARTIAKË, VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË	62
A. Vëzhgues të akredituar nga Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve	63
B. Vëzhgues të akredituar nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor	63
XIV. DITA E ZGJEDHJEVE DHE PROCESI I NUMËRIMIT	64
A. Të dhëna mbi procesin	64
B. Gjetjet për ditën e zgjedhjeve sipas VBS-së	65
1) Konsiderata për gjetjet	66
2) Procedurat e hapjes së qendrave të votimit	67
3) Procedurat e votimit	68
4) Mbyllja e qendrave të votimit	72
C. Votimi në institucionet penitenciare	73
D. Procesi i numërimit	74
1) Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore	74
2) Aktiviteti i grupeve të numërimit të votave dhe zbatimi i procedurave të numërimit	74
3) Aktiviteti i Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor gjatë numërimit të votave	75
XV. REKOMANDIME	77
A. Rekomandime parësore	77
B. Rekomandime dytësore	78
XVI. FJALORTH	80
XVI. Shtojcë I – Gjetjet e Vëzhgimit të Bazuar Statistikisht / Statistical Based Observation (VBS/SBO)	81

SHTOJCË	81
XVII. GJETJET E VËZHGIMIT TË BAZUAR STATISTIKISHT / STATISTICAL BASED OBSERVATION (VBS/SBO)	81
1. HYRJE	82
2. METODOLOGJIA E VËZHGIMIT	82
a) Përzgjedhja e qendrave të votimit	82
b) Metodat e vëzhgimit dhe raportimit	83
c) Mënyra si janë prezantuar gjetjet	84
3. GJETJET NGA VËZHGIMI ME BAZË STATISTIKORE	85
a. Procedurat e hapjes së qendrave të votimit	86
a1) Orari i hapjes së qendrave të votimit	86
a2) Prezenca e komisionerëve të qendrave të votimit në momentin e hapjes	86
a3) Organizimi dhe infrastruktura e Qendrave të Votimit	87
a4) Respektimi i procedurave standarde gjatë hapjes së qendrave të votimit	88
a5) Materialet e nevojshme për procesin e votimit	89
a6) Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të hapjes së qendrave të votimit	90
b. Procedurat e votimit	90
b1) Persona që ndodhen në qendrën e votimit	90
b2) Organizimi dhe infrastruktura e qendrës së votimit	92
b3) Respektimi i procedurave të votimit	93
b4) Parregullsi në votim	98
b5) Situata e përgjithshme në të cilën u zhvillua votimi	100
b6) Aksesi për personat me aftësi të kufizuara në procesin e votimit	104
b7) Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të votimit	105
b8) Sjellja ndaj vëzhguesve	106
c. Mbyllja e qendrave të votimit	107
c1) Orari i mbylljes së qendrave të votimit	107
c2) Persona që ndodhen në Qendrën e Votimit gjatë procedurave të mbylljes	108
c3) Procedurat për administrimin e materialeve të votimit	108
c4) Nisja e materialeve për në KZAZ	110
c5) Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të mbylljes së qendrave të votimit	111



HYRJE E DOKUMENTIT

Raporti Përfundimtar për Zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë të 25 Qershorit 2017 është një përmbledhje e gjetjeve të konkluduara në periudhën nëntë mujore të aksionit të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV) për vëzhgimin e procesit zgjedhor. Shtirja kohore që i referohet ky dokument përfshin periudhën prej përcaktimit të numrit të mandateve parlamentare për çdo zonë zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në nëntor 2016 deri në shpalljen e rezultatit final të zgjedhjeve në korrik 2017.

Raporti Përfundimtar u parapri nga tre Raporte të Ndërmjetme, dy Deklarata Paraprake mbi Proceset e Votimit dhe të Numërimit të votave, një Qendrim Publik mbi Financat e Partive Politike dhe një Raport mbi Drejtësinë Zgjedhore¹.

Ky Raport Përfundimtar dhe raportimet paraprake përbëjnë materializimin e gjetjeve dhe të analizës së kryer në ndjekje të punës së komisioneve zgjedhore në të tri nivelet, të institucioneve të tjera përgjegjëse për procesin, si dhe të aktorëve të përfshirë në të.

Për vëzhgimin e këtij procesi zgjedhor, përfshirë Ditën e Zgjedhjeve dhe procesin e numërimit, KVV akreditoi dhe trajnoi rreth 1'900 vëzhgues, prej të cilëve angazhoi rreth 1'600 vëzhgues. Aksioni i vëzhgimit për këtë proces u mbështet nga 34 organizata në të gjithë vendin dhe u drejtua nga Komiteti Drejtues i KVV-së së bashku me njësinë koordinuese dhe të ekspertizës.

Ecuria në komisionet e të tri niveleve të administrimit zgjedhor si dhe puna e institucioneve të tjera përgjegjëse u ndoq nga 73 vëzhgues afatgjatë. Për sa u bë e mundur, u vëzhgua ecuria, mbarëvajtja dhe aspekte të financimit të fushatës zgjedhore, situata e përgjithshme politike e institucionale, si dhe sjellja e administratës shtetërore lokale e qendrore. Rëndësi të veçantë iu kushtua monitorimit të procesit të ankimeve dhe apeliave në dy nivelet e larta të administrimit si dhe në Kolegjin Zgjedhor. Ndërsa rreth 1'500 vëzhgues afatshkurtër vëzhguan Ditën e Zgjedhjeve, procesin e numërimit, aktivitetin e komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë në përgatitje të ditës së zgjedhjeve, përgjatë saj si edhe gjatë procesit të numërimit deri në plotësimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve.

Gjatë Ditës së Zgjedhjeve, KVV angazhoi vëzhgues fiks dhe të lëvizshëm, si edhe vëzhgues të veçantë që ndoqën procesin në qendrat e votimit të posaçme.

¹ "Qendrim Publik - Procesi Zgjedhor 2017 e të tjera Procese Institucionale e Politike te Lidhura me të" i publikuar me datë 07.04.2017; "Raport i Ndërmjetëm Monitorimi II" i publikuar me datë 05.06.2017; "Raport i Ndërmjetëm Monitorimi III" i publikuar me datë 23.06.2017 dhe "Raport Monitorimi mbi Drejtësinë Zgjedhore - Zgjedhjet Parlamentare 2017" i publikuar me datë 29.08.2017.

Pjesa dërrmuese e vëzhguesve afatshkurtër ishin fiks dhe vëzhguan një kampion përfaqësues të Qendrave të Votimit të përzgjedhur rastësisht, i cili garantoj përgjithësimin e gjetjeve për të gjithë vendin, me një nivel konfidence 95% dhe me një marzh gabimi deri në 4.69%².

Metodologjia e "Vëzhgimit të Bazuar Statistikisht / Statistical Based Observation" (VBS/SBO), pas përdorimit të saj në Zgjedhjet e Parlamentare të 2013-ës, u përdor në këto zgjedhje për herë të dytë nga KVV.

Për këtë proces, për herë të parë në Shqipëri, vëzhguesit e KVV-së përdorën një aplikacion për telefona celularë inteligjentë për të transmetuar të dhënat drejt Qendrës Operative, si një mënyrë më e shpejtë dhe më efektive për transmetimin e të dhënave.

Procesi zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Qershorit 2017, është procesi zgjedhor kombëtar i shtatë i ndjekur nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV)³. Gjithashtu në vëmendjen e tij kanë qenë në vazhdimësi edhe proceset reformuese të kuadrit ligjor përgjatë kësaj periudhe.

Koalicioni ka ndjekur dhe ndjek në vijueshmëri proceset zgjedhore, zhvillimet e tjera institucionale apo politike që afektojnë zhvillimin e demokracisë, liritë dhe të drejtat politike të qytetarëve apo çështjet zgjedhore, si një ndërveprim i organizatave jofitimprurëse vendase, lokale apo qendrore, të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e demokracisë dhe të të drejtave të njeriut.

2 Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë në Ditën e Zgjedhjeve vëzhgoi 541 qendra votimi në të gjithë vendin. Pas analizës dhe pastrimit të të dhënave, gjetjet u bazuan vetëm në të dhënat e 524 QV-ve. Çdo qendër votimi u vëzhgua, kryesisht nga dy vëzhgues të stacionuar në atë qendër votimi, me turne prej 7 orësh secili. Vëzhguesit ndoqën dhe vlerësuan procesin e hapjes së qendrave të votimit, ecurinë e procesit të votimit dhe procesin e mbylljes së qendrave të votimit. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore dhe procesi i numërimit të votave u mbulua në të gjitha vendet e numërimit të votave në të gjithë vendin.

3 Organizatat përbërëse të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV), përveç organizatave themeluese dhe njëkohësisht anëtare të Komitetit Drejtues të KVV-së: Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD), Shoqata KRIIK Albania dhe Shoqata për Gratë dhe Fëmijët (SHPGF), si pjesë e Aksionit të Vëzhgimit të këtij Procesi Zgjedhor për Zgjedhjet e 25 Qershorit 2017 në renditje alfabetike ishin: ¹ Fondacioni i Personave me Aftësi të kufizuara në Shqipëri (ADRF) – Tiranë; ² Qendra "Unë Gruaja" – Pogradec; ³ Qendra "Forumi i Gruas Elbasan" – Elbasan; ⁴ Qendra "Gruaja në Zhvillim" – Tiranë; ⁵ Qendra "Lëvizja Rinore për Demokraci" – Pukë; ⁶ Qendra "Ligji, Biznesi dhe Gruaja Rurale" – Tiranë; ⁷ Qendra "Parlamenti Rinor Lezhë" – Lezhë; ⁸ Qendra "Platforma Kombëtare për Gratë" – Fier; ⁹ Qendra "Të Drejtat e Njeriut në Demokraci" – Tiranë; ¹⁰ Qendra e Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale Kukës – Kukës; ¹¹ Qendra Gruaja në Zhvillim – Korçë; ¹² Qendra Këshillimore për Njerëzit me Aftësi të Kufizuara – Shkodër; ¹³ Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Durrës; ¹⁴ Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – Korçë; ¹⁵ Qendra Rajonale "Syri i Medias së Re" – Gjirokastrë; ¹⁶ Qendra Rinore Vlorë (QRV) – Vlorë; ¹⁷ Qendra e Botimeve Bujqësore – Tiranë; ¹⁸ Qendra Shqiptare "YMCA Tirana" – Tiranë; ¹⁹ Qendra Shqiptare e Ambientit – Tiranë; ²⁰ Shoqata "Qëndistaret" – Korçë; ²¹ Shoqata "Për Mbrojtjen e të drejtave të gruas Fshatare dhe Qytetare" – Berat; ²² Shoqata "Argitra" – Dibër; ²³ Shoqata "Gruaja drejt së Ardhmes" – Durrës; ²⁴ Shoqata "Gruaja në Media" – Tiranë; ²⁵ Shoqata "Gruaja në Zhvillim" – Shkodër; ²⁶ Shoqata "Në dobi të Gruas Shqiptare" – Tiranë; ²⁷ Shoqata "Njerëzit të parët" – Fier; ²⁸ Shoqata "Për Gratë dhe Fëmijët" – Lushnjë; ²⁹ Shoqata e "Grave me probleme Sociale" – Durrës; ³⁰ Shoqata për Kulturë Demokratike (SHKD) – Elbasan dhe ³¹ Sindikata e Pavarur e Punonjësve te Tipografisë – Tiranë;

I. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE DHE VLERËSIMI

Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të 25 Qershorit 2017 përbënë procesin e 18-të zgjedhor në vend pas rënies së regjimit komunist, për Legjislaturën e IX-të Parlamentare.

Ndonëse një shoqëri me aspirata të forta drejt integritimit europian, Shqipëria prej gati tre dekadash vazhdon të përballet me sfida madhore apo bazike përsa i përket zbatimit të ligjit, ndërtimit të institucioneve të pavarura, apo luftës ndaj korrupsionit sistematik. Këto fenomene, në kontekstin e një shoqërie me të tërë sferat e saj të nënshtuara ndaj motorit politik dhe me nivele jo të dëshirueshme të cilësisë së jetesës dhe të mirëqenies qytetare, ulin entuziasmin dhe përkrahjen e qytetarëve ndaj projektit shtetformues demokratik.

Në këtë rrjedhë, procesi zgjedhor i 25 Qershorit mbarti edhe njëherë karakteristikat e një demokracie ende në tranzicion, të një përpjekje shtetformuese me sfida thelbësore ligjzbatuese dhe të një klase politike të mbyllur në kundërvënien e lidërshipeve politike.

Klima e tensionit politik, pasiguria institucionale, mangësitë në instrumenta ligjorë për t'u përfshirë përmbajtësisht në ofertat elektorale dhe për t'u mbrojtur nga presioni politik apo intimidimet, ishin edhe njëherë shenjat dalluese të këtij procesi zgjedhor.

Ky proces zgjedhor ndonëse çënoi shumë hapa proceduralë të rregullimeve ligjore, gëzoi një mbarëvajtje të qetë në raport me rendin publik dhe lejimin e qytetarëve për të votuar.

Megjithatë diskutimi i munguar publik mbi ofertat politike, kundërvënia e ashpër e liderëve politikë, mungesa e transparencës për veprimtaritë financiare të subjekteve dhe evidentimi i rasteve të dyshimta të drejtimit të votës, provuan për një mungesë të vullnetit dhe të kapaciteteve institucionale për të zhvilluar zgjedhje demokratike larg agjendave politike.

Procesi zgjedhor i 25 Qershorit për zgjedhjen e përfaqësuesve të rinj parlamentarë shenjoi një përvojë demokratike të cënuar, me pjesëmarrje të lirë dhe jo vetëvendosëse të qytetarëve.

Në përmbledhje të një ndjekje permanente të përgatitjeve zgjedhore përgjatë ecurisë së tyre, të paraprirra nga monitorimi i ecurive të tjera institucionale të lidhura ngushtë me çështjet zgjedhore, vëzhgimit të mbarëvajtjes së Ditës së Zgjedhjeve dhe të procesit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë vërejtë si më poshtë:

- Konfliktualiteti i lartë i lidhësive politike, pas arritjes së dakortësisë për ndryshimet Kushtetuese të muajit korrik 2016 dhe deri në dakortësinë e Marrëveshjes Politike të 18 Majit 2017, përcollën një klimë pasigurie tek qytetarët për ecurinë institucionale deri në cënimin e rendit publik.

Kjo klimë politike e parakushtëzoi tërë mbarëvajtjen e procesit zgjedhor si proces për t'u tejkaluar larg ngërçeve politiko-institucionale dhe jo si momenti më i rëndësishëm i manifestimit të vullnetit qytetar.

- Nisja flagrante e fushatës parazgjedhore, si nga angazhimi i hapur elektoral i Këshillit të Ministrave dhe mesazhet me efekte elektorale të protestës permanente tre mujore të opozitës politike, ndihmuan në krijimin e klimës kritike institucionale dhe të tensionuar qytetare.

Fushata zgjedhore e parakohëshme bëri *nul* të gjitha rregullimet ligjore që sigurojnë mbarëvajtjen e mbulimit mediatik, të veprimtarisë financiare të subjekteve, apo mbi administratën publike.

- Marrëveshja Politike e 18 Majit, përpos vullnetit dakortësues pozitiv, ishte një shfaqje e një klase politike që për një vit nuk arriti të shfrytëzonte kanalet institucionale si Komisioni i Posaçëm i Reformës Zgjedhore dhe të manifestonte maturi në gjetjen e dakortësisë pa arritur në tejkalim të çdo limiti ligjor dhe në rrethana serioze pranë një krize të rëndë.

Edhe gjetja e dakortësisë ndërmjet dy lidervë politikë, në traditën e marrëveshjeve *in extremis* të politikës shqiptare ishte “pas dyerve të mbyllura”, në mungesë tërësore transparence dhe e paqartë në terma kohorë apo në zotime konkrete.

- Ndryshimet e kuadrit ligjor me amendimin e tre akteve ligjore, si rezultat i Marrëveshjes Politike, u kryen pa asnjë argumentim publik dhe, përsa mund të lejonte kuadri kohor, jo në adresim të problematikave të evidentuara në vijueshmëri.

Vlerësohet se këto ndryshime ishin gati tërësisht jo efikasë në rregullimet që ndërmorën për këtë proces zgjedhor. Veçanërisht amendimi i “Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, në rëndimin e penaliteteve për veprat që çenojnë integritetin e zgjedhjeve, ofroi një qasje të gabuar ligjzbatuese dhe me premisa për efekt të kundërt.

- Ngritja e Grupit të Punës Ndërmintor Task-Force vlerësohet si një manifestim i një shembulli tejet pozitiv në frymën e ndërveprimit institucional jo vetëm në raport me procesin zgjedhor.

Vlerësohet se për shkak se funksionet e Grupit Task-Force ishin një klonim ligjor i detyrave funksionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kuadri kohor më shumë se i pamjaftueshëm për të qenë efektiv, mungesa e instrumentave realë ligjorë dhe mosbashkëpunimi i treguar nga administrata publike ndaj kësaj trupe, vendosën se ndërmarrja në fjalë përpos shembullit të mirë nuk arriti të ishte garante në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

▪ Zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si rezultat i Marrëveshjes Politike, zhvleftësoi tërë ndërmarrjet ligjore dhe institucionale të nisura që prej miratimit të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” të vitit 2008.

Ky precedent kaparosi dy standarte anti-ligjore të imponuara nga klasa politike, si administrimi politik, jo institucional dhe jo i pavarur i proceseve zgjedhore dhe të “çertifikimit” të integritetit të këtyre proceseve nga lidershipe politike.

▪ Zhvendosja pa asnjë rregullim ligjor e datës së zgjedhjeve dhe afateve të tjera si për regjistrimin e subjekteve zgjedhore apo të depozitimit të anëtarëve të komisioneve zonale, vendosën në *stres-test* tërë administrimin zgjedhor në periudhën e tij me delikate dhe veçanërisht punën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kjo sjellje e shndërroi në një standart vështirësisht të korrektueshëm në vijueshmëri, të precedentëve të deri tanishëm të mosrespektimit të afateve proceduralë.

▪ Periudha ligjore për zhvillimin e fushatës zgjedhore ishte vizualisht jo e ngarkuar në promocionin elektoral urban dhe në publicitetin mediatik, për shkak të rregullimit të ri ligjor kufizues vetëm në afërsi të zyrave zgjedhore dhe ndalues për reklamën e paguar në operatorët e shërbimit mediatike.

Megjithatë nga raportimet e vëzhguesve afatgjatë u vërejt një fushatë zgjedhore e decentralizuar në nivel baze, tejet intensive dhe me shenja të kontrollit të votës.

▪ Përcaktimi i detyrimit ligjor për regjistrimin e ambienteve të zyrave zgjedhore pranë Bashkive, ndonëse me mangësi rregulluese, shërbeu për të evidentuar numrin e lartë të këtyre organizimeve lokale dhe në përlllogaritjen e kostove financiare që përmbajnë. Ndonëse në shumë raste, subjektet zgjedhore nuk i regjistruan zyrat e tyre zgjedhore, vëzhguesit raportuan një numër të lartë të tyre.

Ky numër i lartë zyrash, fushata tepër intensive derë më derë, dhe përdorimi i listave të zgjedhësve nga subjektet zgjedhore, në kontekstin shqiptar, evidentojnë shenja të drejtimit dhe kontrollit të votës.

▪ Ndonëse disafish më e shtrirë në kohë se rregullimi ligjor, fushatës zgjedhore ose i munguan platformat elektorale, ose dokumentet që reklamoinin ofertën elektorale ishin deklamativë, jo të argumentuar dhe në çdo rast nuk morën vëmendje përgjatë ecurisë elektorale.

Gjithashtu, fushata zgjedhore u lidh ngushtësisht me figurat e liderëve të subjekteve kryesore dhe kandidaturat garuese mbetën në hijen e siglave zgjedhore, duke e shndërruar përballjen elektorale në “votëbesim” ndaj Kryetarëve politikë.

▪ Kuadri ligjor që garanton transparencën e administrimit të procesit zgjedhor dhe të drejtat e vëzhguesve, kryesisht në nivelin e komisioneve zonale, u cënuan rëndë edhe në këtë proces zgjedhor.

Mospublikimi në kohë i vendimmarrjes si nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor apo mosofrimi tërësor i informacionit nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor, apo mosofrimi i informacionit të vazhdueshëm dhe në kohë nga institucionet e tjera, prekën besimin tek procesi zgjedhor.

- Procesi zgjedhor për Zgjedhjet e 25 Qershorit 2017 u shoqërua me një numër të ulët ankimesh nga subjektet zgjedhore si në nivelin administrativ ashtu edhe në nivelin gjyqësor.

Vlerësohet se numri i ulët i ankimeve nga subjektet zgjedhore reflekton humbjen e besimit të subjekteve zgjedhore, kryesisht atyre joparlamentare, në efikasitetin dhe integritetin e mekanizmit të dhënies së drejtësisë zgjedhore.

- Nga raportet e Bordit të Monitorimit të Medias rezultoi se ofruesit e shërbimit mediatik në edicionet informative nuk i respektojnë raportet kohore për mbulimin e fushatës zgjedhore të subjekteve, të përcaktuar nga kuadri ligjor zgjedhor.

Gjithashtu ofruesit e shërbimit mediatik përgjatë fushatës zgjedhore mundësuan hapësira kohore televizive të konsiderueshme për veprimtaritë elektorale të subjekteve zgjedhore, në shkelje me rregullimin ligjor.

- Në mbulim të fushatës zgjedhore dhe në debatet televizive përgjatë fushatës zgjedhore, operatorët e shërbimeve mediatike më së shumti ishin përcjellës të mesazheve elektorale, pa ofruar qasje objektive dhe kritike ndaj ofertave elektorale.

Përdorimi i materialeve audiovizuale në mbulim të veprimtarive elektorale të përgatitura prej vetë subjekteve, të transmetuara në edicionet informative, ngriti pikëpyetje për përdorimin e reklamës politike të fshehur dhe në cënimin e profesionalizmit në përcjelljen e informacionit.

- Në zbatim të detyrimeve dhe në frymën e Marrëveshjes Politike të 18 Majit, përpos mekanizmave institucionalë të denoncimit, nga Ministrinë dhe institucionet e varësisë së tyre apo nga institucione të tjera përgjegjëse u ndërmorën mundësi alternative të denoncimit qytetar ndaj rasteve të drejtimit të votës apo të përdorimit të burimeve publike në funksion të fushatës zgjedhore.

Këto mekanizma alternativë të denoncimit, duke përdorur edhe mundësitë që ofron teknologjia bashkëkohore, shënuan një numër të ulët denoncimesh dhe një numër akoma më të vogël të denoncimeve të përcjella në kanalet e institucioneve të hetimit.

- Në sjelljen e komisionerëve të nivelit të dytë dhe të tretë, sikurse është vërejtur edhe në proceset e mëparshme, u evidentua sërish fenomeni i orientimit të punës së komisioneve sipas dakordësisë individuale të anëtarësisë, përtej rregullimeve ligjore.

Në reflektim të Marrëveshjes Politike të 18 Majit, kjo sjellje e komisionerëve në administrimin e këtij procesi u thellua dhe pati shtrirje më të gjerë.

- Integriteti financiar i kandidatëve garues dhe burimet financiare të subjekteve zgjedhore ishin dy çështje që edhe në këtë proces zgjedhor mbartën pikëpyetje të forta në lidhje me kapjen e tyre nga interesa privatë apo të jashtëligjshëm.

Veprimtaria financiare e subjekteve zgjedhore pritet t'i nënshtrohet një mekanizmi kontrolli të ekspertëve kontabël dhe financiarë të përzgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, por i cili vlerësohet si tërësisht jo efikas në garantimin e transparencës dhe zbatimit të rregullimeve ligjore.

▪ Në përgjithësi Dita e Zgjedhjeve procedoi e qetë, me shkelje sporadike të procedurave formale të procesit, të cilat u gjykua se nuk e afektuan në mënyrë domethënëse procesin e votimit. Fotografimi i votës, votimi familjar dhe shkelja e procedurave për asistimin e zgjedhësve që kërkojnë asistencë ishin fenomene të cilët u vërejtën në një numër relativisht të lartë të qendrave të votimit.

Shqetësuese ishte toleranca e komisionerëve të qendrave të votimit ndaj këtyre fenomeneve, veçanërisht ndaj fotografimit të votës, në lidhje me të cilin komisionerët neglizhuan të përmbushnin të gjitha detyrimet ligjore.

▪ Propaganda elektorale apo tentativat për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve nga militantët e partive politike gjatë Ditës së Zgjedhjeve, në ambientet e brendshme ose në afërsi të qendrave të votimit, megjithëse jo një fenomen i vënë re në masë, ishte gjithashtu një fenomen shqetësues.

▪ Vështirësia, deri pamundësia në shumë qendra votimi, që zgjedhësit me aftësi të kufizuara të ushtronin të drejtën e votës mbeti një fenomen i paadresuar edhe në këto zgjedhje.

▪ Procesi i numërimit u zhvillua shpejt, në përgjithësi me qetësi, dhe në përputhje me kërkesat e Kodit Zgjedhor. Këto zgjedhje shënuan një precedent pozitiv në drejtimin e shpejtësisë së numërimit të votave, i cili përfundoi rreth 48 orë pas mbylljes së procesit të votimit.

Pavarësisht se ky proces numërimi ishte më i shkurtri në kohëzgjatje në shtatë procese zgjedhore të zhvilluar prej përcaktimit të numërimit të përqëndruar në Shqipëri, sërish u vërejtën ndërprerje të procesit të numërimit, në një numër të konsiderueshëm të VNV-ve, në të shumtën e rasteve për shkak të lodhjes së komisionerëve, dhe rifillime të numërimit jo në orën e përcaktuar.

▪ Ndërprerja e vëzhguesve politikë në mbarëvajtjen e punëve të GNV-ve vazhdoi të ishte problematike në një pjesë të konsiderueshme të vendeve të numërimit të votave.

Komunikimi me zë të lartë ndërmjet të pranishmëve, prezenca e lartë e personave të paautorizuar ose jo në VNV, ishin ndër shkaqet e rëndimit të mbarëvajtjes.

II. SITUATA POLITIKE

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Qershorit 2017 ishin procesi zgjedhor i përgjithshëm i 18-të për zgjedhjen e Legjislaturës së IX-të Parlamentare, që prej rënies së regjimit komunist.

Proceset zgjedhore në vend janë paraprirë në vazhdimësi nga atmosfera e konfliktit politik, me karakteristikat përkatëse rast pas rasti. Atmosfera e rënduar e akuzave të ndërsjellta dhe e kundërvënieve diametralisht të kundërta, kanë ushqyer kulturën e pasigurisë institucionale dhe deri tek ajo e pasigurisë së rendit publik. Gjendje kjo që dëmton në thelb frymën e proceseve zgjedhore apo të sistemeve demokratike.

Kjo traditë antidemokratike e instaluar nga klasa politike, i ka shndërruar proceset zgjedhore në një përballje forcash dhe jo në një garim platformash elektorale. Imponimi i pasigurisë, përballja agresive e forcave dhe finalizimi i proceseve me dakotësinë bipartizane për pranimin e rezultateve, ka bërë që procesi zgjedhor tek qytetarët të konsiderohet më së shumti një moment ecurie politike që duhet tejkaluar dhe jo si momentum më i lartë i vetëvendosjes së vullnetit plebishitar.

A. Situata konfliktuale pas amendimeve kushtetuese

Pas një klime dakotësie mbipartizane të sforcuar në Korrikun e vitit 2016, e cila solli miratimin me konsensus të plotë parlamentar të ndryshimeve kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, polarizimi politik u rikthye në muajin shtator të atij viti.

Përgjatë fundit të vitit 2016 dhe fillimit të vitit 2017, opozita shqiptare shprehu me forcë shqetësimin e saj në lidhje me realizimin e Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvend, të lira dhe të ndershme⁴.

Për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve, me 5 Dhjetor 2016 Presidenti i Republikës së Shqipërisë dekretoi fillimisht datën 18 Qershor 2017.

Klima e konfliktualitetit politik dhe e shqetësimit të pretenduar të forcave opozitare për manipulimin e procesit zgjedhor, kulmoi me protestën e datës 18 Shkurt 2017. Kjo protestë u ndoq nga një vendosje dhe qëndrim i vazhdueshëm i përkrahësve të forcave opozitare në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit” përpara godinës së Kryeministrisë për rreth tre muaj. Gjithashtu, protesta permanente u shoqërua me një bojkot institucional të të gjitha forcave opozitare, pjesë e të cilit ishte mospërfshirja e tyre në përgatitjet e procesit zgjedhor.

Kërkesat e forcave opozitare në mënyrë që ata të ndërprisnin bojkotin institucional dhe të bëheshin pjesë e procesit zgjedhor, nuk u materializuan në një tekst shterues. Megjithatë këto kërkesa mbështeteshin në tre çështje politike, si: garantimi i vullnetit të qytetarëve dhe ruajtja e fshehtësisë së votës, lufta ndaj narko-trafficut dhe krijimi i një qeverisje tranzitore të përbërë nga teknokratë që të merrte përgjegjësinë për zhvillimin e procesit zgjedhor.

⁴ Ky shqetësim mbështetej në pretendimin e rrezikut të manipulimeve dhe të drejtimit të votës nga mazhoranca qeverisëse. Në ligjërimitin e forcave opozitare shembulli më i fortë provues i këtij rreziku ishte mbarëvajtja e procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Pjesëshme për Kryetar të Bashkisë Dibrë të mbajtura me datë 11 Shtator 2016.

Këto tre perspektiva mbetën të paqarta formalisht në mënyrën se si kërkohej vënia e tyre në zbatim në kontekstin e gjendur. Megjithatë, ndër këto, kërkesa më kryesore për garantimin e vullnetit dhe të fshehtësisë së votës u lexua praktikisht si kërkesë për përdorimin e teknologjisë së votimit në procesin zgjedhor. Në vijimësi të qëndrimit publik të mbajtur dhe të protestës permanente të forcave opozitare, u këmbëngul prej tyre se pretendimet e ngritura ishin të panegociueshme.

Përdorimi i teknologjisë në procesin e votimit, identifikimit dhe të numërimit në procesin zgjedhor, ishte një çështje e mbartur në dialogun politik që në nisje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, i cili dështoi në punën e tij⁵. Ky Komision Parlamentar *ad-hoc* u ngrit në vazhden e zotimeve të aktorëve kryesorë politikë për një reformë të thelluar dhe integrale të kuadrit ligjor zgjedhor, si dhe ishte i dyti në llojin e tij me synim amendimin e thelluar të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” të vitit 2008.

Megjithatë, përsa u tregua nga mos investimi i palëve në thirrjen e seancave të Komisionit, mos paraqitja e alternativave të mirëargumentuara, shqyrtja në kohë e diskutimeve duke e bërë çdo amendim thelbësor të pamundur, u provua për ekzistencën një vullneti të gjithëanshëm për dështimin e punës së këtij Komisioni.

Përgjatë periudhës disa mujore së kohëzgjatjes të funksionimit të Komisionit Parlamentar përgjatë vitit 2016, falë një sensi të zakonshëm maturie të aktorëve politikë mund të ishte arritur qoftë edhe në një produkt minimal amendimi ligjor. Një situatë e tillë do të bënte të mundur shmangien e klimës disa mujore të mosbesimit përpara procesit zgjedhor, njëkohësisht do të kursente edhe stresin procedural apo politik në të cilën u vendosën institucionet e vendit.

Përpos dështimit të Reformës Zgjedhore, ngërçi politik dhe bojkoti institucional i nisur me protestën e 18 Shkurt 2017 nga forcat opozitare, për tre muaj paralizoi rrjedhën institucionale. Kjo paralizë vendosi në pikëpyetje procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Parlamentare që po përgatitej për t’u mbajtur, si dhe proceset madhore të një rëndësie të veçantë që pritej të kalonte vendi. Ajo që e forcoi edhe më klimën e pasigurisë institucionale ishte edhe ligjërimi politik i përfaqësuesve të forcave opozitare, të cilët bën pjesë të daljeve dhe prononcimeve publike edhe thirrje anti-institucionale⁶.

Tensioni politik i krijuar u ndihmua dhe nga mungesa e rigjetjes së një koalicioni parazgjedhor të forcave qeverisëse, kryesisht të Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Përfaqësues të lartë si dhe Kryetari i

⁵ Në një hark kohor 15 mujor, i mandatar 5 herë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisioni zhvilloi vetëm 5 seanca plenare, nuk miratoi një plan pune dhe nuk konkludoi në asnjë akt ligjor. Kryefjala e konfliktit ndërmjet partive fillimisht me datë 7 Maj 2017. Në vazhden e një gjuhe të dhunshme të forcave opozitare ishte edhe thirrja për organizimin e një proteste mbarëkombëtare ditën e mbajtjes së zgjedhjeve të pjesshme në qytetin e Kavajës, e cila binte në kundërshtim me legjisllacionin për tubimet. Rrethanë kjo që e shtyu Kryeministrin e vendit t’i bënte thirrje të tërhiqeshin nga garimi dy kandidatëve të vetëm garues, njëri si përfaqësues i Partisë Socialiste dhe tjetri i shoqërisë civile. Në përgjigje të kësaj thirrje publike, kandidaturat garuese depozituan dorëheqjen nga garimi në KZAZ-në përkatëse, duke e zhvendosur këtë proces zgjedhor në një datë të papërcaktuar.

⁶ Kjo klimë konfliktualiteti, kryesisht ndërmjet lidërshipeve të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, arriti të funksionalizonte edhe procesin zgjedhor të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kavajë, të parashikuara fillimisht me datë 7 Maj 2017. Në vazhden e një gjuhe të dhunshme të forcave opozitare ishte edhe thirrja për organizimin e një proteste mbarëkombëtare ditën e mbajtjes së zgjedhjeve të pjesshme në qytetin e Kavajës, e cila binte në kundërshtim me legjisllacionin për tubimet. Rrethanë kjo që e shtyu Kryeministrin e vendit t’i bënte thirrje të tërhiqeshin nga garimi dy kandidatëve të vetëm garues, njëri si përfaqësues i Partisë Socialiste dhe tjetri i shoqërisë civile. Në përgjigje të kësaj thirrje publike, kandidaturat garuese depozituan dorëheqjen nga garimi në KZAZ-në përkatëse, duke e zhvendosur këtë proces zgjedhor në një datë të papërcaktuar.

Partisë Socialiste bënë publikisht të ditur disa herë vullnetin për riafirmimin e koalicionit qeverisës. Lidërshipi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në asnjë moment nuk e refuzoi publikisht një ofertë të tillë, por e lidhi ngushtësisht riafirmimin e koalicionit qeverisës me pjesëmarrjen ose jo të forcave opozitare në zgjedhjet e qershorit. Qëndrim që solli tejkalimin e afatit ligjor për regjistrimin e mundshëm të koalicioneve zgjedhore, duke e pamundësuar kështu edhe koalicionin parazgjedhor të dy forcave PS e LSI.

B. Arritja e dakortësisë politike mazhorancë-minorancë parlamentare

Përgjatë hapave proceduralë në përgatitjen e procesit zgjedhor, të bojkotuar nga forcat opozitare, u kryen disa përpjekje për të patur një marrëveshje midis forcave politike nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësitë e huaja në vend dhe nga të dërguar të posaçëm të vendeve partnere⁷.

Përpjekja e fundit e përfaqësuesve të vendeve partnere ishte ajo e Zëvendës/Ndihmës Sekretarit të Departementit të Shtetit të SHBA-së z. Hoyt Brian Yee, përgjatë një cikli takimesh në Tiranë. Përpjekje e cila nuk ia doli në vetvete të sillte një marrëveshje të menjëhershme, por që kontribuoi në mënyrë vendimtare në formësimin e një dakortësie ndërmjet dy liderëve kryesorë të Partisë Socialiste dhe të Partisë Demokratike.

Pas takimit të dytë *tête-à-tête*, në ecurinë e negociatave ndërmjet dy liderëve politikë, në orët e para të mëngjesit të datës 18/05/2017 u njoftua publikisht arritja e dakortësisë.

Marrëveshja dakortësoi në thelbin e saj, përfundimin e bojkotit institucional dhe përfshirjen në procesin zgjedhor të forcave opozitare, mbështetur në një tërësi pikash të dakortësuar. Ndonëse nuk pati një dokument zyrtar bipartizan, konkluziv dhe me natyrë ligjore të bërë publik, mediatikisht u përcoll një dokument i hartuar në gjashtë pika⁸.

Në tërësinë e çështjeve që përbënë Marrëveshjen e 18 Majit të dy liderëve kryesorë, pesë prej elementëve kishin të bënin ngushtësisht me procesin zgjedhor. Përmendet shtyrja e datës së zgjedhjeve dhe regjistrimi si subjekte zgjedhore i partive opozitare, emërimi i disa ministrave teknikë, zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, disa ndryshime të kuadrit ligjor zgjedhor dhe ngritja e strukturës ndërministrorë në monitorimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Elementë këto, të cilët arritën të dimensiononin procesin duke vendosur kështu precedentë të rinj.

Së pari, marrëveshja politike arriti të zhvendoste në mënyrë tërësisht ekstra ligjore datën e mbajtjes së zgjedhjeve me një javë, pra me datë 25 Qershor. Gjithashtu, shtyrja e datës së mbajtjes së zgjedhjeve përfshiu

⁷ Ndër këto tentativa, si hapi i parë konkret në arritjen e dakortësisë ishte vizita dhe përpjekja për marrëveshje e datës 25/04/2017, me negociator eurodeputetin z. David McAllister. Të tëra këto përpjekje ndihmuan së bashku në nxitjen e gjuhës së dialogut dhe në afrimin e palëve në një formulë dakortësie.

⁸ Tematikat e katër gjashtë pikave, të përbëra nga nënçështje, përfshinin në vija të përgjithshme nominalisht çështjet si: 1Zgjedhjet; 2Qeveria; 3Parlamenti; 4Organet e pavarura; 5Reformat dhe 6Masa të tjera.

dhe mundësinë e partive politike të opozitës për t'u regjistruar si subjekte zgjedhore.

Sigurimi i pjesëmarrjes së forcave opozitare në zgjedhje u shoqërua edhe me çështje të tjera të dakortësuara ndërmjet mazhorancës qeverisëse dhe opozitës parlamentare. Për këtë arsye, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u mbledh në seancë të jashtëzakonshme me datë 22 maj 2017⁹.

Disa prej pikave të rendit të ditës të kësaj seance të jashtëzakonshme parlamentare ishin zëvendësimi i titullarve të lartë të gjashtë Ministrive me rol specifik në proceset zgjedhore, i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i Zëvendës Kryeministrit¹⁰.

Këto Ministri ku u krye zëvendësimi i titullarëve, në vijueshmëri të proceseve zgjedhore të mëparshme në vend janë kritikuar apo akuzuar, për përfshirje të paligjshme të titullarëve dhe drejtuesve të lartë në fushatat zgjedhore duke përdorur burimet njerëzore apo materiale të administratës. Ndaj, në bazë të marrëveshjes, edhe disa prej titullarëve të lartë në këto institucione u zëvendësuan me teknicienë të përzgjedhur nga forcat opozitare¹¹.

Në drejtim të mospërdorimit të administratës së shtetit në procesin zgjedhor, si konkluzion i Marrëveshjes ishte dhe parashikimi i ngritjes së një strukture ndërministrorë në formën e një Task-Force. Strukturë kjo e drejtuar nga Zëvendës Kryeministri teknik dhe nga disa titullarë të tjerë të lartë. Në ndihmë të punës së kësaj strukture ishte dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01/06/2017, i cili rregulloi në një masë veprimtarinë e Grupit Task-Force¹².

Klima politike përpara nisjes së fushatës zgjedhore dhe arritja e marrëveshjes politike u reflektua edhe në ecurinë e fushatës zgjedhore. Kjo e fundit u zhvillua si zgjatim i përvojave të mëparshme dhe i klimës përpara fushatës, por nuk arriti në eventualitete jashtë të zakonshmes.

9 Në seancën e jashtëzakonshme të datës 22 Maj 2017, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi amendime në kuadrin ligjor në lidhje me proceset zgjedhore. Këto amendime konsistuan në ndryshimin e Ligjit "Për Partitë Politike", Ligjin "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe "Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë". Përmbytja e këtyre amendimeve natyrisht që nuk mund të ishin bërë pjesë e një procesi të konsultimit publik, siç e kërkon kuadrin ligjor, por dhe nuk kishin marrë një vëmendje të mëparshme në diskutimin publik. Kryesisht kjo vleu për ndryshimit e kryera në Ligjin "Për Partitë Politike", që ndonëse preknin një çështje madhore si financat e subjekteve zgjedhore, nuk reflektuan asnjë ide të trajtuar apo propozuar më parë.

Në fund, në seancën e jashtëzakonshme parlamentare u miratua dhe zëvendësimi i Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pas dorëheqjes së z. Denar Biba, Kuvendi pas një thirrje 24 orëshe të vakancës miratoi z. Klement Zguri si Kryetar, më parë anëtar i KQZ-së i propozuar nga Partia Republikane. Ndërkohë në të njëjtën seancë, z. Denar Biba u emërua si anëtar i KQZ-së i propozuar nga Partia Republikane. Një figurë, e cila në vitin 2013 u propozua si anëtar nga Partia Socialiste, në vitin 2016 u përzgjedh si Kryetar i KQZ-së nga Kuvendi si kandidaturë e pavarur dhe një vit më vonë për shkak të kontekstit u miratua si anëtar i propozuar nga Partia Republikane.

10 Ministri i Shendetësisë, z. Ilir Beqja u zëvendësua me z. Arben Beqiri; Ministri i Arsimit, znj. Lindita Nikolla u zëvendësua me znj. Mirela Karabina; Ministri i Drejtësisë, z. Petrit Vasili u zëvendësua me z. Gazment Bardhi; Ministri i Punëve të Brendshme, z. Fatmir Xhafa u zëvendësua nga z. Dritan Demiro; Ministri i Financave z. Arben Ahmetaj u zëvendësua nga znj. Helga Vukaj; Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë zj. Olta Xhaçka u zëvendësua nga znj. Xhuljeta Kërtusha dhe Zv.Kryeministri z. Niko Peleshi u zëvendësua nga znj. Ledina Mandjafa.

11 Pas emërimit të 6 ministrave të rinj nga Kuvendi i Republikës, gjithashtu edhe 5 titullarë të lartë në pozicione të rëndësishme të administratës u zëvendësuan me individë teknicienë të përzgjedhur nga forcat opozitare. Në fakt, këta funksionarë u emëruan për një periudhë tejet të shkurtër, duke mos patur mundësi kohore për të qenë efikasë dhe përcaktues në detyrat e tyre.

12 Vendimi Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01/06/2017, "Për marrjen e masave dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017", abrogoi Urdhrin e Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë Nr. 65, datë 12/05/2017, "Për marrjen e masave për ndalimin e vënies në përdorim nga subjektet zgjedhore të mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme pronë e administratës publike, si dhe të burimeve njerëzore të institucioneve të administratës publike të çdo niveli, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 18 qershor 2017".

Më tipikja e fushatës zgjedhore ishte dakortësia e fshehtë e “mos sulmimit” ndërmjet Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste. Dakortësi që e zhvendosi gravitetin e përballjes në fushatën zgjedhore për Zgjedhjet e 25 Qershorit, ndërmjet dyshes së partive të mëdha parlamentare tradicionale PD-PS dhe në anën tjetër të dy partive të vogla parlamentare PDIU-LSI.

Këto dy të fundit, të krijuara më vonë në përvojën e demokracisë shqiptare, në sajë të numrit të mandateve parlamentare të zotëruara kanë patur peshë përcaktuese në vendimmarrjen politike. Si të tilla, ato u vendosën në objektin e akuzave të dy partive tradicionale si subjekte përfituese të bashkëqeverisjeve, por pa marrë përsipër kostot e tyre. Madje vijueshmëria e akuzave të ndërsjellta risolli në ligjërimet elektorale akuza për përfshirje në narko-trafik, afëra korruptive, shpërdorim të burimeve publike, e të tjera akuza të renda.

Me publikimin e rezultateve paraprake të votimit dhe më pas me shpalljen e rezultatit përfundimtar¹³, subjekti Partia Socialiste arriti mazhorancën parlamentare pa domosdoshmërinë e kërkimit të koalicionit paszgjedhor.

Një rezultat që forcat opozitare indirekt e pranuan, por në daljet publike e delegitimuan si një rezultat të një procesi zgjedhor me integritet të cënuar.

Sërisht në argumentimin e forcave opozitare u sollën pretendimet për një fenomen masiv të shit-blerjes së votës, si dhe të përdorimit të administratës publike në drejtimin e votës.

III. KUADRI LIGJOR ZGJEDHOR

Kuadri ligjor zgjedhor në thelbin e tij mbart “Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, të miratuar në vitin 2008 dhe të amenduar dy herë. Ky akt ligjor rregullon në pjesën më të madhe çështjet e administrimit zgjedhor, financimit të subjekteve zgjedhore dhe sistemin e drejtësisë zgjedhore.

Në rregullimin e këtyre çështjeve, Kodi ndalet veçanërisht edhe në funksionimin e institucioneve permanente si Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Kolegji Zgjedhor, por edhe të organizmave të përkohshëm si Bordi i Monitorimit të Medias, Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor apo Komisionet e Qendrave të Votimit.

Përpos këtij akti madhor, për rregullimin e proceseve zgjedhore janë edhe akte të tjera, ku më i rëndësishmi në hierarkinë ligjore është “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e cila garanton tërë mekanizmin e mandatimit qeverisës. Gjithashtu, përmenden akte të tjera si: “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” mbi veprat penale që çënojnë zgjedhjet, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë” mbi veprimtarinë administrative të KQZ-së, apo Ligji “Për Partitë Politike” mbi funksionimin e partive politike.

¹³ Vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 555, datë 26/07/2017, “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të Zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 qershor 2017”.

A. Administrimi zgjedhor

Administrimi zgjedhor përfshin tre tematika madhore në sigurimin e mbarëvatjes së proceseve zgjedhore. Këto tematika janë: përgatitja e *listës së zgjedhësve*; *ngritja e administratës zgjedhore* si Komisionet e nivelit të dytë apo të tretë; *ndërtimi i infrastrukturës zbatuese* si caktimi i qendrave të votimit apo i vendeve të numërimit votave; sigurimi i kapaciteteve të nevojshme të shërbimit të energjisë elektrike, të teknologjive mbështetëse të filmimit të numërimit të votave, e të tjera.

1) Sistemi elektoral shqiptar

Prej amendimeve kushtetuese të vitit 2008, sistemi shqiptar qeverisës mbështetet në një sistem elektoral proporcional rajonal të mbyllur. Ky sistem rajonal ndërtohet në 12 zona zgjedhore që përkrijnë me njësitë administrative të qarkut, ku votohen listat e kandidatëve për atë zonë të subjekteve zgjedhore garuese.

Për zgjedhjet për Kuvendin, përjashtohen nga shpërndarja e mandateve partitë politike që konkurojnë më vete dhe që nuk arrijnë të marrin më shumë se 3% të votave, si dhe koalicionet që nuk arrijnë të marrin më shumë se 5% të votave të vlefshme në zonën zgjedhore përkatëse¹⁴.

Ky lloj mekanizmi përgjatë përvojës së tre proceseve zgjedhore të përgjithshme të vitit 2009, 2013 dhe së fundmi të 2017-ës, ka evidentuar disa problematika në përcaktimin e vullnetit popullor.

Dy prej problematikave kryesore të reflektuara janë “votat e humbura” të subjekteve që nuk kalojnë dot pragun dhe “pabarazia e votës” ndërmjet subjekteve që janë pjesë e koalicioneve parazgjedhore dhe atyre që konkurrojnë më vete.

Këto dy fenomene, të shoqëruara me mungesën e garancisë së balotazhit dhe me faktin që listat e kandidatëve janë të mbyllura dhe të përgatitura nga kryetarët e subjekteve, kanë passjellë një imponim politik ndaj votuesve.

Efektivisht, sistemi elektoral e vendos qytetarin të votojë përzgjedhjet e bëra nga kryetarët e subjekteve zgjedhore dhe jo direkt kandidatët garues për t'i patur më pas si përfaqësues të vet në parlament.

Nga ana tjetër, kandidatët e listave të partive pasi zgjidhen deputet, sipas rregullimit kushtetues, marrin një mandat përfaqësimi individual, duke mos patur tashmë detyrim llogaridhënie as ndaj qytetarëve dhe as ndaj vetë partive të tyre.

2) Infrastruktura zgjedhore

Infrastruktura mbështetëse në proceset zgjedhore si: vendndodhja e Qendrave të Votimit, e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor apo e Vendeve të Numërimit të Votave, e shoqëruar me kërkesat dhe kriteret përkatëse për këto vendndodhje, përbën thelbin e administrimit të procesit zgjedhor. Një infrastrukturë që legjislati i e parashikon të ngrihet tërësisht për

¹⁴ Një formulë matematikore e quajtur “Formula d’Hondt”, përcakton ndarjen e mandateve mes subjekteve të ndryshëm, ndërkohë që formula tjetër “Sainte Laguë”, përcakton ndarjen e mandateve mes vetë partive që përbëjnë koalicionin.

çdo proces zgjedhor sipas një mekanizmi, kriteresh, afatesh dhe ndërveprimi institucionesh të përcaktuara. Volumi i madh i përgatitjeve për të ndërtuar një strukturë të tillë¹⁵ me ndërveprimin e disa institucioneve për çdo ecuri zgjedhore, konsiderohet një menaxhim jo i mirë burimesh dhe energjish.

Legjislacioni mund të parashikojë konsolidimin e një harte permanente të vendndodhjes së këtyre trupave të administratës zgjedhore, e cila të rifreskohet në vijimësi nga administrata e përhershme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me informacion koherent për gjendjen.

Kjo gjykohet t'i japë më operativitet administratës së KQZ-së për pajisjen në kohë të këtyre Komisioneve me infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme si: shërbimin e internetit, energjisë elektrike, telefonisë fikse, apo edhe kryerjen e kontrollit fizik të ambienteve ku do të ushtrojnë funksionin këto trupa.

Përsa u konstatua edhe në këtë proces zgjedhor, këto çështje infrastrukturore mbartën sërish problematika si në proceset e mëparshme zgjedhore.

3) Përgatitja dhe hartimi i Listës së Zgjedhësve

Sistemi zgjedhor në Shqipëri parashikon krijimin pasiv të Listave të Zgjedhësve bazuar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, pra një transpozim automatik të tyre pa vendosur asnjë detyrim për zgjedhësit.

Përgatitja dhe saktësimi i Listës Përfundimtare të Zgjedhësve parashikohet të kalojë një mekanizëm i cili përfshin pesë etapa procedurale: ¹publikimin ciklik një mujor të listave paraprake të zgjedhësve; ²njoftimin me shkrim të zgjedhësve; ³korrigjimin administrativ të listave paraprake; ⁴korrigjimin gjyqësor të listave paraprake dhe ⁵mundësinë e votimit me vendim gjyqësor.

Përpos problematikave që mbart kuadri ligjor dhe respektimi i tij, thelbi i problematikës mbetet zbatimi i Ligjit “Për gjendjen civile”¹⁶.

Dinamikat demografike migratore apo emigratore, në vijimësi, nuk kanë gjetur reflektim në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile¹⁷. Dy problematikat më kryesore që u vërejtën edhe në këtë proces ishin votuesit pa adresë shifrore zgjedhore (pa kod banimi)¹⁸ dhe gjendja civile faktike e popullatës, ku veçohet më problematike ajo e personave në sistemin penitenciar.

Në këtë drejtim, vlerësohen si nisma pozitive Ligji Nr. 14/2016, “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë” dhe Projekti i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Regjistrimit të Adresave dhe Shtetasve “Popullimi”.

¹⁵ Në këtë proces zgjedhor infrastruktura përfshinte 5362 Qendra Votimi, 90 Komisione Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe 90 Vende të Numërimit të Votave, dhe 433 tavolina të numërimit të votave;

¹⁶ Ligji Nr. 10 129, datë 11/05/2009, “Për gjendjen civile”; ndryshuar me Ligjin Nr. 6/2012, datë 02/02/2012; Ligjin Nr. 130/2013, datë 25/04/2013; Ligjin Nr. 134/2016, datë 22/12/2016.

¹⁷ Në thelb të tërë rregullimit ligjor qendron detyrimi i shtetasve që ndryshimin e vendbanimit për një periudhë më shumë se tre mujore, t'a reflektojnë si ndryshim edhe të gjendjes civile. Mosrespektimi i këtij rregullimi përgjatë proceseve zgjedhore ka sjellë problematika të ndryshme përsa i përket saktësisë së listës së zgjedhësve.

¹⁸ Me amendimet ligjore të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” në vitin 2004, kur asokohe ishte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ngarkuar në përgatitjen e listave të zgjedhësve, u përcaktua “adresa shifrore zgjedhore” për zgjedhësit (Neni 6). Më pas, me amendimet e vitit 2005 e në vazhdim u përcaktua se “në listën e zgjedhësve, për çdo zgjedhës, shënohen: numri rendor në listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, adresa shifrore zgjedhore, emri, atësia, mbiemri dhe datëlindja” (Neni 51).

Megjithatë, këto nisma nuk patën impakt në procesin zgjedhor dhe zbatimin e tyre vuajti nga mungesa e transparencës dhe ligjzbatimit.

Përsa i përket mekanizmit të hartimit të listave, i cili në frymë ka për qëllim informimin sa më masiv të qytetarëve për qendrat e votimit ku ata mund të votojnë, evidentohet një problematikë në raport me drejtimin e votës, veçanërisht në kontekstin e krijuar. Mekanizmi i informimit mbi listat e zgjedhësve dhe e drejta e subjekteve zgjedhore për të pasur listat e zgjedhësve, prej disa procesesh zgjedhore po vërehet si një instrument i mundshëm dhe i përdorur për orientimin apo kontrollin e votës.

Në kontekstin e fushatave zgjedhore të zhvilluara gjithmonë e më shumë sipas strategjisë “derë më derë”, pasja në dispozicion e listave të zgjedhësve i ndihmon subjektet zgjedhore në drejtimin dhe kontrollin e votës. Ndonëse kjo e drejtë e subjekteve zgjedhore në fillesat e saj shërbente që ato t’i vinin në ndihmë përkrahësve të tyre për t’i informuar për vendndodhjen se ku ata mund të votonin, tanimë kjo situatë është tjetërsuar. Stabiliteti i listave të zgjedhësve dhe format elektronikë të informimit e kanë zbehur nevojën për informim nga subjektet zgjedhore. Ndërkohë qëllimi i këtij instrumenti është tjetërsuar në përdorim prej subjekteve politike. Mundësia e subjekteve zgjedhore për të lokalizuar çdo votues dhe për të marrë informacioni gati të plotë mbi rrethanat e tyre socio-ekonomike, të ndihmuar nga konteksti i një shoqërie ende të lidhur, me institucione të politizuara dhe garanci të dobta në zbatimin e ligjit, ndihmon dhe ushqen jo pak mekanizmat e drejtimit dhe kontrollit të votës.

4) Aktet nënligjorë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Sipas Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) në bazë dhe për zbatim të ligjit, mund të nxjerrë vetëm vendime ose udhëzime¹⁹. Pas miratimit të Kodit Zgjedhor të vitit 2008, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar së paku 45 nënakte normative ose ndryshime aktesh normative, në zbatim të këtij Kodi. Nga këto akte 11 janë miratuar formalisht si vendime, 6 udhëzime janë aktualisht të shfuqizuar dhe 5 udhëzime janë aktualisht të amenduar.

Problematike është se përgjatë ecurisë së tij, ky institucion në shumë raste, ka miratuar ose ka amenduar një tërësi aktesh me karakter udhëzues, por të formatuara ligjërisht si vendime. Për një pjesë të akteve, kjo ka ndodhur në momentet kur trupa kolegjiale e KQZ-së ka qenë jo e plotë dhe vetëm me katër anëtarë, për shkak të vakancave të krijuara dhe të paplotësuara nga partitë parlamentare.

Përpos se nuk gjendet ende një përpjekje sistematizuese e këtij numri nënaktesh të formësuar proceduralisht në mënyrë diskrecionale, mbetet problematik mospublikimi i 9 prej këtyre nënakteve në Fletoren Zyrtare, nga të cilët 8 janë akoma në fuqi. Nga këto nënakte, 5 prej tyre në fund të tekstit ligjor e lidhin shprehimisht hyrjen në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare, duke ngritur kështu pikëpyetje për zbatueshmërinë e tyre ligjore. Gjithashtu,

¹⁹ Aktet me karakter normativ të miratuar nga kjo trupë kanë fuqi mbi të gjithë territorin e vendit, kanë fuqi mbi të gjithë dhe formalisht “hyjnë në fuqi pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare, përveç rasteve kur rrethanat diktojnë hyrjen e menjëhershme në fuqi, ndërsa aktet e tjera hyjnë në fuqi menjëherë”.

për 5 nënakte normative të publikuara në Faqen e Internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mungojnë lidhjet për materialet shoqëruese.

B. Drejtësia zgjedhore

Në të shumtën e rasteve të raportimit apo të analizës së proceseve zgjedhore, fusha e drejtësisë zgjedhore shihet si e njëjta me sistemin shqyrtues të rasteve të ankimeve dhe apelimeve të subjekteve zgjedhore.

Në fakt, qasja korrekte ndaj drejtësisë zgjedhore duhet të përfshijë edhe rastet e shqyrtimit të formave të korrupsionit zgjedhor apo formave të cënimit të vullnetit të votuesve. Në këtë mënyrë edhe institucionet e përfshira në këtë sistem nuk janë vetëm ato me objekt të mirëfilltë zgjedhor, por edhe institucione si gjykatat e zakonshme apo institucionet hetimore si Prokuroria.

1) Penalizimi i veprave që çënojnë zgjedhjet

Prej miratimit të “Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë” në vitin 1995, në Kreun X të tij janë njohur veprat që çënojnë liritë dhe integritetin e proceseve zgjedhore.

Në amendimet që i janë bërë këtij akti në vite është zgjeruar numri i kundërvajtjeve penale që çënojnë zgjedhjet. Me amendimet e kryera në seancën e jashtëzakonshme të datës 22/05/2017, këto kundërvajtje u shndërruan në vepra penale dhe sanksionet përkatëse u rënduan.

Jo vetëm në teorinë e së drejtës, por kryesisht në çështjet e së drejtës penale, rëndimi i penaliteteve vlerësohet me rezerva. Përvoja ka treguar se rritja e penaliteteve më së shumti nuk e nxit kulturën e ndëshkueshmërisë dhe të zbatimit të ligjit.

Në përvojën shqiptare, ku cënuesit e proceseve zgjedhore në pjesën dërmuese nuk janë dënuar, rritja e penaliteteve mund të sjellë efektin e kundërt nga ai i kërkuar²⁰.

Vlerësohet si problematik dhe i paadresuar nga kuadri ligjor shqiptar, parashikimi i një mekanizmi hetimi efektiv dhe i një procedure efektive denoncimi ndaj fenomeneve që çënojnë lirinë dhe integritetin e proceseve zgjedhore. Veçanërisht procedurat e denoncimit, vlerësohen si një problematikë madhore. Mungesa e një procedure efektive e shoqëruar nga kultura e pandëshkueshmërisë ka ndërtuar një perceptim publik ndaj kultit të pandëshkueshmërisë, i cili gjithmonë e më shumë po kërkon një sipërmarrje të jashtëzakonshme për t’u ndryshuar.

2) Sistemi zgjedhor i ankimit-apelimeve

Me miratimin e “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” të vitit 2003, i cili konstitui për herë të parë Kolegjin Zgjedhor, u materializua një mekanizëm

²⁰ Në kontekstin e një shoqërie të mbyllur me lidhje farefisnore dhe shoqërore të ngushta, me besim të ulët tek institucionet dhe ligjzbatimi, apo ku kultit i pandëshkueshmërisë është i fortë, rritja e penaliteteve ushqen hezitim apo frenim për të sjellë denoncimin e shkelësve. Nga ana tjetër, edhe për strukturat e hetimit bëhet kështu më e vështirë të provuarit e veprës, si dhe “rezistenca” e formave korruptive gjykohet të jetë më e lartë përballë penaliteteve më të rënda.

relativisht i plotë i sistemit të ankimim-apelimeve për çështjet zgjedhore. Një sistem i mbështetur në gjykimin administrativ, i cili përfshin Komisionin Zonal të Administrimit Zgjedhor dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, dhe në gjykimin gjyqësor të kryer nga Kolegji Zgjedhor, trupë gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit të Rrethit Tiranë.

Ky mekanizëm i drejtësisë zgjedhore, i cili ka pësuar ndryshime sekondare, është provuar ndër të tjera në shtatë procese zgjedhore të përgjithshme, ku përvoja e fundit ishin Zgjedhjet e 25 Qershorit 2017. Ajo që vihet re në këtë përvojë është defaktorizimi i këtij mekanizmi të dhënies së drejtësisë zgjedhore, pra i rivendosjes së të drejtave të subjekteve zgjedhore të cilat janë çenuar gjatë procese zgjedhore.

Ky defaktorizim përpos se ka ardhur si pasojë e një sjellje politike për t'a anametur si proces drejtësinë zgjedhore, ka ndodhur edhe për shkak se ne vetvete ka mbartur problematika të thella në rregullimin ligjor.

Në thelb të këtyre problematikave mund të evidentohen tre tematika përgjithëse, të cilat e kanë shndërruar sistemin në jo efikas. Këtu përmenden mungesa e parimit të precedentit, i cili është shfaqur në inkoherenca të forta vendimmarrëse, sidomos në gjykimin gjyqësor.

Së dyti, vërehet mbivendosja e kompetencave dhe e roleve në marrëdhëniet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Kolegjit Zgjedhor dhe Gjykatës Kushtetuese.

Në fund dhe në vazhden e dy të parave, përmendet mospërcaktimi i saktë i të drejtave dhe i instrumentave ligjorë të palëve për t'iu drejtuar këtij mekanizmi. Kuadri ligjor është i paqartë se cilat janë objektet, subjektet apo rrethanat e legjitimuara për t'iu drejtuar kësaj gjykate, si dhe kufijtë e tagrave të vendimmarrjes së kësaj gjykate në raport me procesin zgjedhor.

C. Financat e subjekteve zgjedhore

Teksti ligjor që rregullon, kontrollon dhe bën transparencën e veprimtarisë financiare të partive politike në periudhën zgjedhore ose kalendarike vjetore, parashikon një mekanizëm në tre nivele dhe të ndërthurur. Këto nivele përfshijnë depozitimin e raporteve të vetëdeklarimit financiar vjetor nga partitë, auditimin vjetor dhe/ose zgjedhor të veprimtarisë financiare nga ekspertët kontabël të përzgjedhur nga KQZ-ja, si dhe procesin e verifikimit që mund të ndërmerret nga KQZ-ja. Një mekanizëm që *a priori* maksimalisht siguron korrektësinë e librave financiarë të subjekteve zgjedhore, por jo një evidentim real të të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera²¹.

Kuadri ligjor për veprimtarinë financiare të subjekteve zgjedhore, përpos moszbatueshmërisë së ligjit, vuan edhe prej mos parashikimit të instrumentave realë ligjorë, mos adresimit tërësor apo adresimit minimal të problematikave të rëndësishme. Këtu përmenden mungesa e rregullimeve

²¹ Veprimtaria financiare e partive politike dhe e subjekteve zgjedhore, që prej Ligjit "Për partitë politike" të vitit 1991 dhe deri me ndryshimet e kryera të Ligjit "Për Partitë Politike" të vitit 2001, në thelbin e tij vlerësohet si tërësisht jo efektiv. Kuadri ligjor në fjalë përmban rregullime të pakta, përcakton një kontroll fiktiv dhe garanton një transparencë jo reale të asaj që është veprimtaria financiare e subjekteve zgjedhore.

përsa i përket shpenzimeve të kryera nga personat e tretë apo e ashtuquajtura “fushata hije”, rrethi tejet i ngushtë i konfliktit të interesit për donatorët, apo mospërkufizimi ligjor i koncepteve bazike si ai i zyrave zgjedhore, degëve partiake, vullnetarizmit politik apo i fushatës së parakohshme.

Me amendimet e kryera ndaj Ligjit “Për Partitë Politike” në seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit të datës 22/05/2017, mekanizmi i kontrollit u pasurua dhe me një instrument të ri. Ndryshimet ligjore parashikuan që, në funksion të vlerësimit të kostove të fushatave zgjedhore, KQZ-ja emëron ekspertë financiarë në monitorimin e veprimtarisë elektorale të subjekteve. Këta ekspertë brenda 4 muajsh nga shpallja e rezultatit detyrohen të depozitojnë raportet përkatëse për vlerësimin e kryer prej tyre, që për këtë proces zgjedhor, si afat i fundëm depozitimi është data 26/11/2017.

D. Reformimi i kuadrit ligjor zgjedhor

Problematikat e vërejtura në vijimësi të proceseve zgjedhore dhe dështimi i procesit të reformës zgjedhore të vitit 2016, e bëjnë të një rëndësie vitale amendimin e kuadrit ligjor zgjedhor. Një proces amendimi që nevojitet të jetë integral në tematikat që përfshin, gjithëpërfshirës në aktorët pjesëmarrës dhe transparent në procesin e diskutimeve.

1) Reformimi i thellë dhe harmonizimi i kuadrit ligjor

Marrëveshja politike e 18 Majit, ndonëse e shpëtoi procesin zgjedhor nga një precedent negativ i mospjesëmarrjes së opozitës, nuk shpëtoi procesin nga një përvojë tjetër me precedentë negativë.

Zhvendosja e afateve ligjore pa asnjë rregullim ligjor, zëvendësimi i Kryetarit të KQZ-së me anë të një procedure formale dhe mbivendosja e vullnetit politik ndaj rregullimit ligjor, kaparosën përvojën e deritanishme të përvojave zgjedhore jo si mbarëvajtje ligjore.

Në një përvojë disa vjeçare zgjedhore, vullnetet politike kanë arritur të determinoheshin si pranues apo “çertifikes” të proceseve dhe rezultateve zgjedhore, duke delegjitimuar vendimmarrjen institucionale. Precedenti i fundit, arriti të vendosë plotësisht vullnetin e lidhshipeve politike tashmë edhe si vullnet administrues të proceseve zgjedhore.

Fryma e reformës zgjedhore të pritshme nevojitet pikë së pari të përballet me distancimin e vullnetit politik nga administrimi dhe “çertifikimi” i proceseve zgjedhore. Distancim ky që në terma ligjorë do të thotë forcim i institucioneve realisht të pavarura dhe forcimi real i rolit qytetar në mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore.

2) Transparenca e procesit zgjedhor

Sigurimi i integritetit të proceseve zgjedhore kërkon jo vetëm zbatim të ligjit dhe institucione të pavarura, por edhe dukjen si të tillë.

Perceptimi publik është një garanci e domosdoshme në forcimin e

besimit qytetar tek institucionet dhe në investimin e tyre. Sjellje kjo që nuk mund të arrihet pa sigurimin e një transparence maksimale të të gjithë procesit zgjedhor.

Kjo transparencë maksimale përpos çdo garancie të tekstit ligjor, duhet të jetë një frymë vertikale e institucioneve për të evidentuar mangësitë e proceseve dhe për të shmangur dyshimin qytetar ndaj të gjitha formave të mundshme të manipulimit.

Në këtë drejtim, kuadri ligjor përcakton kritere relativisht të plota në sigurimin e transparencës për proceset zgjedhore dhe në të drejtat e vëzhguesve.

Megjithatë, këto garanci ligjore janë cënuar nga aktorët përgjegjës në çështje nga më thelbësore, deri në sjellje haptazi anti-ligjore, si për shembull mospublikimi i vendimmarrjes institucionale. Nevojitet që kuadri ligjor jo vetëm të parashikojë masa penalizuese për shkelësit, por edhe të përcaktojë rrugë alternative të marrjes së informacionit në momentin kur funksionarët përgjegjës vendosin apo sillen në shkelje të të drejtave për informimin publik ose të të drejtave të vëzhguesve.

IV. ADMINISTRIMI I PROCESIT ZGJEDHOR

Administrimi i proceseve zgjedhore në vend parashikohet si një strukturë piramidale në tre nivele komisionesh. Në majë të strukturës administruese qëndron trupa e komisionerëve dhe administrata publike e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Institucioni i KQZ-së ngarkohet si një strukturë jo vetëm organizuese, por edhe mbikqyrëse e tërë procesit zgjedhor. Për këtë qëllim, ajo asistohet nga institucione të tjera përgjegjëse për proceset zgjedhore, nëpërmjet Nëpunësve Ndërlidhës (NN), të cilët janë funksionarë të institucioneve të ngarkuar posaçërisht për të kryer komunikimin institucional sa më dinamik.

Në nivel të dytë dhe lokal qëndrojnë në vazhdimësi Zyrat Rajonale Zgjedhore (ZRZ), ndërkohë që kur është vit zgjedhor ngrihen dhe funksionojnë për rreth 3 muaj Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), të ngarkuar për administrimin e çdo Zone të Administrimit Zgjedhor (ZAZ). Pranë KZAZ-ve ngrihen Vendet e Numërimit të Votave (VNV) dhe pranë këtyre të fundit ngrihen Grupet e Numërimit të Votave (GNV), të përbërë nga komisionerë të ngarkuar për numërimin e fletëve të votimit. Ndërsa Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) janë strukturat më afatshkurtra një ditore që funksionojnë vetëm ditën e zgjedhjeve.

Trupa me shtatë anëtarë e KQZ-së ngarkohet nga “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” si përgjegjëse për mbikqyrjen e mbarëvajtjes së të gjithë procesit zgjedhor, para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve²². Për këtë proces zgjedhor, kjo

²² Gjashtë prej anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve miratohen me shumicë “50 plus 1” nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (KRSH). Kandidaturat e tyre paraqiten tre prej dy partive më të mëdha të mazhorancës

trupë qendroi në majën e hierarkisë administrative të 90 KZAZ-ve për 90 ZAZ-të, 28 ZRZ-ve dhe 28 inspektorëve, 92 NN-ve, 866 GNV-ve dhe 5'362 KQV-ve.

A. Ecuria e punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

1) Deformimi i kompozimit të anëtarësisë së KQZ-së

Marrëveshja Politike e 18 Majit pas-solli ndër të tjera ndryshimin e Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve²³.

Në frymën e kuadrit ligjor, Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është, së paku, titullari i institucionit dhe përcaktuesi në sigurimin e mazhorancës vendimmarrëse të institucionit.

Në aspiratën kryesore të kuadrit ligjor, në vazhden e një përpjekje disa vjeçare që prej "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë" të vitit 2000, Kryetari mban përgjegjësinë e garantimit të paanshmërisë dhe pavarësisë institucionale të KQZ-së. Reforma legislative zgjedhore e vitit 2012 përcaktoi një procedurë të hapur për përzgjedhjen e këtij pozicioni pikërisht për të arritur në përzgjedhjen e një figure që aspirohej të garantonte paanshmërinë dhe pavarësinë institucionale.

Ndryshimet e kryera, si pasojë e Marrëveshjes së 18 majit, përpos një procedure ligjore më shumë se të sforcuar²⁴ dhe që provuan pavërtetësinë e vullnetit politik për të ndërtuar një institucion të paanshëm dhe të pavarur, konkluduan në një deformim të kompozimit të trupës së KQZ-së.

Tanimë trupa e KQZ-së ka katër anëtarë të propozuar nga mazhoranca parlamentare, ndërkohë që Kryetari është një nga tre anëtarët e propozuar prej minorancës parlamentare.

Ndonëse mund të pranohet se një formulë e tillë në përbërje siguron një "barazi armësh" në drejtimin e trupës dhe të institucionit, kjo situatë bie ndesh me tërë frymën dhe strukturën e legjislacionit zgjedhor.

Ky deformim prek jo vetëm çështjet e administrimit zgjedhor, por gjithashtu edhe çështjet e tjera që janë tagër e KQZ-së. Një institucion që duhet pranuar se është tejet i ngarkuar me detyrime voluminoze jo vetëm mirëfilltazi zgjedhore si administrimi, drejtësia zgjedhore apo financat e partive politike, por edhe lidhur me çështjet referendare apo me të ashtuquajturin proces të dekriminalizimit.

parlamentare dhe tre të tjerë nga dy partitë më të mëdha të minorancës parlamentare. Gjithashtu, edhe anëtar i shtatë, i cili mban detyrën e Kryetarit dhe titullar i institucionit, miratohet me shumicë "50 puls 1" nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ndryshe nga anëtarët e tjerë, kandidaturat vijnë si thirrje e hapur publike dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (KÇLAPDNJ) i cili përzgjedh dy kandidatura. Nga aplikantët e interesuar përzgjidhen dy kandidatura, sipas një mekanizmi skualifikues të anëtarëve përfaqësues të mazhorancës dhe pakicës parlamentare në KÇLAPDNJ. Në fund KRSH miraton me shumicën parlamentare "50 plus 1" kandidaturën për Kryetar të KQZ-së.

23 Formalisht, pas dorëheqjes së Kryetarit në detyrë që prej emërimit me datë 3 nëntor 2016 dhe thirrjes publike për më pak se 24 orë për vakancën e krijuar, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në seancën jashtëzakonshme të datës 22/05/2017 miratoi kandidaturën e z. Klement Zguri si Kryetar. Z. Zguri deri në atë moment, prej vitit 2000 ishte anëtar i Komisionit si i kandidaturë e propozuar nga Partia Republikane. Ndërsa Kryetari i larguar z. Biba, ishte më parë anëtar i KQZ-së për rreth 3 vite si i propozuar nga Partia Socialiste, ndërkohë që në seancën e 22 majit u ir-miratua formalisht anëtar i KQZ-së si kandidaturë e propozuar nga Partia Republikane.

24 Thirrja publike e vakancës, koha për për t'i mundësuar aplikimin kandidatëve të interesuar, mekanizmi mazhorancë-opozitë në anëtarësinë e komisionit parlamentar për skualifikimin e kandidatëve, deri në miratimin e një prej dy kandidaturave prej Kuvendit, parashikon formalitete dhe afate ligjore disa javore.

2) Vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Që prej dekretimit të datës së parë të zgjedhjeve, trupa e KQZ-së zhvilloi 72 seanca plenare për përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor. Gjatë këtyre seancave në funksion të procesit zgjedhor, trupa miratoi 478 vendime²⁵, nga të cilat 4 vendime për ndryshim udhëzimesh dhe 3 udhëzime.

Pjesëmarrja e shtatë anëtarëve në këto seanca ishte gati tërësisht e plotë dhe mbarëvajtja kryesisht ka respektuar ceremonialitetin. Megjithatë, përpos edhe vendimmarrjes së shumti unisone, trupës i mungoi kolegjaliteti dhe dialogu institucional. Vazhdoi të vërehet pozicionimi *en bloc* i anëtarëve në diskutimin e çështjeve. Dy seanca gjatë të cilave pati konfliktualitet ndërmjet palëve, u shoqëruan me bojkotimin e tre anëtarëve të propozuar nga minoranca parlamentare²⁶.

Përpos angazhimit në funksion të përgatitjeve për procesin zgjedhor, KQZ ishte e angazhuar edhe në zbatim të legjislacionit për procesin e ashtuquajtur të dekriminalizimit.

Në zbatim të këtij legjislacioni, në periudhën që referon dokumenti janë marrë në shqyrtim në rend dite verifikimet për 9 Kryetarë Bashkie, 16 Deputetë të Kuvendit dhe 10 anëtarë të Këshillave Bashkiakë. Në bazë të vendimmarrjes së KQZ-së u vendos përfundimi i mandatit para afatit për 1 Kryetar Bashkie, 2 Deputetë të Kuvendit dhe 9 anëtarë të Këshillave Bashkiakë²⁷.

Transparenca institucionale vazhdoi të ishte sërisht problematikë e administratës publike të këtij institucioni. Pranohet progresi në këtë çështje, por vërehet një situatë larg detyrimeve ligjore dhe akoma më larg frymës së transparencës që nxit besimin e qytetarëve në integritetin e procesit. Lidhur me detyrimin për publikimin brenda 24 orëve të akteve në faqen zyrtare të internetit konkludohet se 50 % e tyre u publikuan në kohë, 45 % e tyre nuk u publikuan as brenda një jave, 118 akteve të publikuara iu mungojnë materialet bashkëlidhur dhe 9 akte për këtë proces zgjedhor nuk janë publikuar ende.

3) Respektimi i afateve procedurale

Respektimi i procedurave dhe kryesisht i afateve nga institucionet e administrimit zgjedhor edhe në procese të mëparshme ka qenë problematike. Kjo problematikë nuk ka ardhur vetëm për shkak të tejkalimeve

²⁵ Në total për periudhën që mbulon dokumenti, trupa e KQZ miratoi 565 vendime, nga të cilat 478 vendime në funksion të procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare, 31 vendime në funksion të realizimit të zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kavajë, 50 vendime në funksion të ligjit të dekriminalizimit, 6 vendime për çështje të tjera. Votimi i vendimmarrjes së trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në funksion të procesit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare ishte 439 vendime me votim 7-0, 9 vendime me votim 6-1, 3 vendime me votim 5-2, 16 vendime me votim 4-3, 59 vendime me votim 6-0, 30 vendime me votim 4-0, 3 vendime me votim 4-2, 2 vendime me votim 4-1 dhe 4 vendime me votim 5-0.

²⁶ Në seancën e datës 27/02/2017 gjatë diskutimit për emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së dhe në seancën e datës 23/03/2017 gjatë diskutimit për shqyrtimin e dosjeve të disa deputetëve dhe Kryetarëve të Bashkisë në kuadër të Ligjit të Dekriminalizimit. Për më shumë shih Qendrim publik "Mbi procesin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 18 Qershorit 2017 dhe të tjera procese institucionale dhe politike të lidhura me të Dhjetor 2015 - 31 mars 2017" faqe 22,23. <http://www.zgjedhje.al/uploads/File/2017/Procesi%20zgjedhor%202017/KVV-QendrimPublik-Zgjedhjet2017eTeTjeraProceselInstitucionaleEPolitikeTeLidhuraMeTe-07-04-2017.pdf>

²⁷ Ndërkohë më parë për 18 anëtarë të Këshillave Bashkiakë u vendos përfundimi i mandatit për shkak të mosdorëzimit të formularit të vetëdeklarimit pranë KQZ, në muajin Maj 2016. Për më shumë shih Qendrim publik "Mbi procesin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 18 Qershorit 2017 dhe të tjera procese institucionale dhe politike të lidhura me të Dhjetor 2015 - 31 mars 2017" <http://www.zgjedhje.al/uploads/File/2017/Procesi%20zgjedhor%202017/KVV-QendrimPublik-Zgjedhjet2017eTeTjeraProceselInstitucionaleEPolitikeTeLidhuraMeTe-07-04-2017.pdf>.

eventuale, por edhe si një frymë institucionale për t'i vlerësuar afatet ligjore jo si detyrim, por si afate orientuese dhe fleksibël. Madje, kjo qasje nuk ka qenë një standard i "imponuar" nga ecuria e praktikës, por është përdorur si një standard i dyfishtë i institucioneve. Në disa raste forma procedurale është vlerësuar si e pactedueshme, ndërkohë që në raste të tjera përmbajtja është parë si prevaluëse ndaj respektimit të formaliteteve.

Në zbatim të kuadrit ligjor zgjedhor dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor, trupa e KQZ-së miratoi me vendim "*Planin Orientues të Veprimeve*" (POV). Ky plan reflekton detyrimet procedurale në organizim të procesit zgjedhor, si dhe detyrime kohore që vetë institucioni i vendos vetes. Vendimi për POV të këtij procesi zgjedhor u miratua në seancën e datës 9 dhjetor 2016 dhe përbëhej prej 58 pikash. Në analizë, rezultoi se ky plan u respektua në 43 % të tijin deri me datë 18 Maj 2017, kur u arrit marrëveshja politike dhe afatet procedurale u tjetërsuan. Megjithatë, pranohet se POV e humbi objektin e tij me bojkotin institucional të forcave opozitare dhe shtyrjen më pas të datës së zgjedhjeve, si rezultat e Marrëveshjes së 18 Majit.

Shtyrja e datës së zgjedhjeve për në 25 Qershor zhvendosi tërë ecurinë e procesit zgjedhor në një boshllëk ligjor. Kjo situatë e vendosi administrimin e procesit në një *stres-test*, në dy muajt e tij më delikat.

Mbi KQZ-në si institucioni mbikqyrës dhe drejtues rëndoi pesha e gjithë kësaj situatë pa asnjë akt ligjor përpos një dekreti të dytë presidencial të datës 21 maj 2017 për caktimin e datës së re të zgjedhjeve.

Kësisoj, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kreu në mënyrë ekstra ligjore dhe jashtë afateve regjistrimin e disa subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve përkatës²⁸, pranimin e depozitimit të propozimeve për anëtarë të KZAZ-ve nga partitë e opozitës, zëvendësimin e anëtarëve të KZAZ-ve të emëruar kryesisht, apo miratimin e modeleve të fletëve të votimit.

Ky precedent kaparosi botërisht standardin e dyfishtë në respektimin e procedurave zgjedhore, në varësi të një vullneti më madhor, i cili në të ardhmen mund të jetë politik ose jo.

4) Precedenti pozitiv i caktimit të mandateve për çdo zonë zgjedhore si dhe i zonave të administrimit zgjedhor

Përcaktimi i numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore dhe i zonave të administrimit zgjedhor (ZAZ) janë dy momente të një rëndësie të veçantë, të cilat në të gjitha proceset e mëparshme zgjedhore kanë qenë çështje të shoqëruara me debate të forta midis anëtarëve të trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si edhe në diskutimin politik²⁹.

²⁸ Në situatën e gjendur, KQZ-ja në Vendimet Nr. 324 dhe Nr. 325, për regjistrimin e Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane, përdori si bazë ligjore të përmendur në aktet në fjalë Nenin 3, pika 3, të Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë". Kjo dispozitë në "Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", është në fakt përkufizim i konceptit të diskrecionalitetit në tagrat apo detyrat funksionale të administratës publike. Përkufizim ky i cili është tërësisht i pavend në aktet e përmendura, i keqpërdorur si një visticë e kuadrit ligjor për tejkalimin e tij, dhe më e rëndësishmja mbart rrezikshmëri në përdorimin e precedentit në të ardhmen.

²⁹ Përvoja e zbatimit të kriterëve ligjore për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor përgjatë katër proceseve zgjedhore (2009, 2011, 2013, 2015), pas miratimit të Kodit të ri Zgjedhor në vitin 2008, ka qenë me debate të forta institucionale dhe politike. Ndonëse Kodi Zgjedhor ngarkon ekskluzivisht Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përcaktimi i zonave të administrimit zgjedhor është kryer më së shumti nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me akte legislative dhe në vitin 2013 është kryer nga Kolegji Zgjedhor.

Përsa i përket organizimit të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e 25 Qershorit, diskutimi i këtyre dy çështjeve përbëri një rast tërësisht të ndryshëm nga përvoja e deri sotme.

Diskutimi dhe vendimmarrja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndoqi një rrjedhë institucionale relativisht të qetë dhe konstruktive. Precedent ky që lexohet si shembull i asaj se si arrin konflikti politik të ndërhyjë në rrjedhën institucionale dhe se si çështje nga më menaxheriale shndërrohen në debate politike.

B. Ecuria e punës së Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor

Komisionet Zonalet të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) janë komisionet e nivelit të dytë që bëjnë administrimin në nivelin lokal të proceseve zgjedhore³⁰.

Natyra dhe specifikat që kanë, i bëjnë këto komisione mbase më të rëndësishmit në administrimin e procesit zgjedhor, por nga ana tjetër edhe më vulnerabël dhe pjesërisht edhe më të vështira për t'u monitoruar. Vlen të përmendet se këto komisione kryejnë funksion të përkohshëm, kanë përbërje mirëfilltazi politike, janë në një numër të lartë në total dhe me shtrirje gjeografike në të gjithë vendin. Theksohet se, edhe pse këto komisione mbartin natyrë institucionale, anëtarët e tyre nuk janë formalisht funksionarë publikë.

1) Konstituimi dhe ecuria e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor

Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor për 90 zonat e administrimit zgjedhor, u konstituan me datë 03/04/2017. Për shkak se vetëm Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim paraqitën propozimet e tyre brenda afatit me datë 05/04/2017, në gjysmën e tyre sekretarët ose kryetarët u emëruan kryesisht nga KQZ-ja³¹.

Pas Marrëveshjes së 18 Majit dhe depozitimit të propozimeve për anëtarë nga Partia Demokratike dhe Partia Republikane, KQZ-ja kreu në datat 31/05/2017 dhe 05/06/2017 zëvendësimin e anëtarëve të emëruar kryesisht.

Në funksion të informimit për mbarëvajtjen e punës dhe përgatitjes ligjore të anëtarëve të komisioneve, KQZ zhvilloi sesione trajnimi në sistem "kaskadë". Fillimisht me datë 13/05/2017 organizoi sesionin e trajnimit të trajnerëve të anëtarëve të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe Inspektorëve të Zyrave Rajonale Zgjedhore. Ndërsa në datën 07/06/2017 u zhvilluan sesionet e trajnimit me pjesëmarrjen e anëtarëve të KZAZ-ve. Megjithatë, zëvendësimi i anëtarëve të emëruar kryesisht dhe lirim-emërimet e anëtarëve përkatës nga vetë subjektet zgjedhore në

³⁰ Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve përbëhen nga shtatë anëtarë me të drejtë vote dhe nga sekretari përgjegjës për dokumentacionin e komisioneve, pa të drejtë vote. (Neni 29 i Kodit Zgjedhor). Këto komisione kryejnë konstituimin e Komisioneve të Qendrave të Votimit (Neni 33 i Kodit Zgjedhor), konstituimin e Grupeve të Numërimit të Votave (Neni 36 i Kodit Zgjedhor), akreditimin e vëzhguesve partiakë (Neni 6 i Kodit Zgjedhor), shpallin rezultantin përfundimtar (Neni 122 i Kodit Zgjedhor) dhe më e rëndësishmja janë shkalla e parë në gjykimin administrativ (Neni 126 i Kodit Zgjedhor).

³¹ Për shkak të mos depozitimit të propozimeve për anëtarë dhe sekretarë nga Partia Demokratike dhe Partia Republikane brenda afatit të përcaktuar në Nenin 28 të Kodit Zgjedhor, konkretisht në datën 6 mars 2017, KQZ bëri thirrjen publike me datë 12/03/2017 për personat e interesuar nga shoqëria civile për t'u bërë pjesë e tyre. Pas shprehjes së interesit nga aplikantët, në seancën e datës 03/04/2017 u miratuan 47 anëtarë dhe 45 sekretarë të emëruar kryesisht.

vazhdën e traditës së mëparshme të proceseve në vend, e cënoi më së shumti punën e kryer nga KQZ-ja.

Edhe me mungesën e opozitës në komisione deri në momentin kur u zëvendësuan anëtarët e emëruar kryesisht, lirim-emërimet e anëtarëve nuk munguan nga dy subjektet zgjedhore PS e LSI duke kryer zëvendësimin e 15 anëtarëve dhe 4 sekretarëve.

Ndërsa pas plotësimit të konfigurimit politik të KZAZ-ve, gjatë periudhës në vazhdim deri në fund të procesit zgjedhor, u kryen 53 lirim-emërimet e anëtarësh të tjerë, nga të cilët 22 sekretarë, 2 zv.kryetarë dhe 1 kryetar. Përqindja në total e lirim-zëvendësimeve të anëtarëve të KZAZ-ve shënoi ulje në krahasim me proceset e fundit, e cila ishte në masën 24.5%, duke përfshirë dhe ata të emëruar kryesisht³².

2) Transparenca në ecurinë e punës së KZAZ-ve

Kuadri ligjor ndër të tjera rregullon se seancat e vendimmarrjes së KZAZ-ve janë plenare, mbledhjet e tyre zhvillohen në ambientet e caktuara si seli e tyre, vendimmarrja e komisioneve bëhet publike brenda 24 orëve dhe i mundësohet pa pagesë personave të interesuar, oraret e punës së komisioneve janë të përcaktuara apo se shkresat e depozituara shënohen në librat e protokollit. Këto kërkesa pa ekuivok të tekstit ligjor për transparencën, në vazhdim e traditës së proceseve të mëparshme zgjedhore edhe në këtë proces zgjedhor vuajtën nga një mos-zbatueshmëri e rëndë.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë (KVV) me datë 20/06/2017 iu drejtua me shkresë zyrtare dhe me njoftim elektronik 90 Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, me objekt marrjen e faksimileve të vendimeve të këtyre Komisioneve. Ky komunikim zyrtar ishte paraprirë nga refuzimi gati tërësor i përfaqësuesve të këtyre komisioneve ndaj kërkesave verbale të vëzhguesve afatgjatë të KVV-së për të patur faksimilet e vendimeve.

Edhe pas shkresave zyrtare të depozituara, në asnjë rast nuk u dha përgjigje formale nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor.

Nga dokumentacioni i KZAZ-ve i depozituar në KQZ dhe i marrë pjesërisht nga ky i fundit³³, rezultoi se 48 Komisione i kanë përcjellë dokumentacion të mangët KQZ-së dhe me parregullsi të shumta, të cilat reflektojnë edhe mbarëvajtjen e punës së kryer prej tyre.

Nga informacioni i marrë informalisht deri tre javë pas ditës së zgjedhjeve nuk i kishin përcjellë dokumentacionin e plotë të vendimmarrjes KQZ-së³⁴. Nga 48 KZAZ-të që kishin depozituar

³² Në procesin zgjedhor të vitit 2013, lirim-zëvendësimet e antarësisë së KZAZ-ve ishin në masën 37,2% dhe për procesin zgjedhor të vitit 2015 lirim-zëvendësimet e antarësisë së KZAZ-ve ishin në masën 37%.

³³ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë me datë 03/07/2017 iu drejtua me shkresë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të marrë kopje të dokumentacionit të vendimmarrjes së Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor. Në përgjigje të kësaj shkrese, zyrtarisht Komisioni refuzoi të lëshonte kopje të këtij dokumentacioni, me argumentimin e pamundësisë teknike në momentin e dhënë. Sjellje haptazi anti-ligjore dhe vetëm pas këmbënguljes së përfaqësuesve të Koalicionit, ky dokumentacion u përcoll në mënyrë informale.

³⁴ KZAZ Nr. 1 Bashkia Malësi e Madhe; KZAZ Nr. 2 Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 8 Bashkia Fushë-Arrës; KZAZ Nr. 9 Bashkia Tropojë; KZAZ Nr. 10 Bashkia Has; KZAZ Nr. 11 Bashkia Kukës; KZAZ Nr. 12 Bashkia Lezhë; KZAZ Nr. 13 Bashkia

dokumentacionin³⁵, kopje të të cilave KVV arriti të sigurojë, duke vlerësuar mangësitë në rendin kronologjik të akteve, rezultoi se së paku në 10% e vendimeve të marra nuk i ishin përcjellë KQZ-së³⁶.

Ndër çështjet më problematike në vendimarrjet e 48 KZAZ-ve evidentohet se nuk figuron në asnjë rast në vendimet e marra prej tyre akte të cilat kanë bëjnë miratimin e vëzhguesve partiakë. Kjo situatë ndërton një kontekst problematik duke ngritur pikëpyetje të mëdha mbi zbatimin e detyrimeve ligjore mbi atë se sa ka qenë numri i vëzhguesve partiakë pranë QV-ve, KZAZ-ve apo VNV-ve, nga cilët subjekte politike u akredituan këta vëzhgues dhe sa për secilin subjekt në raport me secilin komision administrimi.

3) Infrastruktura e mundësuar nga KQZ-ja për KZAZ-të

Në funksion të zbatimit të detyrimeve ligjore, kuadri ligjor përcakton ndërtimin e një infrastrukture të nevojshme për punën e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor, si caktimi i një selie, pajisja me shërbimin e telefonisë fikse, me shërbimin e internetit, shërbimin e energjisë elektrike apo pajisje zyre (kompjuter personal, printer-skaner, e të tjerë). Kërkesa këto që në kontekstin e kapaciteteve vendase, për afatet dhe rregullimet që vendos kuadri ligjor, pranohet që mbartin vështirësi në administrim.

Ajo që rezultoi edhe nga ecuria e procesit, ishin mangësitë dhe problematikat në respektimin e kërkesave të ligjit lidhur me infrastrukturën e këtyre komisioneve.

Referuar vendndodhjes së miratuar të selive të këtyre komisioneve, rezultoi se pesë prej tyre u vendosën jo në përputhje me kuadrin ligjor³⁷.

Deri në fund të muajit maj, rreth një muaj para datës së zgjedhjeve dhe dy muaj pas konstituimit Komisionet vazhduan të ishin me mangësi të thella në

Lezhë; KZAZ Nr. 15 Bashkia Kurbin; KZAZ Nr. 17 Bashkia Klos; KZAZ Nr. 18 Bashkia Bulqizë; KZAZ Nr. 19 Bashkia Dibër; KZAZ Nr. 20 Bashkia Krujë; KZAZ Nr. 21 Bashkia Durrës; KZAZ Nr. 26 Bashkia Vorë; KZAZ Nr. 27 Bashkia Kamëz; KZAZ Nr. 30 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 31 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 33 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 36 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 38 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 39 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 42 Bashkia Kavajë; KZAZ Nr. 43 Bashkia Rragozhinë; KZAZ Nr. 45 Bashkia Belsh; KZAZ Nr. 46 Bashkia Cërrik; KZAZ Nr. 48 Bashkia Elbasan; KZAZ Nr. 49 Bashkia Elbasan; KZAZ Nr. 50 Bashkia Elbasan; KZAZ Nr. 51 Bashkia Gramsh; KZAZ Nr. 59 Bashkia Patos; KZAZ Nr. 62 Bashkia Ura Vajgurore; KZAZ Nr. 63 Bashkia Kuçovë; KZAZ Nr. 64 Bashkia Berat; KZAZ Nr. 66 Bashkia Skrapar; KZAZ Nr. 68 Bashkia Maliq; KZAZ Nr. 73 Bashkia Kolonjë; KZAZ Nr. 76 Bashkia Memaliaj; KZAZ Nr. 78 Bashkia Gjirokastrë; KZAZ Nr. 82 Bashkia Vlorë; KZAZ Nr. 88 Bashkia Sarandë; KZAZ Nr. 89 Bashkia Finiq.

35 KZAZ Nr. 3 Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 4 Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 5 Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 6 Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 7 Bashkia Shkodër; KZAZ Nr. 14 Bashkia Mirditë; KZAZ Nr. 16 Bashkia Mat; KZAZ Nr. 22 Bashkia Durrës; KZAZ Nr. 23 Bashkia Durrës; KZAZ Nr. 24 Bashkia Durrës; KZAZ Nr. 25 Bashkia Shijak; KZAZ Nr. 28 Bashkia Kamëz; KZAZ Nr. 29 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 32 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 34 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 35 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 37 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 40 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 41 Bashkia Tiranë; KZAZ Nr. 44 Bashkia Peqin; KZAZ Nr. 47 Bashkia Elbasan; KZAZ Nr. 52 Bashkia Librazhd; KZAZ Nr. 53 Bashkia Prenjas; KZAZ Nr. 54 Bashkia Lushnje; KZAZ Nr. 55 Bashkia Lushnje; KZAZ Nr. 56 Bashkia Divjak; KZAZ Nr. 57 Bashkia Fier; KZAZ Nr. 58 Bashkia Fier; KZAZ Nr. 60 Bashkia Roskovec; KZAZ Nr. 61 Bashkia Mallakastër; KZAZ Nr. 65 Bashkia Polican; KZAZ Nr. 67 Bashkia Pogradec; KZAZ Nr. 69 Bashkia Pustec; KZAZ Nr. 70 Bashkia Devoll; KZAZ Nr. 71 Bashkia Korçë; KZAZ Nr. 72 Bashkia Korçë; KZAZ Nr. 74 Bashkia Përmet; KZAZ Nr. 75 Bashkia Këlcyz; KZAZ Nr. 77 Bashkia Tepelenë; KZAZ Nr. 79 Bashkia Libohovë; KZAZ Nr. 80 Bashkia Dropull; KZAZ Nr. 81 Bashkia Vlorë; KZAZ Nr. 83 Bashkia Vlorë; KZAZ Nr. 84 Bashkia Vlorë; KZAZ Nr. 85 Bashkia Selenicë; KZAZ Nr. 86 Bashkia Himarë; KZAZ Nr. 87 Bashkia Delvinë dhe KZAZ Nr. 90 Bashkia Konispol.

36 Ajo që u vërejt në shumë raste, përsa i ishin përcjellë KQZ-së dhe që KVV arriti të sigurojë, vendimarrja e KZAZ-ve me dhjetra vendime ishte e lokalizuar në vetëm pak ditë. Në 12 KZAZ rezultoi se vendimet janë marrë ndërmjet datave 24 deri 26 qershor 2017.

37 Selitë e KZAZ-ve Nr. 71, 72, 74, 75 dhe 89, nuk u caktuan në godina publike me funksion arsimor, kulturor apo shëndetësor. Ato u caktuan në godinën e Bashkisë ose në varësi të Bashkisë, fakt që çënon së paku dukjen e këtyre komisioneve jo si një trupë administruese e pavarur, por si një organ në varësinë e qeverisjes vendore.

komoditetin që duhet t'i ofrohen zyrove. Në asnjë rast komisionet nuk ishin të pajisur me numër telefonik fiks, së paku 20 % e tyre nuk ishin të pajisur me kompjuter personal, rreth 20 % nuk ishin të pajisura me printer-skaner dhe rreth 20 % nuk ishin të pajisur me shërbim interneti. Këto mangësi vazhduan në vijimësi, ku edhe në ditën e zgjedhjeve rezultuan Komisionet me mangësi përsa kërkon kuadri ligjor³⁸.

C. Ecuria e punës së Komisioneve të Qendrave të Votimit

Dita e Zgjedhjeve të 25 Qershorit 2017 u administrua nga 5 362 Komisionet të Qendrave të Votimit (KQV)³⁹. Nga 5 362 Qendra Votimi (QV), 4 952 QV ishin të vendosura në ambiente publike, 389 QV ishin të vendosura në ambiente private dhe 21 QV ishin të vendosura në ambiente të institucioneve të posaçme.

KQV-të duhet të ishin konstituar deri me datë 31 maj 2017⁴⁰, por rezultoi që depozitimet e propozimeve për anëtarësinë e KQV-ve nga subjektet zgjedhore u kryhen deri në ditët e fundit para datës së zgjedhjeve. Kjo problematikë u ngrit me forcë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në disa komunikime publike⁴¹.

Në komunikimin e fundit publik të KQZ-së për këtë çështje rezultoi se deri me datë 23 qershor 2017, nuk ishin konstituar ende KQV-të e 16 KZAZ-ve.

Sipas Vendimi të Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01/06/2017, u përcaktua që funksionarët publikë për t'u përfshirë në anëtarësinë e KQV-ve, nevojiteshin të informonin dhe të merrnin miratimin e eprorëve⁴². Rregullim që vendosi një situatë intimidimi apo pamundësie lejimi nga eprorët të personave që ishin funksionarë publikë, por që ishin propozuar nga subjektet zgjedhore për anëtarë të KQV-ve.

38 KZAZ Nr. 24 Bashkia Durrës kishte mungesë të kompjuterit, printerit dhe ndriçimit; KZAZ Nr. 35 kishte probleme me funksionimin e kompjuterit; KZAZ Nr. 80 Bashkia Dropull mungonte telefoni fiks; KZAZ Nr. 48 Bashkia Elbasan mungonte printeri dhe fotokopja; KZAZ Nr. 49 Bashkia Elbasan nuk punonte printeri.

39 Pranë qendrave të votimit parashikohet ngritja e Komisioneve të Qendrave të Votimit, me përbërje prej shtatë anëtarësh ku dy prej mbajnë pozitën e kryetarit dhe sekretarit. Katër anëtarë në gjysmën e Qendrave të Votimit përzgjidhen nga dy partitë parlamentare më të mëdha të mazhorancës dhe 3 anëtarë nga dy partitë parlamentare më të mëdha të minorancës. Në gjysmën tjetër të Qendrave të Votimit ndodh e anasjellta, ndërsa kryetari dhe sekretari janë të partive të kundërta dhe gjithmonë propozohen nga dy partitë më të mëdha mazhorancë-minorancë.

40 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Neni 36, Përbërja e KQV-së, (...) "2. KZAZ-ja emëron anëtarët e KQV-ve jo më vonë se 5 ditë nga paraqitja e propozimeve".

41 Lidhur me procesin e emërimit të anëtarëve të KQV-ve, KQZ bëri pesë deklaratat publike, ku adresoi vonesën në respektimin e ligjit për konstituimin e këtyre komisioneve. Sipas deklaratave lidhur me këtë çështje, në datën 13/06/2017 ishin emëruar më pak se 50% e komisionerëve. Sipas deklaratës së datës 15/06/2017, 62 KZAZ nuk kishin emëruar asnjë komisioner për Qendrat e Votimit, dhe në 31 prej tyre nuk ishte dorëzuar asnjë propozim nga asnjë parti politike. Në deklaratën e datës 19/06/2017 u raportua se 28 KZAZ nuk kishin përmbyllur emërimet e anëtarëve të KQV-ve. Në deklaratën e datës 21/06/2017 u bë e ditur se 21 KZAZ nuk kishin përmbyllur emërimet e anëtarëve të KQV-ve dhe kjo për shkak se partitë politike që e kanë të drejtën për të propozuar komisionerët e QV, ende nuk kishin depozituar pranë KZAZ-ve listat emërore me dokumentacionin përkatës. Në fund, në deklaratën e datës 23/06/2017 u bë e ditur se ende 16 KZAZ nuk kishin bërë ende konstituimin e KQV-ve.

42 Pika 5: "Punonjësi i administratës shtetërore ka të drejtë të angazhohet si komisioner zgjedhor, në përbërje të KZAZ-ve, KQV-ve dhe GNV-ve, pasi të ketë njoftuar paraprakisht me shkrim eprorin direkt dhe njësinë e personelit për këtë veprimtari dhe të ketë marrë lejen me shkrim nga eprori direkt. Angazhimi si komisioner nuk duhet të ndikojë në përmëshjen e detyrave funksionale si pjesë e shërbimit civil".

Përpos formës ligjore që kishte akti rregullues në raport me legjislacionin për nëpunësit, akti në fjalë afektoi mbarëvajtjen e ngritjes së komisioneve. Ai ngriti pikëpyetje mbi ligjshmërinë e tij mbi përfshirjen ose jo të administratës publike në administrimin e proceseve zgjedhore.

Në rastin e komisionerëve të KZAZ-ve, të cilët në momentin e daljes së aktit ishin emëruar gati të tërë, u evidentua një problematikë jo e vogël dhe e vërejtur në vazhdimësi. Vlen të saktësohet pozicioni që duhet të kenë anëtarët e KZAZ-ve që janë njëkohësisht nëpunës të administratës shtetërore, përgjatë periudhës më shumë se 3 mujore të funksionimit të KZAZ-ve, pa çenuar ose marrëdhënien e punës ose pjesëmarrjen në veprimtarinë e komisionit.

V. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Hartimi i listave të zgjedhësve në legjislacionin shqiptar parashikohet si një mekanizëm pasiv, ku nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile projektohen ekstraktet e përbërësve zgjedhorë të shtetasve nga 18 deri në 100 vjeç. Për saktësimin e këtyre përbërësve parashikohen dy mekanizma: ai i auditëve teknikienë të emëruar nga KQZ-ja dhe ai i korrektimit administrativo-gjyqësor me nismën e qytetarëve.

A. Të dhëna për procesin

Afati ligjor për publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve për Zgjedhjet për Kuvend, të dekretuara fillimisht për në 18 Qershor 2017, ishte data 08/05/2017. Me dekretimin prej Presidentit të Republikës të datës së re 25 Qershor 2017 për mbajtjen e zgjedhjeve dhe me ndryshimin e Udhëzimit për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve, afati i ri për gjenerimin dhe publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve për Zgjedhjet për Kuvend të 25 Qershorit 2017 u përcaktua data 24/05/2017. Datë që nuk e respektoi afatin ligjor për publikimin e listës përfundimtare të zgjedhësve, i cili duhet të jetë jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve dhe që në rastin në fjalë do të ishte data 16/05/2017.

Për Zgjedhjet e 25 Qershorit 2017 rezultoi se shtetas shqiptarë mbi moshën 18 vjeçare që mund të votonin ishin 3 452 308 persona, nga të cilët 136 651 ose 3.96 % ishin zgjedhës që do të votonin për herë të parë. Ndërkohë raporti meshkuj-femra i votuesve ishte 51% - 49%, të përjashtuar nga lista ishin 1 489 persona që kishin mbushur moshën 100 vjeç dhe 1 367 persona të cilët kishin humbur drejtësinë e votës në zbatim të procesit të dekriminalizimit.

Përsa i përket Qendrave të Votimit (QV) ku u votua me datë 25 Qershor 2017,

21 ishin QV të posaçme të vendosura në rezidenca shtetërore me një total prej 3 166 votues. Nga këto Qendra Votimi, 19 ishin pjesë e sistemit penitenciar⁴³, një rezidencë për të moshuar dhe një tjetër rezidencë e shërbimit ushtarak.

Përgatitjes së listës përfundimtare të zgjedhësve duhet t'i paraprijë një proces 60 ditor i njoftimit me shkrim të zgjedhësve⁴⁴ si dhe një proces 5 mujor i publikimeve ciklike të përmuajshme të ekstrakteve të përbërësve zgjedhorë⁴⁵. Dy procese këto që janë në funksion dhe shërbejnë për saktësimin e listës së zgjedhësve nëpërmjet punës së kryer nga Zyra e Gjendjes Civile nën mbikqyrjen e auditëve teknikienë të përzgjedhur nga KOZ-ja si dhe nëpërmjet ankimit administrativ ose gjyqësor që ndërmerret nga vetë zgjedhësit. Ky mekanizëm i fundit është një rregullim që i vjen në ndihmë qytetarëve të cilët nëse vihen në dijeni për pasaktësi të përbërësve zgjedhorë mund t'i drejtohen Zyrës së Gjendjes Civile apo organeve gjyqësore për t'i korrektuar.

B. Njoftimi me shkrim dhe saktësimi i përbërësve zgjedhorë

Për Zgjedhjet e 18 Qershorit e më pas të 25 Qershorit, procesi i njoftimit me shkrim duhej të kryhej në periudhën 04/01/2017 deri më 05/03/2017.

Në këtë proces zgjedhor, për herë të parë pas ndryshimeve të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” të vitit 2012, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një fond për bashkitë e vendit për të kryer këtë proces. Zyrtarisht u njoftua se fondi për zhvillimin e këtij procesi u caktua në shumën prej 13 869 660 lekë, i cili u autorizua për lëvrime në datën 16/02/2017⁴⁶.

Përpos lëvrimit të fondit të përcaktuar në një vonesë të paarsyeshme, edhe mungesa e përkushtimit të zbatimit të ligjit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, bëri që procesi të dilte nga rregullimi ligjor. Nga komunikimi me disa bashki, fondi për njoftimin me shkrim të zgjedhësve u lëvrua përgjatë datave 16 deri 23 shkurt 2017 dhe procesi i njoftimit me shkrim të zgjedhësve nisi në muajin mars, ndërkohë që disa bashki të tjera raportuan se ky proces njoftimi vazhdoi deri në muajin maj. Vlen të shënohet se në këtë proces zgjedhor, ndryshe nga dy proceset zgjedhore të mëparshme, vullneti mos-respektues dhe mos-zbatues i ligjit u shoqërua edhe me një kosto financiare, lidhur me të cilin nuk u bë i ditur asnjë informacion zyrtar mbi rezultatet e tij, as përsa u arrit nga procesi dhe as se si u menaxhua ky fond.

Përsa i përket shtetasve që kërkuar korrektim të përbërësve zgjedhorë në rrugë gjyqësore nga komunikimi zyrtar rezultoi se nuk pati praktikë të tillë. Në asnjë rast për këtë proces zgjedhor, qytetarët nuk u investuan në rrugë gjyqësore për të ndryshuar përbërësit e ekstrakteve zgjedhore.

⁴³ Nga 23 Institucione të Ekzekutimit të Veprave Penale (IEVP) në rang vendi, në katër prej tyre nuk u parashikua ngritja e Qendrave të Votimit të Posaçme për shkak të numrit të votuesve të ligjshëm nën 15 votues siç parashikon kriteri ligjor. IEVP-të ku nuk u ngritën Qendra Votimi ishin IEVP Krujë, IEVP Tropojë, IEVP Spitali i Burgut Tiranë dhe IEVP Kavajë.

⁴⁴ “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 52, Njoftimi me shkrim i zgjedhësve.

⁴⁵ “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 51, Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë.

⁴⁶ Lidhur me këtë proces, sipas komunikimit zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC), ky institucion nuk ka të dhëna mbi ecurinë e procesit të njoftimit me shkrim dhe të dhëna të tjera të mbledhura nga raportimi i detyrueshëm që duhet të bëjnë Kryetarët e Bashkive, sikundër kërkohet prej Kodit Zgjedhor.

VI. REGJISTRIMI I SUBJEKTEVE ZGJEDHORE

A. Deri në arritjen e Marrëveshjes së 18 Majit 2017

Deri në arritjen e Marrëveshjes së 18 Majit 2017, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve u regjistruan 46 subjekte zgjedhore, depozituan listat shumëëmërore të kandidatëve 15 subjekte zgjedhore, nga të cilat asnjë parti politike e opozitës, si dhe nuk u regjistrua asnjë koalicion zgjedhor⁴⁷. Afati i fundëm për depozitimin e listave shumëëmërore dhe për regjistrimin e koalicioneve zgjedhorë ishte një çështje që u shoqërua me shumë diskutime.

Në vazhden e konfliktualitetit politik, mundësisë të mos-marrjes pjesë në procesin zgjedhor të forcave opozitare dhe diskutimeve brenda koalicionit qeverisës, Partia Socialiste (PS) dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) iu drejtuan një kërkesë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për shtyrjen e afatit ligjor për regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Një kërkesë nga dy partitë kryesore të mazhorancës parlamentare pa asnjë bazë ligjore, të cilën KQZ-ja e mori në shqyrtim në seancën e datës 20/04/2017. Pas shqyrtimit të kësaj çështje, trupa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nuk mori asnjë vendim mbi kërkesën.

Përshkrimi i afatave procedurale në “Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë” është problematik në shumë raste, për shkak të formulimit literal që lë vend për ekuivok. Një prej tyre, e cila u shoqërua me debat të fortë politik, ishte afati për dorëzimin e listave shumëëmërore të kandidatëve garues. Diskutimi u përqendrua rreth afatit limit të depozitimit të listave shumëëmërore me datë 28/05/2017 apo me 29/05/2017, ndërkohë që data e zgjedhjeve vazhonte të ishte data 18 Qershor 2017 dhe subjektet zgjedhore të mazhorancës i kishin depozituar listat e tyre shumëëmërore me datë 29/05/2017.

Kjo çështje u ankimua edhe në Kolegjin Zgjedhor nga dy subjekte zgjedhore, por u pushua prej Kolegjit për shkak se palët u tërhoqën. Kjo për shkak se ndërkohë me shqyrtimin e ankimimit u arrit edhe Marrëveshja Politike e 18 Majit duke ricaktuar datën 25 Qershor si data e mbajtjes së zgjedhjeve dhe rrjedhimisht edhe një përllogaritje të re të afateve.

B. Pas arritjes së marrëveshjes së 18 Majit 2017

Në mungesë të koherencës ligjore, pas rivendosjes së afateve për regjistrimin e subjekteve zgjedhore, vetëm dy parti politike depozituan kërkesën për regjistrim dhe u regjistruan nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 26/05/2017.

Baza ligjore e përdorur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në të dy rastet ishte problematike. Situata ligjore në të cilën legjislatori e vendosi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për shkak të vullneteve politike ishte tërësisht e mangët dhe jo institucionale. Megjithatë, përdorimi i referencave

⁴⁷ Afati ligjor për regjistrimin e subjekteve zgjedhore është 70 ditë përpara datës së zgjedhjeve, për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore është 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve dhe për depozitimin e listave shumëëmërore të kandidatëve është jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

ligjore në dy rastet e sipërpërmendura, ndër të tjera e Nenit 3 pika 3 e Ligjit 44/2015 “Kodi Procedurave Administrative”, i cili është dispozitë përkufizuese e termimit “*diskrecioni i organit publik*”, vendos një element më shumë në kuadrin e deritanishëm të precedentëve antiligjorë.

Bazuar në këtë marrëveshje politike, afati për dorëzimin e listave shumëemërore të kandidatëve për deputetë u rivendos në datën 26/05/2017. Partia Demokratike (PD) i dorëzoi këto lista në tejkallim të ekstremitetit kohor dhe me një tërësi mangësish. Pas konstatimit të këtyre mangësive, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 28/05/2017, vendosi t’i jepte 24 orë kohë Partisë Demokratike për plotësimin e listave dhe të dokumentacionit shoqëruës. Për shkak se edhe në shqyrtimin e mbledhjes së datës 29/05/2017, plotësimet në dokumentacion nuk ishin kryer ende prej PD-së, u vendos për dhënien edhe të 24 orëve të tjera. Në mbledhjen e datës 30/05/2017, dokumentacioni i kërkuar ishte plotësuar nga subjekti zgjedhor në fjalë, me përjashtim të respektimit të kuotave gjinore në pesë zona zgjedhore. Mbi këtë të fundit, trupa dhe administrata e KQZ-së në seancë la të kuptohej vendosjen e sanksioneve përkatëse, por në aktin përkatës nuk u bë pjesë.

Në rezultante, në këtë proces zgjedhor morën pjesë 18 subjekte zgjedhore të përfaqësuar nga 2 666 kandidatë, nga të cilët 1 073 gra dhe 1 593 burra.

Ndërkohë ndërmjet kandidaturave të pesë subjekteve zgjedhore që rezultuan më vonë parlamentare (PS, PD, LSI, PDIU, PDS) grupmosha e të rinjve 18-30 vjeç ishte e dyta më e përfaqësuar nga kandidaturat në garim me 26.5% të vendeve⁴⁸. Subjekti zgjedhor me mesataren aritmetike më të lartë të moshës së kandidaturave garuese ishte Partia Socialiste me moshë mesatare 44 vjeç dhe subjekti zgjedhor me mesataren më të ulët të moshës së kandidaturave garuese ishte Lëvizja Socialiste për Integrim me moshën 39 vjeç.

Përsa i përket vendlindjeve të kandidaturave garuese të këtyre pesë subjekteve zgjedhore që rezultuan parlamentare, vërehet se numri më i lartë i kandidaturave kishte për vendlindje zonën gjeografike që i përket qarkut Tiranë me 17.4% të totalit, dhe se numri më i ulët i kandidaturave kishte për vendlindje zonën gjeografike që i përket qarkut Lezhë me 2,8% të totalit⁴⁹.

⁴⁸ Ndërmjet pesë subjekteve zgjedhore që rezultuan parlamentare (PS, PD, LSI, PDIU, PDS) përfaqësimi i grupmoshave në kandidaturat për deputet të tyre ishte: 26,5% e kandidaturave ishin të grupmoshës 18-30 vjeç; 20,77% e kandidaturave ishin të grupmoshës 31-40 vjeç; 25,99% e kandidaturave ishin të grupmoshës 41-50 vjeç; 20,39% e kandidaturave ishin të grupmoshës 51-60 vjeç; 5,1% e kandidaturave ishin të grupmoshës 61-70 vjeç dhe 1,28% e kandidaturave ishin të grupmoshës mbi 71 vjeç.

⁴⁹ Sipas vendlindjeve të kandidatëve garues të 5 subjekteve zgjedhore që rezultuan pas zgjedhjeve parti parlamentare (PS, PD, LSI, PDIU, PDS), zonat gjeografike (sipas qarqeve) ishin të përfaqësuar si vijon: Tirana me 17,27%; Fieri me 12,86%; Elbasani me 10,85%; Durrësi me 10,18%; Kukësi me 3,62%; Shkodra me 9,51%; Vlora me 8,51%; Berati me 6,43%; Dibra me 5,89%; Gjirokastra me 5,63%; Korça me 6,43% dhe Lezha me 2,82%.

VII. FUSHATA ZGJEDHORE

Kodi Zgjedhor e përcakton zhvillim e fushatës elektorale nga subjektet zgjedhore nga 30 ditë para datës së zgjedhjeve deri 24 orë para asaj dite. Një përcaktim ky që jo vetëm rregullon mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore, por përfshin edhe rregullime të tjera si ato mbi veprimtarinë financiare të subjekteve zgjedhore apo mbi ecurinë e administratës publike.

Fushata zgjedhore për Zgjedhjet e 25 Qershorit përcaktohej të zhvillohej përgjatë datave 26 Maj deri me 23 Qershor 2017. Kjo fushatë zgjedhore ishte e para që prej miratimit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në vitin 1998, ku subjektet zgjedhore nuk ishin të përfshira në asnjë koalicion parazgjedhor.

Mbarëvajtja e kësaj fushate prej subjekteve zgjedhore u çënuar dhe u karakterizua nga fenomene të hasura dhe në fushatat zgjedhore të mëparshme, por përmbajti dhe solli në traditën zgjedhore precedentë të rinj.

A. Problematika të traditës në proceset zgjedhore

1) Fushata e parakohshme zgjedhore

Në tërë vijueshmërinë e tyre, proceset zgjedhore në vend janë paraprirë nga fushata zgjedhore të parakohshme. Fenomen ky që ndihmohet dhe nga mospërkufizimi i kuadrit ligjor se çfarë përbën fushatën zgjedhore dhe çfarë përbën fushatën zgjedhore të parakohshme, përpos një hamendësimi logjiko-ligjor.

Këto fushata zgjedhore, nga procesi zgjedhor në tjetrin vazhdojnë efektivisht të kenë nisje edhe më të herëshme. Kësisoj fushatat zgjedhore, nga një periudhë e kufizuar e përballjes së alternativave elektorale shndërrohet në një paralizë disa mujore institucionale për shkak të tensionit politik.

Bojkoti institucional dhe protesta e nisur me datë 18 Shkurt nga forcat opozitare shërbeu ndër të tjera edhe si një lloj nisje e parakohshme e fushatës zgjedhore. Ndonëse ishte një protestë që në objektin e saj nuk kishte ofertën elektorale për zgjedhjet, periudha e afërt me ditën e zgjedhjeve, kërkesat e lidhura ngushtë me procesin zgjedhor si dhe alternativat apo premtimet e paraqitura shërbyen si nisje e fushatës zgjedhore. Përgjatë zhvillimit të kësaj proteste parazgjedhore, nga pjesëmarrësit u përcollën edhe mesazhe me nota të gjuhës së urrejtjes të cilat kontribuan në krijimin e një klime pasigurie institucionale. Megjithatë, në vazhdim përgjatë fushatës zgjedhore tonet agresive të mesazheve elektorale u zbehën.

Nisja e parakohshme e fushatës zgjedhore u paralelizua në vijueshmëri dhe nga veprimtaritë e mazhorancës qeverisëse e kryesisht të Partisë Socialiste të Shqipërisë (PS). Veprimtaritë e këtij subjekti zgjedhor dhe të përfaqësuesve të saj në qeveri nën sloganin “Për Shqipërinë që duam”, i cili rezultoi më pas edhe slogani elektorale i saj, nisën që në fillim të muajit prill.

Përgjatë këtyre aktiviteteve parazgjedhore, institucionale ose jo, me pjesëmarrjen e Kryeministrit të Republikës apo të anëtarëve të Këshillit të Ministrave u përcollën në vijueshmëri mesazhe elektorale, veçanërisht

prej këtyre të fundit të cilët kishin edhe funksione të rëndësishme koordinimi elektorale.

U vërejt gjithashtu një angazhim i përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore në fushatën zgjedhore të Partisë Socialiste. Këta përfaqësues, në vazhdim me frymën e përcjellë dhe në procese të tjera, në deklarimet e tyre publike lidhën ngushtësisht vijueshmërinë e punëve të përditshme në qeverisjen vendore me përkrahjen politike të qeverisjes qendrore dhe bënë thirrje të hapura elektorale për mbështetje të tyre.

Mos-respektimi i afatit për të bërë fushatë elektorale nga PS u evidentua edhe në cënimin e heshtjes zgjedhore., gjatë së cilës, përfaqësues të këtij subjekti zgjedhor, përcollën drejt qytetarëve mesazhe telefonike me nxitje elektorale⁵⁰.

2) Mungesa e platformave elektorale dhe e diskutimit mbi ofertat elektorale

Ndonëse e nisur disa muaj para afatit ligjor, fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 Qershorit 2017 i mungoi përballja serioze e ofertave elektorale.

Mungesa e kësaj përballje ofertash elektorale reflektoi edhe mungesën formale të publikimit nga pjesa më e madhe e subjekteve zgjedhore të një dokumenti të mirëfilltë të prezantimit të platformave elektorale⁵¹. Edhe subjektet zgjedhore kryesore, të cilat pretendonin të ishin forca qeverisëse të ardhshme, ofruan ose vetëm dokumenta deklamativë ose nuk i dhanë vëmendje argumentave seriozë elektorale.

Mungesa e përballjes së argumentave u shoqërua dhe me protagonizmin e liderëve politikë, të cilët nuk bënë të mundur prezantimin e kandidatave garuese.

Kandidatët garues kryesorë mbetën të fshehur pas siglave elektorale dhe konfliktualitetit të lartë të lidhësive politike. Fenomen ky që vazhdon të thellojë largësinë e llogaridhënies së përfaqësuesit parlamentar me zgjedhësit e tij.

Nga raportimet e Policisë së Shtetit përgjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore rezultoi se u kryen 1 141 tubime elektorale nga 14 subjekte zgjedhore⁵². Sipas raportimit të Policisë së Shtetit, zona elektorale më e ngarkuar me veprimtari elektorale ishte Qarku Tiranë me 194 aktivitete dhe më pak i ngarkuari ishte Qarku Fier me 51 aktivitete. Ndërsa sipas subjekteve zgjedhore, në total rezultoi se Partia Socialiste (PS) zhvilloi 517 tubime, Partia Demokratike (PD) zhvilloi 357 tubime, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) zhvilloi 182 tubime dhe Partia Drejtësi, Integritet dhe Unitet (PDIU) zhvilloi 47 tubime⁵³.

50 Rasti më flagrant i këtyre veprimeve ishte rasti i Bashkisë Tiranë, ku u përcollën ftesa me përmbajtje elektorale nga Kryetari i Bashkisë.

51 KVV në datën 20/06/2017, iu drejtua me kërkesë zyrtare të gjitha subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje për të patur kopje të platformës së tyre elektorale. Në asnjë rast, nuk pati asnjë reagim zyrtar nga të 18-të subjektet.

52 Ligji Nr. 8773, datë 23/04/2001, "Për tubimet", Neni 5, Njoftimi i Policisë së Shtetit, (...) "1. Në rast tubimi në shesh ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit."

53 Nga totali i tubimeve të raportuara nga Policia e Shtetit, rezultoi se u kryen në Qarkun Tiranë PS - 78 tubime, PD - 78 tubime, LSI - 22 tubime, PDIU - 7 tubime; në Qarkun Durrës PS - 30 tubime, PD - 19 tubime, LSI - 5 tubime, PDIU - 2 tubime; në Qarkun Shkodër PS - 39 tubime, PD - 20 tubime, LSI - 5 tubime, PDIU - 2 tubime; në Qarkun Vlorë PS - 9 tubime, PD - 3 tubime, LSI - 5 tubime, PDIU - 1 tubim; në Qarkun Gjirokastrë PS - 43 tubime, PD - 23 tubime, LSI - 20

Tjetër element përsëritës në këtë fushatë ishte nxitja e bojkotit të procesit zgjedhor apo e votës së bardhë. Disa forca politike jo parlamentare dhe me profil të ulët elektoral i bënë thirrje qytetarëve për të bojkotuar procesin zgjedhor. Thirrje kjo si formë proteste e një procesi zgjedhor pa alternativa reale dhe kundër establishmentit politik të krijuar.

Kjo frymë e bojkotimit, ndonëse jo si një aksion i drejtuar politik, u vërejt si rast i paprecedentë në Qarkun Elbasan në Qendrën e Votimit Nr. 2640, në Fshatin Grabovë. Në këtë qendër votimi nuk u paraqit asnjë votues dhe as anëtarët e komisionit nuk votuan. Kjo sjellje bojkotuese u bë e ditur se ishte një manifestim i komunitetit lokal në raport me ofertat politike të paraqitura në vijimësi nga establishmenti politik.

B. Precedentë të rinj të fushatës zgjedhore

Amendimet në Ligjin “Për Partitë Politike” të kryera në seancën e jashtëzakonshme të datës 22/05/2017, kufizuan në masë të madhe përdorimin e materialeve të promovimit elektoral në nivel urban dhe ndaluan reklamën e paguar politike në ofruesit e shërbimit mediatic, kanale televizive dhe transmetues radiofonik. Kufizime dhe ndalime që pas-sollën një fushatë zgjedhore vizualisht jo të ngarkuar në raport me proceset e mëparshme zgjedhore.

Në drejtim të kundërt me këtë imazh të fushatës zgjedhore, nga raportimet e vëzhguesve afatgjatë rezultoi një zhvendosje e fushatave zgjedhore. Kjo fushatë zgjedhore, edhe si një trend i projektuar nga fushatat e mëparshme, ishte e decentralizuar, në nivel baze dhe me organizim lokalist. Organizimi i fushatës zgjedhore u vërejt në formën e ashtuquajtur të takimeve elektorale "derë më derë", duke u shmangur nga tradita e të ashtuquajturave mitingje masive.

Nga raportimet në Bashkitë e vendit⁵⁴, përsa u komunikua, rezultoi se nga subjektet zgjedhore u regjistruan së paku 854 zyra zgjedhore, si ambiente private në funksion të drejtimit dhe organizimit të nxitjes elektorale.

Bashkia me më shumë zyra zgjedhore rezultoi Bashkia Tiranë me 197 zyra të regjistruara, dhe Bashkia me më pak zyra zgjedhore të regjistruara rezultoi Bashkia Lushnjë me 1 zyrë⁵⁵. Këto shifra janë minimaliste sepse në shumë raste, subjektet zgjedhore nuk i regjistruan pranë bashkive zyrat zgjedhore të ngritura.

tubime, PDIU – 0 tubime; në Qarkun Elbasan PS – 86 tubime, PD – 46 tubime, LSI – 33 tubime, PDIU – 15 tubime; në Qarkun Fier PS – 27 tubime, PD – 14 tubime, LSI – 5 tubime, PDIU – 3 tubime; në Qarkun Korçë PS – 41 tubime, PD – 19 tubime, LSI – 3 tubime, PDIU – 3 tubime; në Qarkun Dibër PS – 31 tubime, PD – 24 tubime, LSI – 22 tubime, PDIU – 13 tubime; në Qarkun Berat PS – 47 tubime, PD – 14 tubime, LSI – 22 tubime, PDIU – 1 tubim; në Qarkun Kukës PS – 48 tubime, PD – 56 tubime, LSI – 33 tubime, PDIU – 0 tubime dhe në Qarkun Lezhë PS – 38 tubime, PD – 41 tubime, LSI – 7 tubime dhe PDIU – 0 tubime.

⁵⁴ Udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr. 1, datë 31/05/2017 “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”. Neni 2, (...) “Subjekti zgjedhor është i detyruar që brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi të njoftojë me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse, adresat e sakta të zyrave elektorale. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit administratë dhe bashkisë, bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e materialeve propagandistike”.

⁵⁵ Referuar përgjigjeve zyrtare nga 46 bashki rezultoi se: Qarku Berat kishte 59 zyra zgjedhore; Qarku Dibër 70 zyra zgjedhore; Qarku Durrës 67 zyra zgjedhore; Qarku Elbasan 38 zyra zgjedhore; Qarku Fier 38 zyra zgjedhore; Qarku Gjirokastrë 72 zyra zgjedhore; Qarku Korçë 142 zyra zgjedhore; Qarku Kukës 50 zyra zgjedhore; Qarku Lezhë 67 zyra zgjedhore; Qarku Vlorë 9 zyra zgjedhore dhe Qarku Shkodër 30 zyra zgjedhore.

Sa i përket subjekteve zgjedhore që rezultuan parlamentare në zgjedhjet e 25 qershorit, subjekti me numrin më të lartë të zyrave ishte Partia Socialiste me 465 zyra, pasuar nga partia Lëvizja Socialiste për Integrim me 159 zyra, Partia Demokratike me 117 zyra, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet me 86 zyra dhe Partia Social Demokrate me 1 zyrë⁵⁶.

Numri i lartë i këtyre organizimeve të përkohshme, strukturimi i decentralizuar në nivel baze i fushatës zgjedhore në mungesë të ofertave elektorale, krijoi pikëpyetje mbi objektivat e funksionimit të zyrave zgjedhore. Këto njësi lokale të subjekteve zgjedhore u vërejtën si struktura organizative, të cilat mbartin shenja të drejtimit dhe kontrollit të votës.

Megjithëse për procesin zgjedhor nuk garoi asnjë koalicion parazgjedhor, në zhvillimin e fushatës zgjedhore u vërejt një dakortësi e fshehur ndërmjet Partisë Demokratike dhe Partisë Socialiste në kundërvënie ndaj subjekteve zgjedhore të tjera. Kjo kundërvënie pati kryesisht për objekt partinë Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partinë për Drejtësi, Integritet dhe Unitet, të cilat u anatemuan jo vetëm si përfituese të koalicioneve të mëparshme, por edhe për përdorimin e administratës publike në funksion të interesave partiakë. Akuza ndaj të cilave, kryesisht Partia Lëvizja Socialiste për Integrim iu përgjigj me kundërakuza për lidhje kriminale apo me narko-trafikun të përfaqësuesve të Partisë Socialiste.

Qasja e treguar e grupimeve politike pati ndikimin e vet si në administrimin e procesit zgjedhor ashtu edhe në frymën e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor në nivel lokal.

Marrëveshja e heshtur politike ushqeu dakortësinë në drejtimin e mbarëvajtjes së komisioneve të administrimit. Dakortësia e anëtarësisë përfaqësuese të dyshes PS-PD e vendosi funksionimin e komisionit jashtë frymës balancuese që përmban ligji zgjedhor, gati në një funksionim në unison e të mbyllur ndaj vëzhguesve apo aktorëve të tretë, veçanërisht në raport me problematikat e hasura.

⁵⁶ Ndërkohë parti të tjera ishin Partia Demokracia Sociale me 2 zyra, Partia Fryma e Re Demokratike me 2 zyra, Partia Republikane me 19 zyra, Partia Kristian Demokrate me 2 zyra, Partia Bashkimi Demokristian me 1 zyrë, Partia Aleanca Demokristiane me 1 zyrë, Partia Aleanca Popullore për Drejtësi me 1 zyrë dhe Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen me 1 zyrë.

VIII. FINANCIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

A. Transparenca financiare

Financimi i fushatës zgjedhore dhe i subjekteve politike, si dy çështje të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, vazhdojnë të mbesin një trajtim deklamativ i kuadrit ligjor pa ofruar një adresim të një mekanizmi institucional efektiv.

Problematika më parësore e këtij mekanizmi, përpos moszbatimit të rregullimeve ligjore si kufizimet dhe ndalesat, është mosgarantimi i transparencës.

Mungesa e transparencës mbi të ardhurat dhe shpenzimet e subjekteve zgjedhore dhe partive politike, në parim ngre shqetësimin e kapjes së drejtimit të këtyre subjekteve nga interesa privatë apo të jashtëligjshëm.

Në nxitje të frymës së transparencës në raport me zgjedhësit, KVV i bëri thirrje të gjitha subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve garues të deklarorin para ditës së zgjedhjeve shpenzimet dhe të ardhurat në organizimin e fushatës, si dhe vetëdeklarimin e statusit financiar të kandidatëve⁵⁷. Një detyrim ky jo ligjor, por që do të ndihmonte dhe informonte qytetarët përpara se të votonin lidhur me integritetin financiar të subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve garues.

Kjo Thirrje Publike nuk mori asnjë reagim nga asnjë prej subjekteve zgjedhore apo prej kandidatëve, megjithë vullnetet dhe zotimet e bëra prej tyre për transparencë.

B. Mekanizmi i kontrollit

Mekanizmi ligjor parashikon auditimin e veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore nga ekspertë kontabël të përzgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ekspertët për auditimin e veprimtarisë financiare për fushatën zgjedhore për zgjedhjet e 25 Qershorit, u përzgjedhën në seancën e datës 31/07/2017. Këta ekspertë pritet të kontrollojnë vërtetësinë dhe plotësinë e dokumenteve financiare të subjekteve zgjedhore në organizim të fushatës zgjedhore.

Për herë të parë në këtë proces zgjedhor, me ndryshimet ligjore në Ligjin “Për partitë politike”, në prag të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 Qershorit 2017, u parashikua ndër të tjera, një mekanizëm i ri ligjor për monitorimin e veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore. Sipas këtij mekanizmi, një trupë prej 24 ekspertësh financiarë të përzgjedhur me short nga Komisioni Qendror të Zgjedhjeve, u ngarkuan të ndiqnin veprimtaritë elektorale të subjekteve zgjedhore, nga ku të përlllogarisnin edhe kostot financiare.

Këta ekspertë financiarë duhet të hartojnë raportin përfundimtar të monitorimit në një periudhë më pak se katër muajore nga emërimi, që për

⁵⁷ Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë, Qendrim Publik “Voto Transparencën! Transparenca e gjendjes dhe e burimeve financiare të Kandidatëve dhe e financave të fushatës zgjedhore; si thelbi i formësimit të Integritetit të Procesit Zgjedhor, të të Zgjedhurve dhe Partive Politike”, datë 21/06/2017.

këtë proces zgjedhor është jo më vonë se data 26/11/2017. Nga përvoja e deritanishme ndër zërat më të kushtueshëm në shpenzimet (të ligjshme) e subjekteve zgjedhore kanë qenë kryesisht: ¹veprimtaritë elektorale (takime, mitingje), ²zyrat elektorale / zgjedhore, ³pagesat për komisionerë dhe vëzhgues, dhe ⁴promocioni mediatik (reklamat me pagesë). Katër zëra që duhet të jenë të rendësishme parësore në punën e ekspertëve kontabël të përzgjedhur për auditimin dhe kostimin e fushatës zgjedhore⁵⁸.

IX. MEDIA

Roli i medias, në të tërta format e saj, para dhe përgjatë fushatës zgjedhore është përcaktues në rezultatin e proceseve zgjedhore. Mediat si mjete komunikimi masive, të cilat falë zhvillimeve teknologjike po fitojnë një pozicion të fortë shoqëror, shërbejnë jo vetëm si hapësirë promovimi të alternativave politike, por mund të shndërrohen në mjete të deformimit të opinionit publik. Forca deformuese e opinionit publik të mediave në përvojën universale ka provuar që mund të arrijë deri në përmbytjen e rezultateve elektorale.

A. Amendimet dhe mangësitë e kuadrit ligjor

Amendimet në ligjin “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” në seancën e jashtëzakonshme të datës 22/05/2017 vendosën ndalimin e reklamës politike të paguar në ofruesit e shërbimeve mediatike përgjatës periudhës zgjedhore. Një rregullim që u përball me kontestimin e gjerë të operatorëve mediatikë kryesorë, të cilët edhe kërcënuan për moszbatim të ndalimit që përcaktonte ligji.

Megjithatë, kuadri ligjor ende nuk rregullon reklamat politike, të paguara ose jo, të fshehura ose të drejtëpërdrejtë, jashtë periudhës zgjedhore.

Edhe për shkak të nisjes së fushatave zgjedhore shumë herët, operatorët mediatikë përdoren gjerësisht për përcjelljen e mesazheve elektorale pa asnjë rregullim ligjor. Kuadri ligjor madje nuk e përkufizon se çfarë konsiderohet një “reklamë politike e fshehtë”, e cila keqpërdoret gjerësisht nga operatorët e shërbimeve mediatike gjatë periudhës jo zgjedhore⁵⁹.

⁵⁸ Megjithatë, përpos këtyre katër zërave të sipërmendur, veprimtaria financiare e subjekteve zgjedhore ka një shumësi të lartë kostosh. Kosto këto që mbartin kosto financiare, por jo domosdoshmërisht mbartin një transaksion financiar të drejtëpërdrejtë, si dhe kryhen për interes të fushatave zgjedhore të partive politike, por jo domosdoshmërisht kryhen nga partitë politike. Dy raste këto që i referohen vullnetarizmit apo shërbimeve falas, si dhe fushatë zgjedhore nga të tretët apo “hije”. Nëse mbi vullnetarizmin është miratuar Ligji “Për vullnetarizmin”, i cili është braktisur nga vënia në zbatim, në rastin e fushatës zgjedhore “hije” adresimi ligjor mungon.

⁵⁹ Përsa i përket reklamës politike jashtë periudhës zgjedhore, në dy raste për këtë proces zgjedhor pati qendrim publik të Autoritetit të Mediave Audiovizuale. Me anë të njoftimeve në datat 15/02/2017 dhe 10/05/2017, u bë thirrje për ndalimin e reklamave në operatorët e shërbimeve mediatike, të cilat njoftinin mbajtjen e protestave të zhvilluara

Forma kryesore e keqpërdorimit të kësaj mangësie ligjore në vijimësi u krye me anë të materialeve audio-vizuale të parapërgatitura nga institucione apo parti politike të transmetuara në edicionet informative të operatorëve mediatikë.

Këto materiale të parapërgatitura ndonëse informative, në një formë të fshehtë dhe në raste direkte, u përcjollën mesazhe elektorale.

Tjetër formë e përdorur në kanalet televizive informative, ishin transmetimet e drejtëpërdrejta të veprimtarive të subjekteve zgjedhore. Kohë televizive kjo e dedikuar me efekt elektorale të drejtëpërdrejta dhe që ndër të tjera implikon edhe kosto financiare, duke shmangur kështu amendimet më të reja ligjore.

Nga ana tjetër, rregullimet ligjore të fundit lanë jashtë objektivit të tyre reklamën politike të paguar në mediat e shkruara dhe ato elektronike (portale e rrjete sociale), në periudhën zgjedhore ose jo. Kjo reklamë politike u përdor gjerësisht gjatë fushatës zgjedhore dhe kryesisht në median elektronike.

B. Raportimet e Bordit të Monitorimit të Medias

Bordi i Monitorimit të Medias (BMM) është një strukturë e përkohshme me 7 anëtarë të përzgjedhur përkatësisht nga anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e ngritur pranë Autoritetit të Mediave Audio-Vizive (AMA). Objektivi i kësaj strukture është monitorimi i respektimit të kuadrit ligjor zgjedhor për kohët e transmetimit nga operatorët e shërbimit mediatik. Ky Bord detyrohet të depozitohet për çdo 24 orë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve raportet ditore të kohëve televizive nga operatorët e shërbimeve mediatike në raport me mbulimin mediatik të fushatës zgjedhore. Për këto raportime ditore, me propozim të Bordit ose kryesisht nga trupa e KQZ-së mund merren vendime për sanksionimin e rasteve të mosrespektimit të detyrimeve ligjore përsa i përket kohëve televizive.

Në traditën e proceseve zgjedhore të mëparshme, edhe në këtë proces sjellja e KQZ-së ishte indulgjente në rastet e shkeljeve të rregullimeve ligjore për kohët televizive.

Në kundërshtim tërësor me rregullimin ligjor, jo vetëm që reagimi institucional nuk ishte reagim ditor, por nuk u morën as masa sanksionuese për rastet e shkeljeve. Gjatë seancave ku u morën në shqyrtim raportet javore të Bordit⁶⁰, për rastet e mosbalancimit të kohëve televizive u vendos që vetëm të kërkohet balancimi i minutazheve nga operatorët e shërbimit mediatik.

Në bazë të Kodit Zgjedhor, masë detyruese për balancimin e kohëve mund të aplikohet vetëm ndaj Televizionit Publik, ndërsa për televizionet private, masat e aplikueshme janë gjobat, ose në rastin e përsëritjeve të shkeljeve

nga Partia Demokratike në datat 18 shkurt dhe 13 maj 2017, për të cilat AMA konsideroi se përmbajtja e këtyre reklamave lejohej vetëm në periudhën e zhvillimit të fushatave elektorale. Një veprim në thelb i drejtë në ndalim të reklamës politike jashtëzgjedhore, por një qendrim që do të duhej të ishte më i fortë dhe të adresonte rastet e shumta të reklamës politike të fshehtë jashtë zgjedhore.

60 Seancat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ku u shqyrtuan raportet e Bordit të Monitorimit të Medias u zhvilluan në datat 5, 12, 19, 22 dhe 30 Qershor 2017. Vlen të vlerësohet se, për të dytin proces zgjedhor të përgjithshëm të rradhës, raportet e anëtarëve të BMM-së janë unike me dakortësinë e të gjithë anëtarëve.

ndërpreja e transmetimeve për 48 orë⁶¹. Përpos kësaj, evidentohet se logjika që është përdorur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është kundër frymës së Kodit Zgjedhor. Qasja e institucionit ka qenë në planin afatgjatë, javor apo 4-javor të minutazhit për secilin subjekt⁶².

Në këtë vazhdë, përmendet edhe mospërpunimi sistematik apo lehtësisht i kuptueshëm për publikun e gjerë i informacionit të raporteve ditore të BMM-së.

Nga veprimet akumulative aritmetike të kohës të evidentuar nga raportet televizive ditore përgjatë periudhës zgjedhore 26/05/2017 deri me 23/06/2017, rezulton se në edicionet informative të 4 operatorëve të shërbimeve mediatike kombëtare PS mori 2 724 min, PD mori 2 476 min, LSI mori 1 465 min dhe PDIU mori 267 min⁶³.

Këto kohë televizive reflektojnë një mosrespektim të raportit kohor në edicionet informative “1 për 2” të partive parlamentare që kanë marrë nën 20 përqind vende dhe atyre që kanë marrë mbi 20 përqind të vendeve në parlament⁶⁴.

Ndërsa nga veprimet akumulative aritmetike të kohës televizive të evidentuar nga raportet televizive ditore përgjatë periudhës zgjedhore 26/05/2017 deri me 23/06/2017, rezulton se në transmetimet e drejtëpërdrejta (live) të 4 operatorëve të shërbimeve mediatike të kanaleve televizive informativë më të rëndësishëm PS mori 6 375 min, PD mori 4 429 min, LSI mori 2 016 min dhe PDIU mori 383 min⁶⁵.

61 Në lidhje me raportet e Bordit të Monitorimit të Medias, vërehet se pavarësisht evidentimit të pabarazive dhe mosrespektimit të raporteve të minutazhit mes subjekteve zgjedhore nga raportet e paraqitura në KQZ, nuk u mor asnjë masë administrative ndaj mediave që shkelën detyrimet e Kodit Zgjedhor, lidhur me mbulimin mediatik të fushatës.

62 Kjo bie në kundërshtim me rregullimin ligjor që sanksionet të ndërmerren në nivel ditor, sepse edhe siç duket nga natyra e sanksioneve të mësipërme, ndërpreja e sinjalit, si dhe nga fakti se raportimi i BMM duhet të kryhet në bazë ditore, Kodi Zgjedhor e vendos theksin pikërisht tek ruajtja e barazisë në transmetim përgjatë çdo dite të fushatës zgjedhore.

63 Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Socialiste ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në edicionet informative në: TVSH - 147.47, Top Channel - 283.13, Klan Tv - 323.22, Vizion Plus - 303.89, News 24 - 282.35, Ora News - 298.25, Report Tv - 401.42 dhe Top News - 684.59. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Demokratike ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në edicionet informative në: TVSH - 166.04, Top Channel - 253.08, Klan Tv - 218.8, Vizion Plus - 298.68, News 24 - 219.35, Ora News - 280.52, Report Tv - 525.88, Top News - 513.51. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në edicionet informative në: TVSH - 97.14, Top Channel - 125.75, Klan Tv - 162.26, Vizion Plus - 150.25, News 24 - 185.88, Ora News - 197.25, Report Tv - 257.97, Top News - 288.45. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në edicionet informative në: TVSH - 63.07, Top Channel - 123.37, Klan Tv - 5.13, Vizion Plus - 2.45, News 24 - 60.06, Ora News - 35.48, Report Tv - 38.79 dhe Top News - 33.52.

64 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 81, Edicionet informative të radiotelevizionit publik, (...)”1. Në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizionit publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare, që në zgjedhjet e fundit për Kuvendin kanë marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend. Partitë që kanë marrë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend, përfitojnë kohë transmetimi të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis tyre. Secila nga këto parti përfiton kohë sa dyfishi i kohës që përfiton një parti që ka marrë deri në 20 për qind të vendeve në Kuvend”.

65 Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Socialiste ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në transmetimet e drejtëpërdrejta në: TVSH - 37, Top Channel - 4, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 4, News 24 - 1'254, Ora News - 1'954, Report Tv - 1'665.92, Top News - 1'460. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Demokratike ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në transmetimet e drejtëpërdrejta në: TVSH - 0, Top Channel - 0, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 1'068, Ora News - 1'422, Report Tv - 930, Top News - 1'009. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në transmetimet e drejtëpërdrejta në: TVSH - 0, Top Channel - 0, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 507, Ora News - 514, Report Tv - 412, Top News - 583. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në transmetimet e drejtëpërdrejta në: TVSH - 0, Top Channel - 0, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 178, Ora News - 9, Report Tv - 196 dhe Top News - 0.

Për sa i përket specialeve të transmetuara në 8 operatorë të shërbimeve mediatiche, nga të cilët 4 kanalet televizive kombëtare dhe 4 kanalet televizive informativë, nga veprimet akumulative aritmetike të kohës së evidentuar nga raportet televizive ditore përgjatë periudhës zgjedhore 26/05/2017 deri me 23/06/2017, rezulton se PS ka marrë 68 min, PD ka marrë 2 918 min, LSI ka marrë 117 min dhe PDIU ka marrë 210 min⁶⁶.

Kohët televizive dedikuar subjekteve zgjedhore me mbulim të drejtëpërdrejtë të veprimtarive të tyre elektorale, si dhe specialet që iu kushtohen atyre, më së pari ngrenë pikëpyetje nëse konsiderohen reklamë politike.

Ndërkohë lidhur me kohët televizive të dedikuara ngrihen pikëpyetje mbi kostot e tyre financiare dhe mbi pozicionin e tyre në raport me ndalimin e reklamës politike të paguar.

Në një rast të kundërt, edhe nëse kjo kohë televizive do të konsiderohet e vendosur në shërbim pa pagesë dhe jo si reklamë politike, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” shprehet se “radiot dhe televizionet private nuk vënë kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve politike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të tyre”⁶⁷.

C. Përdorimi i “kasetave” dhe roli kritik i mediave

Problematika e përdorimit prej ofruesve të shërbimit mediatic të materialeve audiovizive të përgatitura nga subjektet zgjedhore vazhdoi të ishte një shqetësim edhe në këtë fushatë zgjedhore.

Sipas vendimarrjes së KQZ-së të vitit 2013, operatorët mediaticë detyrohen që përgjatë fushatës zgjedhore të transmetojnë materialet audiovizive (të ashtuajtura “kasete”) të përgatitura nga subjektet zgjedhore në lidhje me veprimtaritë e tyre zgjedhore. Në këtë proces, në adresim të kësaj çështje, pati dy reagime zyrtare me rëndësi. Avokati i Popullit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizion Shqiptar (RTSH) kundërshtuan vendimarrjen rregulluese të mëparshme të bërë nga KQZ-ja⁶⁸.

⁶⁶ Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Socialiste e Shqipërisë ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në reportazhe speciale në: TVSH - 2, Top Channel - 3, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 49, Ora News - 8, Report Tv - 6, Top News - 0. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Demokratike ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në reportazhe speciale në: TVSH - 0, Top Channel - 3, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 296, Ora News - 419, Report Tv - 940, Top News - 1260. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në reportazhe speciale në: TVSH - 0, Top Channel - 0, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 23, Ora News - 30, Report Tv - 61, Top News - 0. Përgjatë periudhës 26/05/2017 deri me 23/06/2017, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet ndër të tjera ka marrë këtë minutazh në reportazhe speciale në: TVSH - 0, Top Channel - 0, Klan Tv - 0, Vizion Plus - 0, News 24 - 85, Ora News - 0, Report Tv - 99 dhe Top News - 26.

⁶⁷ “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 84, Fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private, (...) “1. Në radiot dhe televizionet private, pasqyrimi i fushatës zgjedhore bëhet vetëm në edicionet e zakonshme dhe të posaçme informative. Radiot dhe televizionet private nuk vënë kohë transmetimi në dispozicion të subjekteve politike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të tyre. Informacionet mbi aktivitetet të fushatës zgjedhore, që përgatiten dhe transmetohen në edicionet informative, bazuar në materiale të vëna në dispozicion nga subjektet zgjedhore, duhet të identifikohen qartë, në përputhje me udhëzimet e KQZ-së.”

⁶⁸ Në rekomandimin e Avokatit të Popullit të datës 04/05/2017 drejtuar Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, u argumentua pavlefshmëria formale dhe antikushetueshmëria në përmbajtje e vendimarrjes në fuqi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që e rregullon ligjërisht çështjen. Për rrjedhojë, Avokati i Popullit i kërkoi Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Inicimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të procedimit administrativ për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të KQZ-së, nr. 503 datë 3.06.2013”. Ndërsa në komunikimin e datës 23/05/2017, Drejtori i Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar iu drejtua me letër kryetarëve të katër partive politike më të mëdha parlamentare. Me anë të këtij komunikimi publik, iu bë e ditur se Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) përgjatë fushatës zgjedhore nuk do të pranonte

Media e konsideruar si pushteti i katërt në shoqëri, mbart një rol publik të fuqishëm dhe në periudha zgjedhore duhet të qendrojë si një aktor objektiv, madje kritik, ndaj platformave dhe premtimeve elektorale. Përpos analizave të ofruara nga ekspertët e fushave të ndryshme, edicionet informative, programacioni dhe debatet, shërbejnë si instrumenta të formësimit të opinionit publik me një sens kritik ndaj platformave elektorale.

Ajo që u vërejt në këtë fushatë, në vijimësi të përvojës së mëparshme në vend, ishte një sens reklamimi i fushatës zgjedhore nga mediat dhe jo një përthyerje objektive e saj.

Operatorët mediatikë shërbyen më shumë si një medium përcjellës dhe jo një medium i të bërit kritikë ndaj një fushate zgjedhore, e cila ndër të tjera ishte pa platforma elektorale.

X. PROCESI I ANKIMIMEVE

Kuadri ligjor mbi ankimimet për çështjet zgjedhore rregullohet sipas ankimimit administrativ dhe ankimimit gjyqësor. Ankimimi administrativ përbëhet nga dy shkallë, ku shkalla e parë janë Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), të cilët për këtë proces ishin 90, dhe shkalla e dytë është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ndërsa ankimimi gjyqësor është objekt i veprimtarisë së trupës së Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit të Rrethit Tiranë.

Në rezultante të këtij procesi zgjedhor, u vërejt një numër shumë i ulët i ankimeve si në nivel administrativ ashtu dhe në atë gjyqësor, si në periudhën para ditës së zgjedhjeve, edhe pas kësaj dite.

Drejt Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për këtë proces zgjedhor nuk pati asnjë ankimim para ditës së zgjedhjeve dhe vetëm pesë ankime pas ditës së zgjedhjeve, nga katër subjekte zgjedhore të ndryshëm⁶⁹. Ndërsa Kolegji Zgjedhor⁷⁰ përgjatë vitit 2017 u investua jo vetëm në çështje që i përkisnin

transmetimin e materialeve audiovizuale të përgatitura nga subjektet zgjedhore dhe se do të mbulohej nga vetë gazetarët e RTSH-së.

69 Nga këto një u tërhoq, një kishte objekt administrativ dhe tre të tjerët kishin për objekt rinumërimin dhe rivlerësimin e votave në Qarkun e Tiranës dhe Qarkun e Beratit. Në rastet e tre padive me objekt rinumërimin dhe rivlerësimin e fletëve të votimit në disa qendra votimi për dy Qarqet, kërkesat u pranuan plotësisht nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

70 Me dekretimin e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me datë 09/12/2016 Këshilli i Lartë i Drejtësisë hodhi shortin për përzgjedhjen e 8 anëtarëve të Kolegjit Zgjedhor. Nga anëtarët e përzgjedhur për të qenë pjesë e trupës së Kolegjit Zgjedhor, dy prej tyre ishin anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Një prej anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Sokol Çomo, i përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përgjatë seancës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë ngriti dy shqetësime në lidhje me shortin e kryer në datë 09/12/2016. Anëtar, pasi kërkoi miratimin e një procedure për mbarëvajtjen e zhvillimit të përzgjedhjes së anëtarëve, e cila nuk u miratua, ngriti pikëpyetje se si ishte kryer procedura e verifikimit të gjyqtarëve për t'u bërë pjesë në short, nëse ata ishin në përputhje me ligjin dhe cili ishte protokollin e mekanizmit të shortit që u mbajt në ambientet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Mbi

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHIMIT

procesit zgjedhor të 25 Qershorit 2017. Nga 10 vendime të marra në total, nga kjo trupë gjyqësore përgjatë këtij viti, 2 kishin të bënin me procesin e ashtuquajtur të dekriminalizimit dhe një me vakancat e krijuara në Këshillin Bashkiak të Tiranës. Ndërsa 7 vendimet e tjera kishin të bënin me procesin zgjedhor dhe i përkisnin periudhës përpara ditës së zgjedhjeve.

A. Procesi i ankimeve para ditës së zgjedhjeve

Elementët kyç që karakterizuan paditë në Kolegjin Zgjedhor para ditës së zgjedhjeve ishin më së shumti të lidhura me situatën e bojkotimit insitucional dhe me rrezikun e bojkotit të zgjedhjeve nga ana e subjekteve zgjedhore të Partisë Demokratike dhe Partisë Republikane. Bojkot që pas Marrëveshjes Politike të 18 Majit, u pasua nga shtyrja e datës së zgjedhjeve si dhe nga regjistrimi i disa subjekteve zgjedhore përtej limitit kohor ligjor.

1) Kontestime mbi afatin ligjor të regjistrimit të subjekteve zgjedhore

Partia Aleanca Popullore dhe Partia Ambientaliste Agrare depozituan ankimimet përkatëse në Kolegjin Zgjedhor për procedurën e ndjekur për miratimin e listave shumëmemërore të një sërë subjektsh. Ankimimet argumentuan se subjektet zgjedhore i kishin depozituar listat shumëmemërore me datë 29/04/2017, në shkelje të pretenduar të afatit 50 ditor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, i cili përcaktonte datën 28/04/2017 si afat fundor.

Kolegji Zgjedhor nuk mundi të shprehej për themelin e çështjes, duke qenë se në të dyja rastet palët paditëse i tërhoqën paditë dhe për pasojë gjykimi u pushua⁷¹.

Në rastin e padisë së ngritur nga subjekti Partia Aleanca Popullore vërehet një element shqetësues në sjelljen e trupës së Kolegjit Zgjedhor të përzgjedhur për gjykimin e çështjes. Ndryshe nga Partia Ambientaliste Agrare, e cila u tërhoq përpara nisjes së shqyrtimit gjyqësor, Partia Aleanca Popullore u tërhoq përgjatë shqyrtimit të çështjes në seancën e datës 22/05/2017. Përgjatë diskutimeve në seancë të kësaj çështje, trupa e Kolegjit Zgjedhor informalisht i la të kuptohej palës paditëse se ishte në interes të saj të tërhiqej⁷².

Vendimmarrja e Kolegjit Zgjedhor në këto çështje, ndonëse për çështje minore në dukje si tejkalimi i një afati prej 24 orësh, do të ishte me shumë vlerë dhe do të përbënte një precedent të fortë. Arsyetimi që do të kryente Kolegji Zgjedhor në çdo rast do të përbënte precedent për vlerësimin në vijueshmëri të një prej çështjeve më të diskutuara në administrimin e proceseve zgjedhore siç është respektimi i afateve procedurale. Nxitja për

këtë fakt, duhet theksuar se në vazhdim nuk u bë i ditur asnjë qëndrim zyrtar i institucionit dhe nuk pati asnjë reagim tjetër mbi vërtetësinë ose jo të akuzave, apo mbi situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

⁷¹ Heqja dorë prej padive në të dyja rastet, u krye edhe si pasojë e arritjes së Marrëveshjes Politike të 18 Majit dhe në kushtet e shtyrjes së datës së zgjedhjeve me Dekret të Presidentit, gjë që nënkuptonte rillogaritjen e afatit 50 ditor, në raport me datën e re të zgjedhjeve.

⁷² Veçanërisht njëri prej anëtarëve të trupës së Gjykatës pati komunikim verbal, pa regjistrim audio, me përfaqësuesin e subjektit pas së cilit, ky i fundit u tërhoq.

t'u tërhequr, e shfaqur informalisht prej trupës së Kolegjit Zgjedhor në formë këshillimore ndaj palës paditëse, reflektoi një vullnet të kësaj trupe për të “mos ndërhyrë” në një çështje me gravitet të lartë të diskutimit politik.

Në ankimmimin e tretë të depozituar nga Partia Forca Rinia, u kërkua anulimi i vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për regjistrimin e Partisë Demokratike (PD) dhe Partisë Republikane (PR) si subjekte zgjedhore, në rezultante të Marrëveshjes Politike. Akte këto që u pretenduan nga pala paditëse se ishin marrë në shkelje me afatin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor. Trupa e Kolegjit Zgjedhor në vendimmarrjen e saj argumentoi mungesën e legjitimitetit aktiv të Partisë Forca Rinia, si një subjekt që nuk kishte interes të ligjshëm për të vënë në lëvizje Kolegjin për këtë çështje. Sipas Kolegjit Zgjedhor, Partia Forca Rinia nuk kishte të drejtë të paraqiste padi për çështjen konkrete dhe për pasojë padia e saj u rrëzua⁷³.

Në lidhje me këtë vendim të Kolegjit Zgjedhor, argumentohet se fakti që Partia Forca Rinia ishte pjesëmarrëse në zgjedhje, ishte tregues i mjaftueshëm i interesit të saj konkret, sepse si konkurente në këtë proces zgjedhor ajo ishte e cënuar prej përfshirjes së partive të tjera në garën elektorale, përtej afateve. Nëse ndiqet arsyetimi i përdorur, sipas të cilit subjektet zgjedhore nuk kanë interes konkret në ngritjen e një padie të tillë, atëherë arrihet në përfundimin se askush nuk mund të ankohet për vendimmarrjen e KOZ-së me këtë objekt.

Së fundmi, në këtë kategori çështjesh ishte edhe padia e ngritur nga z. Dragua Ceka, kundër vendimit të KOZ-së, e cila refuzoi kërkesën e tij për regjistrim si kandidat i propozuar nga zgjedhësit për shkak të tejkalimit të afateve. Kandidati e argumentoi këtë tejkalim, me rivendosjen në afat që u krye edhe për subjektet zgjedhore për t'u regjistruar përtej përcaktimit ligjor. Kolegji Zgjedhor ripohoi se dokumentacioni për regjistrimin si kandidat të paditësit, ishte dorëzuar përtej afatit ligjor. Në argumentimin e kësaj trupe, rivendosja në afat për t'u regjistruar vlente për ato parti politike që kishin qenë pjesë e marrëveshjes politike dhe jo për të tjerë, ndaj për këtë arsye padia u rrëzua.

Në rezultante, ajo që vërejt në vendimmarrjen e Kolegjit Zgjedhor ishte një sjellje prej një trupe gjyqësore që u përpoq të mos çënojë *status quo*-në e administrimit politik të procesit zgjedhor. Fakt ky i vërejtur haptazi në sjelljen e trupës së Kolegjit Zgjedhor në rastin e padisë së Partisë Aleanca Popullore dhe në vendimmarrjen e saj në rastin e padisë së Partisë Forca Rinia.

2) Përcaktimi i subjekteve zgjedhore parlamentare dhe joparlamentare

“Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” subjektet zgjedhore dhe koalicionet e subjekteve zgjedhore që zotërojnë mandate parlamentare i përjashton nga detyrimi për dorëzimin e listave mbështetëse të nënshkrimeve

⁷³ Kolegji Zgjedhor në këtë rast nuk e mori në shqyrtim përmbajtjen e padisë, pra faktin e shkeljes ose jo të depozitimit të kërkesës dhe të miratimit të regjistrimit si subjekt zgjedhor nga KOZ të Partisë Demokratike dhe të Partisë Republikane përtej afateve ligjore. Paditësi u konsiderua jo legjitim, qendrim i mbështetur në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe të asaj Kushtetuese, në bazë të të cilave subjekti i cili vendos në lëvizje gjykatën (në përgjithësi) duhet të ketë një interes vetjak konkret për çështjen që parashtron. Në rrjedhojë të këtij argumenti ligjor, trupa e Kolegjit Zgjedhor arsyetoi se Partia Forca Rinia kishte parashtruar një padi duke qenë palë me interes në çështje.

për regjistrimin e listave shumëemërore të kandidaturave garuese. Rregullimi ligjor mbetet i paqartë në përkufizimin e “zotërimit të mandatit të paktën 6 muajt e fundit”, për shkak se nuk përcaktohet referenca kohore që duhet marrë në konsideratë⁷⁴.

Mbi këtë çështje, partia politike “Lista e Barabartë” iu drejtua Kolegjit Zgjedhor me datë 07/04/2017. Subjekti politik i regjistruar si subjekt zgjedhor iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për konstatimin e vërtetimit të plotësimit të kushtit për zotërimin e mandatit të deputetit të paktën 6 muajt e fundit, por për këtë KQZ-ja nuk kishte marrë ende vendim. Me objekt detyrimin e KQZ-së për të marrë vendim ndaj çështjes dhe konstatimin e vërtetimit të zotërimit të mandatit, subjekti në fjalë depozitoi padi në Kolegjin Zgjedhor.

Trupa e Kolegjit Zgjedhor në vendimmarrjen e datës 14/04/2017, pranoi padinë e ngritur dhe përcaktoi detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për t’u shprehur në lidhje me kërkesën. Ndonëse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në seancën e datës 20/04/2017 e mori në shqyrtim ekzekutimin e vendimit të Kolegjit Zgjedhor, sërish në fund të mbledhjes nuk u mor asnjë vendim.

3) Kontestime për përcaktimin e anëtarit të tretë dhe të katërt të GNV-ve

Për këtë proces⁷⁵, kjo problematikë u parashtrua nëpërmjet padisë së ngritur nga Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI). Ky subjekt paditi vendimin e KQZ-së që e vendosi atë në rradhët e partive parlamentare qeverisëse së bashku me PDIU dhe duhej të përzgjidhnin me short midis tyre anëtarin e tretë të GNV-ve. Kolegji Zgjedhor argumentoi se PDIU nuk kishte qenë pjesëmarrëse në koalicionin parazgjedhor me partinë qeverisëse dhe as nuk kishte qenë e tillë në zgjedhjet e kaluara. Për këtë arsye vendosi ndryshimin e vendimit të KQZ-së, duke caktuar vetëm LSI-në si subjektin që kishte të drejtë të propozonte anëtarin e tretë të GNV-ve. Dy subjektet e tjera zgjedhore PDIU dhe PR, sipas Kolegjit Zgjedhor duhej të konkurronin në short për anëtarin e katërt, si parti të opozitës qeverisëse.

Në rastin në fjalë, Kolegji Zgjedhor gjykoj çështjen duke ndjekur precedentin e vitit 2009, por jo arsyetimin e kryer në vitin 2015, për mënyrën e caktimit të anëtarëve të GNV-ve. Në thelbin e tyre, këto precedentë ndryshojnë në momentin e referencës që marrin për vlerësimin e shumicës qeverisëse. Në rastin e parë merret në konsideratë për referencë koalicioni parazgjedhor dhe në precedentin tjetër koalicioni paszgjedhor⁷⁶.

⁷⁴ Me synim rregullimin e kësaj dispozite, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ndërmori një projekt-udhëzim, por që nuk mori shumicën e cilësuar të votave të anëtarëve për t’u miratuar në seancën e datës 16/02/2017.

⁷⁵ Përcaktimi i partive parlamentare që përzgjedhin anëtarin e tretë dhe të katërt në grupet e numërimit të votave është bërë objekt i vendimmarrjes së Kolegjit Zgjedhor si në procesin zgjedhor të viti 2009 ashtu dhe në vitin 2015.

⁷⁶ Në rastin në fjalë, duke marrë në konsideratë koalicionet parazgjedhore, Kolegji Zgjedhor vlerësoi se PDIU-ja ashtu si edhe PR-ja nuk kishin qenë pjesë e koalicionit parazgjedhor qeverisës. Kështu si parti parlamentare me më shumë se dy deputetë, ato kishin të drejtën për të konkuruar në shortin për caktimin e anëtarit të katërt të GNV-ve. Ndërsa subjekti zgjedhor që kishte të drejtë të përzgjidhte anëtarin e tretë të GNV-ve ishte Lëvizja Socialiste për Integrim.

4) Zëvendësimi kryesisht i anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve

Pranë Kolegjit Zgjedhor u ngrit gjithashtu padi nga subjekti z. Piro Celohoxhaj, në cilësinë si ish-sekretar KZAZ-je, i zëvendësuar prej KOZ-së (pas përfshirjes së PD si subjekt zgjedhor), i cili e ka kundërshtuar vendimin e këtij organi duke kërkuar edhe dëmshpërblimin përkatës. Kolegji konkludoi se natyra e padisë i përket juridiksionit civil (në kontekstin e marrëdhënieve të punës) dhe si e tillë nuk mund të gjykohej prej tij. Vlen të përmendet fakti se ka efektivisht parregullsi në vendimmarrjen e KOZ-së për çështjen konkrete, si dhe për të gjitha zëvendësimet e tjera të sekretarëve dhe anëtarëve të KZAZ-ve. Në bazë të Kodit Zgjedhor zëvendësimi nuk mund të ndodhë më vonë se 30 ditë nga data e zgjedhjeve, ndërkohë që KOZ-ja mori vendim në datë 31 maj.

B. Procesi i ankimeve pas ditës së zgjedhjeve

Rinumërimi i fletëve të votimit për disa Qendra Votimi në Qarkun e Tiranës ishte praktika më e rëndësishme ankimore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për këtë proces zgjedhor. Me ankimimin e subjektit zgjedhor Partia Socialiste (PS) dhe kryesisht të subjektit zgjedhor Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) u krye rinumërimi i fletëve të votimit për 62 Qendra Votimi nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Interesimi i këtyre dy subjekteve zgjedhore për këtë proces rinumërimi ishte mundësia e lëvizjes së një mandati për rreth 40 vota në këtë Qark pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, nga Partia Socialiste për Partinë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Rinumërimi dhe rivlerësimi i kryer nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për këtë rast shënoi një numër të lartë rinumërimi të qendrave të votimit, të krahasueshme me procesin për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Tiranë në Zgjedhjet Vendore të 8 Majit 2011 si dhe në Qarkun Kukës në Zgjedhjet Parlamentare të 23 Qershorit 2013.

Edhe pas procesit të rinumërimit në procesin zgjedhor të 25 qershorit 2017, si në pjesën më të madhe të praktikave të mëparshme të rinumërimeve dhe të rivlerësimeve, nuk pati “përmbysje” të rezultatit. Përpos një mospërputhshmërie të rezultateve në pjesën më të madhe të qendrave të votimit, ku në pak raste marzhet e mospërputhjes ishin relativisht të larta, në rezultante nuk u prek thelbi i rezultatit.

Ajo që mbetet shqetësuese dhe që vazhdon t’a ushqejë dyshimin për procesin e numërimit të kryer është se në rastet e rinumërimit të sipërpërmendura, rezultatet përfundimtare jo vetëm që nuk janë identike me të mëparshmet, por evidentohen raste ndryshimi me një marzh përtej dyshimit të arsyeshëm të një gabimi njerëzor.

Në vijueshmëri të këtyre rezultateve të ndryshueshme, me të drejtë ngrihet pikëpyetja lidhur me tërësinë e rezultateve dhe kryesisht në raport me dëmtimin e mundshëm të subjekteve zgjedhore, të cilat nuk janë pjesë e procesit të administrimit të zgjedhjeve.

XI. INSTITUCIONE TË ANGAZHUARA DHE DENONCIMET

Përpos strukturave të posaçme institucionale të hetimit apo atyre të monitorimit të aparatit ekzekutiv shtetëror, një rol po aq të vlefshëm mbart dhe angazhimi qytetar për të denoncuar. Sado kapacitete në dispozicion apo ekspertizë të lartë të kenë strukturat përgjegjëse të ngarkuara, angazhimi qytetar mbetet përballja më e mirë kundrejt shfaqjeve korruptive në administratën publike.

A. Institucionet e angazuara në proces

Në zbatim të Marrëveshjes Politike të 18 Majit 2017, u krijua trupa ndërministrorë Task-Force për mbikëqyrjen e përdorimit të burimeve të administratës publike në fushatën zgjedhore⁷⁷.

Kjo trupë u ngarkua në mbikëqyrje të procesit dhe në ndihmë të ndërveprimit institucional, ku përfshiheshin Prokuroria e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Njësitë e Qeverisjes Vendorë (NJQV), e të tjerë. Veprimtaria e kësaj trupe u rregullua nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 473, datë 01/06/2017, i cili shfuqizoi Urdhrin e mëparshëm të Kryeministrit të vendit Nr. 65, datë 12/05/2017.

Në këtë funksion, kjo trupë kreu pesë mbledhje në periudhën më pak se një mujore të funksionimit të saj, përgjatë të cilave Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë gëzoi statusin e vëzhguesit.

1) Veprimtaria e Grupit Task-Force

Elementi pozitiv i kësaj trupe ishte përpjekja për një veprim ndërinstitutional në adresim të problematikave në fushatat zgjedhore. Ndërveprim që vihet re të mungojë në tërë vijueshmërinë institucionale në vendin tonë. Megjithatë, në tërë frymën e kuadrit ligjor, funksioni mbikqyrës dhe drejtues i proceseve zgjedhore parashikohet të kryhet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve⁷⁸. Në fakt, nga ana e tij, ky institucion tradicionalisht është munduar të qendrojë pasiv në këtë drejtim duke ruajtur një staturë të administrimit sa më formal të procesit.

Momenti i ngritjes dhe afati i funksionimit, e bënë që në nisje funksionimit e Grupit Task-Force jo efikas në përballjen reale të problematikave. Gjithashtu, mospasja e kapaciteteve logjistike, e një kuadri ligjor të detajuar në instrumenta ligjorë dhe mosbashkëpunimi i treguar nga administrata

⁷⁷ Trupa Task-Forcë kryesohej nga ZëvendësKryeministri dhe përbëhej nga 10 anëtarë: Ministri i Punëve të Brendshme, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Arsimit dhe Sportit, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Ministri i Shtetit për Çështje Vendorë, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, Drejtori i Departamentit të Administratës Publike, Drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtori i Parandalimit dhe Administrimit të Parave në Ministrinë e Financave. Të ftuar në ecurinë e mbledhjeve të Trupës së Task-Force ishin përfaqësues të katër institucioneve si Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, Avokati i Popullit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Ky organizim u konstitua me datë 05/06/2017 dhe i zhvilloi seancat në datat 05/06/2017, 16/06/2017, 20/06/2017, 23/06/2017 dhe 25/06/2017.

⁷⁸ "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Neni 21, Kompetencat e KQZ-së, KQZ-ja ka këto kompetenca: (...) "1. Nxjerr, në bazë dhe për zbatim të ligjit dhe brenda sferës së juridiksionit të saj, vendime dhe udhëzime me fuqi juridike të përgjithshme në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Merr vendime për njësimin e praktikave zgjedhore. 3. Drejton dhe kontrollon kolegjialisht, nëpërmjet çdo anëtarë ose strukturave të saj, procesin parazgjedhor dhe atë zgjedhor. (...) 26. Kryen detyra të tjera, që burojnë nga ky Kod ose nga ligje të tjera dhe që sipas këtij Kodi nuk kryhen nga komisionet e niveleve më të ulëta."

publike ndaj kësaj trupe në punën e saj, ishin elementë të tjerë që ndihmuan në një punë që nuk solli efekte realë në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Sensi mosbashkëpunues ndaj Task-Forcës, u manifestua së pari në mungesën përgjatë seancave të mbledhjeve të saj të përfaqësuesve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Ministrave të përzgjedhur nga Mazhoranca⁷⁹.

Gjithashtu, sensi haptazi mosbashkëpunues në kundërshtim me ligjin u vërejt në marrëdhënien e administratës publike me Ministrat “teknikë”. Shembull për këtë ishte ajo e njërive të qeverisjes vendore, ku nga 61 NJQV vetëm 38 u përgjigjën kërkesave të Task-Forcës. Ndër këto njësi, por dhe me e madhja në vend, ishte Bashkia Tiranë, e cila nuk përmbushi detyrimin për t’i përcjellë informacion trupës Task-Force.

Gjithashtu, u vërejt një mungesë transparence edhe në punën e këtij grupi institucional. Për shkak edhe të kontekstit të përplasjeve politike apo edhe të besimit të ulët qytetar tek institucionet, veprimtaria e Task-Forcës ushquu në publik një lloj klime intimidimi në tërësi ndaj trupës së administratës publike.

Në fund të veprimtarisë së tij me mbylljen e procesit zgjedhor, Grupi Task-Force me datë 17/08/2017 publikoi një dokument përmbledhës mbi ecurinë e punës.

Dokumenti voluminoz me titull “Material Përmbledhës” u shoqërua edhe me tetë anekse voluminozë, të cilët përmbanin të sistematizuar raportimet e vetë institucioneve si dhe komunikimin zyrtar me to të kryer nga Task-Force. Një sjellje kjo për t’u vlerësuar në punën e kryer si model pozitiv institucional dhe në sigurimin e transparencës së duhur.

Ajo që meriton të tërhiqet vëmendje është domosdoshmëria për ndjekjen institucionale dhe rigorozë të gjetjeve të këtij raportimi. Një detyrim si për institucionet përgjegjëse në adresimin e shkeljeve të evidentuara, ashtu dhe për t’u patur parasysh në amendimin e kuadrit ligjor në integral.

2) Institucione të tjera të angazhuara

Që prej krijimit të institucionit kushtetues të Avokatit të Popullit, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, përgatitjet për procesin zgjedhor të 25 Qershorit kanë shënuar rolin më aktiv të titullarit të këtij institucioni. Në përgatitjet e këtij procesi zgjedhor, Avokati i Popullit ka përcjellë një tërësi rekomandimesh ndaj institucioneve përgjegjëse në nxitje të mbarëvajtjes dhe ligjshmërisë.

Me anë të gjashtë rekomandimeve, Avokati i Popullit i bëri thirrje titullarëve të institucioneve më të përfshira për zbatimin e ligjshmërisë dhe sigurimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor.

Çështja kryesore që adresohet në këto rekomandime ka të bëjë me bëjë me mospërdorimin e administratës publike, në nivel qendror dhe atë vendor.

Ndër sektorët e administratës publike më të prekur dhe më të kritikuar për përdorim në fushatat zgjedhore janë stafet pedagogjike të nivelit arsimor të mesëm. Kjo edhe për specifikën e shtuar, që përdorimi i stafit pedagogjik shoqërohet edhe me përfshirjen e nxënësve në moshë madhore ose jo. Kjo e

⁷⁹ Përpjekja e Grupit Task-Forcë për nënshkrimin e një Memorandumi Bashkëpunimi për koordinimin e punës nuk u realizua me argumentimin e mungesës së kohës fizike të Prokurorit të Përgjithshëm për të qenë i pranishëm.

fundit e agravon edhe më shumë këtë shkelje në përdorimin e administratës jo vetëm si përfshirje të personave jo-madhorë, por edhe si cënim në thelb të vlerave demokratike që institucionet arsimore duhet të mbartin dhe të përcjellin.

Përsa i përket këtij procesi zgjedhor, Ministria e Arsimit dhe Sportit znj. Lindita Nikolla i përcolli Drejtorive Rajonale Arsimore urdhërin për mospërdorimin e institucioneve arsimore për qëllime politike.

Një veprim me vlerë si afirmim vullneti institucional, por që ligjërisht nuk mbarti asnjë efekt.

Kontrolli i Lartë i Shtetit përbën një nga institucionet më të rëndësishme të kontrollit të zbatueshmërisë së kuadrit ligjor dhe kryesisht të mirëpërdorimit të fondeve publike.

Për shkak të impaktit politik dhe rrezikut të keqpërdorimit që mund të kishin raportet dhe gjetjet e kryera nga ky institucion, sidomos përgjatë fushatës zgjedhore, me Urdhër të titullarit të tij u kërkua mos publikimi në faqen e internetit i vendimeve të Kryetarit mbi auditimet e ushtruara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën 23 Maj – 27 Qershor.

B. Denoncimet për drejtim të votës

Ajo që është vërejtur si problematika më madhore në denoncimin qytetar të rasteve që çenojnë procesin zgjedhor, ka të bëjë me besimin tek institucionet dhe tek zbatimi i ligjit.

Në vijimësi vërehet një ulje drastike e besimit të qytetarëve tek institucionet publike dhe në veçanti tek ato të hetimit dhe gjykimin. Humbje besimi që i ka rrënjët tek performanca e dobët, efikasiteti i ulët apo tek përfshirja e këtyre institucioneve nën tryshinë e një sistemi korruptiv sistematik.

Përsa i përket mbarëvajtjes së këtij procesi zgjedhor dhe fushatës zgjedhore, instrumentat ligjorë në funksion të qytetarëve për denoncimin e fenomeneve korruptive dhe të abuzivizmit mund të kategorizohen në dy: mekanizmat ekzekutivë dhe format alternative.

Përsa i përket mekanizmave të krijuar si forma alternative apo si instrumenta të krijuar enkas për të mundësuar denoncimin e fenomeneve anti-ligjore prej qytetarëve, rezultoi se ato munguan në efikasitet. Kjo mungesë efikasiteti, përpos besimit të ulët qytetar, mund t'i delegohet edhe transparencës së ulët dhe mosparashikimit ligjor procedural për denoncimet. Në çdo rast, mekanizmat e ngritur shfaqën mungesë transparence për ecurinë e tyre dhe nuk ofruan asnjë rregullim ligjor se si do të ndiqeshin denoncimet në rrugë ligjore.

1) Mekanizmat alternativë të denoncimit

Në asistencë të qytetarëve për të denoncuar format e korrupsionit ishin strukturat alternative të ngritura përgjatë legjislaturës së fundit parlamentare. Ndër këto është faja në internet “Stop Korrupsionit”⁸⁰ dhe aplikacioni për

⁸⁰ Përsa i përket faqes së internetit “Stop Korrupsionit”, zyrtarisht u raportuan tetë raste denoncimesh të kryera në lidhje me fushatën zgjedhore, nga të cilat tre u referuan në Prokurori.

telefonat celularë “Komisariati Dixhital”⁸¹. Të dyja këto forma alternative përdorin teknologjinë për të lehtësuar denoncimin e qytetarëve në mënyrë sa më të thjeshtë. Dy platforma këto të përhershme, për shumë kohë të mediatizuara, por për të cilat nuk u bë kujtesë publike si një mundësi më shumë denoncimi përgjatë procesit zgjedhor.

Në raport me këtë proces zgjedhor pati dy përpjekje për t'i mundësuar qytetarëve instrumenta për të denoncuar shfaqjet korruptive. Të dyja këto u ngritën specifikisht në mbarëvajtje të fushatës zgjedhore dhe referuar vetëm periudhës zgjedhore.

Problematika kryesore e vënë re në funksionimin e tyre ishte momenti i vonët kohor kur ato u bënë efektive dhe mungesa e transparencës mbi to.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgatiti dhe publikoi një aplikacion për telefona celularë “Voto 2017”. Ky aplikacion, përpos qëllimit për të qenë një instrument për denoncimin e rasteve korruptive, kishte për qëllim edhe informimin e qytetarëve për qendrat e votimit ku do të votonin. Ky institucion ngriti gjithashtu edhe linjën telefonike në ndihmë të qytetarëve për të denoncuar rastet abuzive.

Zyrtarisht u raportua se pati një numër prej 18'540 shkarkimesh nga përdoruesit telefonikë dhe 22 denoncime për veprime korruptive që çënojnë integritetin dhe lirinë e votës, nga të cilat 19 u kryen Ditën e Zgjedhjeve. Ndërsa në linjën telefonike të mundësuar, zyrtarisht raportohen se në periudhën 25/06/2017 deri me 28/06/2017 u kryen 240 denoncime.

Asnjë nga këto denoncime nuk iu përcoll Prokurorisë dhe për këtë KQZ-ja argumentoi se denoncimet e kryera ishin të paplota⁸².

Në vazhden e Vendimit të Këshillit të Ministrave për t'u përballur me përdorimin e administratës publike në fushatë zgjedhore, një seri institucione morën masa për t'u vlerësuar në këtë drejtim. Këto institucione përcaktuan funksionarë të ngarkuar specifikisht për pritjen e rasteve të denoncimit, kontaktet e të cilëve u publikuan në faqet e tyre të internetit⁸³.

Ajo që u vu re është numri i ulët i denoncimeve dhe numri akoma më i ulët i procedimeve të përcjella në Prokuri.

Përsa i përket numrit të denoncimeve, bën përjashtim Ministria e Brendshme e cila komunikoi për 484 raste për vepra penale në fushën e zgjedhjeve⁸⁴.

81 Në aplikacionin “Komisariati Dixhital”, përgjatë muajit maj të vitit 2017 nuk u kryen njoftime për raste apo veprime korruptive që çënojnë integritetin dhe lirinë e votës. Ndërsa, përgjatë muajit qershor të vitit 2017 u kryen 21 njoftime për raste apo veprime korruptive që çënojnë integritetin dhe lirinë e votës. Nga komunikimi zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë u bë e ditur se pas verifikimeve të kryera, për shkak se njoftimet nuk ishin të sakta ose nuk përbënin elementë të veprës penale, asnjë rast nuk iu përcoll Prokurorisë.

82 Informimi publik i pakët për këtë aplikacion apo i përmbytjes që duhet të kishin denoncimet, mungesa e garantimit të ruajtjes së anonimitetit, dhe vonesa në publikimin e këtij aplikacioni u bënë shkaqe për një përdorim të ulët dhe jo efektiv të aplikacionit. Kjo u reflektua edhe në numrin e ulët të përdoruesve të aplikacionit me më pak 1'000 persona dhe të asnjë denoncimi të kryer përgjatë fushatës zgjedhore.

83 “Materiali përmbledhës” i publikuar nga Grupi Task-Forcë, datë 17/10/2017, faqe 44, (...) “Personi i kontaktit me Task - Forcën është caktuar nga 14 (katëmbëdhjetë) ministri dhe vetëm nga 5 (pesë) institucione të varësisë së tyre. Ndërsa emrat e personave dhe numrat e kontaktit për denoncime të rasteve të shkeljeve të dispozitave të ndryshme ligjore që kanë lidhje me zgjedhjet janë publikuar nga 15 (pesëmbëdhjetë) ministri dhe vetëm nga 11 (njëmbëdhjetë) institucione të varësisë së tyre. Pavarësisht kësaj sipas raportimeve të çdo ministrie rubrika e kontaktit/email/numra telefoni ishin funksionale për të gjitha ministrinë.”

84 “Materiali përmbledhës”, Task-Force, faqe 121, (...) “Në Ministrinë e Brendshme, nga ana e qytetarëve

2) Mekanizmat ekzekutivë të hetimit

Strukturat klasike dhe të specializuara ligjzbatuese dhe të hetimit janë Policia e Shtetit dhe Prokuroria e Shtetit. Mediatikisht janë përcjellë në numër të shumtë rastet e kallëzimeve penale për shkelje që prekin procesin zgjedhor, incidente për shkak dhe për rrjedhojë të fushatës zgjedhore apo akuza për sjellje anti-ligjore.

Në lidhje me këto situata, munguan transparenca dhe daljet publike prej institucioneve të specializuara në fjalë. Sjellje pasive kjo, edhe për shkak të një klime të fortë politizimi të institucioneve në përgjithësi, që nuk ndihmoi në adresimin real të problematikës dhe të rritjes së besimit të qytetarëve tek këto institucione.

Nga komunikimi zyrtar me Prokuroritë pranë Gjykatave të Rretheve në vend, rezultoi një numër i ulët i materialeve procedurale të përcjella për veprave penale që çenojnë lirinë dhe integritetin e zgjedhjeve⁸⁵.

Akoma më i vogël, afërsisht jo ekzistent, ishte numri i procedimeve penale të nisura nga strukturat përkatëse për veprat penale në fjalë. Rezultoi se dy Prokuroritë më të investuara për këtë proces zgjedhor ishin Prokuroria e Tiranës për 18 materiale procedurale dhe Prokuroria e Elbasanit për 15 materiale procedurale⁸⁶. Ndërsa ndër Prokuroritë më pak të investuara ishte Prokuroria e Përmetit me asnjë rast procedimi.

Të njëjta shifra të ulëta reflektohen edhe në raportimet e kryera nga Policia e Shtetit.

Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë deri me datë 20/06/2017 u identifikuan 4 raste të shitblerjes së votës, të cilat iu referuan organit të Prokurorisë. Ndërsa deri me datë 25/06/2017, Drejtoria raportoi identifikimin e 14 rasteve të veprave që çenojnë lirinë dhe integritetin e procesit zgjedhor⁸⁷.

kanë mbërritur 484 denoncime. lidhur me veprat penale në fushën zgjedhore, prej të cilave: a) Shpërdorim i autoritetit policor, 30 raste; b) Marrja apo përdorimi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit, 34 raste; c) Pengimi i zgjedhësve, 17 raste; d) Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje, 70 raste; e) Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, 18 raste; f) Korrupsioni aktiv dhe pasiv në zgjedhje, 315 raste. Këto raste nga Ministria e Brendshme i janë përcjellë për trajtim Policisë së Shtetit, e cila vetëm 69 raste ka adresuar në prokurori dhe nuk ka dhënë informacion për verifikimet apo procedurat e ndjekura për rastet e tjera."

85 Nga komunikimi zyrtar i KVV-së, rezultoi se për procesin zgjedhor të 25 Qershorit 2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Fier u depozituan 4 materiale procedurale dhe u nisën 2 procedime procedurale për vepra që çenojnë integritetin dhe lirinë e zgjedhjeve; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Kukës u depozituan 3 materiale procedurale; në Prokurorinë e Pogradecit nuk u depozituan materiale procedurale dhe në një rast u nisën procedime penale; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Kavajë u depozituan 3 materiale procedurale dhe u nisën 2 procedime procedurale; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Berat u depozituan 2 materiale procedurale dhe u nisën 2 procedime procedurale; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Lezhë u depozituan 6 materiale procedurale dhe nuk u nis asnjë procedim penal; në Prokurorinë e Rrethit Dibër u depozituan 6 materiale procedurale dhe u nisën 2 procedime penale; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Elbasan u depozituan 15 materiale procedurale, u nisën 8 procedime penale dhe një çështje gjyqësore; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë u depozituan 18 materiale procedurale dhe u nisën 17 procedime procedurale; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Burrel u depozituan 2 materiale procedurale dhe u nis një procedim penal; në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Lushnje u depozituan 8 materiale procedurale dhe u nisën 2 procedime penale dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Përmet nuk u depozitua asnjë material procedural dhe nuk u nis asnjë procedim penal.

86 Në Kreun X të "Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë", Neni 325-332, përcaktohen 10 vepra penale që çenojnë lirinë dhe integritetin e zgjedhjeve të lira: Pengimi i subjekteve zgjedhore; Falsifikimi i materialit zgjedhor dhe rezultateve të zgjedhjeve; Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor; Shkelja e fshehtësisë së votimit; Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar; Dhënia e shpërblimeve dhe e premtimeve; Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike; Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje; Pengimi i zgjedhësit; Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve; Shkelja e së drejtës së zgjedhjes; Shpërdorimi i autoritetit ushtarak.

87 "Materiali përmbledhës" i publikuar nga Grupi Task-Forcë, datë 17/08/2017, faqe 113, (...) "Në raportimin e datës 21 Qershor 2017, MPB sipas Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit ka raportuar 6 raste për shitblerje vote

Për datën 25 Qershor 2017, Policia raportoi se 18 nga 25 rastet e evidentuara nga Policia e Shtetit iu referuan Prokurorisë, ku për 10 rastet e evidentuara të shitblerjes së votës rezultoi se për dy prej tyre u bë arrestim në flagrancë dhe në rastet e tjera u bë referimi në organin e Prokurorisë⁸⁸.

C. Gjetje nga vëzhgimi i qeverisjes vendore

Funksionalizimi politik i qeverisjes vendore si zgjatim i qeverisjes qendrore është një problematikë e vazhdueshme si përgjatë fushatave zgjedhore, ashtu edhe përgjatë ecurisë normale institucionale. Funksionalizim që ka përcjellë konfliktin e lidhshmeve partiake në nivel vendor duke sjellë ngërçe institucionale në rastet e mospërkimit politik të drejtimit të qeverisjes qendrore me atë vendore.

Kjo qasje në fushatat zgjedhore ka marrë shfaqje të ndryshme që prej akuzave politike ndërmjet përfaqësuesve qendrorë me ata vendorë, e deri tek përdorimi i kapaciteteve administrativo-publike në funksion të subjektit zgjedhor që i përket drejtimi i njësisë vendore. Sjellje kjo në traditë që çënon jo vetëm proceset zgjedhore, por tërë përpjekjen disa vjeçare për ndarjen e qeverisjes vendore me atë qendrore.

1) Vendimarrja e Këshillave Bashkiakë

Për këtë proces zgjedhor kjo problematikë u vërejt gjerësisht në shumë njësi të qeverisjes vendore. Përpos sjelljes politike të angazhuar të strukturave administrative, u vërejt edhe një vendimarrje me pikëpyetje të forta për ligjshmërinë e tyre, e cila mund të dyshohet për forma të drejtimit të votës. Një problematikë kjo e vërejtur dhe e evindetuar edhe nga puna e Grupit Task Force.

Përsa është mundur të sigurohet vendimarrja e Këshillave Bashkiakë për periudhën kohore janar-shkurt 2017⁸⁹, vërehen gjetje që ngrenë dyshime. Evidentohen njësi vendore që në këtë periudhë kohore parazgjedhore kanë patur vendimarrje mujore me luhajtje drastike në numrin e ndihmës ekonomike për familjet jo në gjendje të mirë ekonomike, për personat e verbër, për personat para-tetraplegjikë, personave me aftësi të kufizuar dhe për personat invalidë.

gjatë fushatës elektorale. MPB ka pranuar se janë angazhuar në mënyrë masive burime të dyshimta financiare në shit-blerjen e votës nga subjekte politike ose persona të lidhur me këto subjekte. Ndërkohë që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ka raportuar për 3 (tre) raste të konstatuara dhe të referuara për përdorim të parasë në mbështetje të subjekte zgjedhore nga ana e egfektivëve të Policisë së Shtetit, të cilat janë kapur në flagrancë dhe referuar në Prokurori!

88 Drejtari i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, në raportimin e bërë në Grupin Task Force në datë 26.06.2017, përmes shkresës nr. 679/4 evidentoi 25 vepra penale që lidhen me procesin zgjedhor, ku ishin proceduar gjithsej 27 persona, nga të cilët 7 të arrestuar, 10 në gjendje të lirë dhe 10 në kërkim. Nga këto vepra penale, z. Çako raportoi 10 raste të shitblerjes së votës sipas cilësimit 'Korrupsion aktiv në zgjedhje' neni 328 i KP.

89 Kuadri ligjor shqiptar për qeverisjen vendore garanton publikimin e vendimeve të Këshillave Bashkiakë në faqet zyrtare të internetit përkatëse. Rregullim ligjor i pa-respektuar nga shumë njësi vendore, nga të cilat një pjesë nuk e kanë të ngritur fare një faqe interneti, por edhe ndaj kërkesave zyrtare të Koalicioni të Vëzhguesve Vendorë vetëm në 31 raste u kthye përgjigje. Edhe në rastet e kthimit të përgjigjeve informacioni mbetet i paplotë, i pjesshëm dhe jo sistematik.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Nga vëzhgimi formal, përpos ndryshimeve që i shpëtojnë dyshimit aritmetiko-logjik, rezultojnë njësi vendore që në një periudhë 6 mujore para zgjedhjeve, pësojnë shumëfishim progresiv të personave në kategoritë me ndihmë ekonomike⁹⁰, kryejnë shumëfishim të numrit të personave për kategori specifike dhe më pas rikthimin e tyre në gjendjen e mëparshme⁹¹, ose kanë rritje në më pak se 50 për qind të numrit të personave për kategori specifike⁹².

2) Zbatueshmëria e ligjit për subjektet zgjedhore

Në këtë proces zgjedhor, njësitë vendore ndër të tjera ishin të ngarkuar në dy çështje përsa i përket mbarëvajtjes zgjedhore. Sipas legjislacionit për qeverisjen vendore këto institucione duhet të autorizojnë përdorimin e hapësirave publike për funksione tubimesh elektorale përkundrejt tarifave ose lëshojnë ambiente në pronësinë e tyre për funksione takimesh elektorale përkundrejt pagesës. Gjithashtu, me amendimet e reja ligjore, subjektet zgjedhore do të duhej të regjistronin zyrat e tyre zgjedhore pranë njësite vendore përkatëse.

Nga komunikimi zyrtar me këto njësi, përsa u arrit të merrej përgjigje, evidentohen raste të njësite vendore që e injoruan tërësisht kuadrin ligjor në çështjen në fjalë. Përballë numrit të lartë të tubimeve që raportoi Policia e Shtetit, në pjesën më dërrmuese të tyre subjektet zgjedhore nuk morën autorizim nga njësitë vendore dhe nuk paguan tarifat vendore për zënien e hapësirave publike.

Gjithashtu evidentohen shumë raste që subjektet zgjedhore, madje parlamentare, nuk i deklaruan zyrat zgjedhore pranë njësite vendore.

Shembuj këto që, përpos dëmit që mund të shkaktojnë në financat publike apo cënimit të kuadrit ligjor në vetvete, reflektojnë injorimin e hapur ndaj zbatimit të kuadrit ligjor nga subjektet zgjedhore si dhe indulgjencën institucionale ndaj tyre pa bërë dallime partiake.

⁹⁰ Në Bashkinë Peqin rezultojnë se në muajt e skajshëm janar-qershor 2017, numri i personave për kategoritë e ndihmës ekonomike janë: numri i personave paratetraplegjikë nga 13 në 75, numri i personave invalid nga 248 në 651, numri i personave me aftësi të kufizuara nga 118 në 566, numri i personave të verbër nga 36 në 135. Në Bashkinë Durrës rezultojnë se në muajt e skajshëm janar-qershor 2017, numri i familjeve për kategorinë e ndihmës ekonomike janë nga 83 në 406. Në Bashkinë Vlorë rezultojnë se në muajt e skajshëm janar-qershor 2017, numri i familjeve për kategorinë e ndihmës ekonomike janë nga 15 në 114.

⁹¹ Në Bashkinë Poliçan rezultojnë se numri i familjeve jo në gjendje të mirë ekonomike dhe që përkrahen me ndihmë ekonomike në muajin janar ishte 176, në muajin prill ishte 329 dhe në muajin qershor 162.

⁹² Në Bashkinë Cërrik rezultojnë se në muajt e skajshëm janar-qershor 2017, numri i familjeve jo në gjendje të mirë ekonomike dhe që përkrahen me ndihmë ekonomike është nga 768 në 896.

XII. PJESËMARRJA E GRUPEVE SHOQËRORE NË PROCESIN ZGJEDHOR

Gjithëpërfshirja e tërë grupeve shoqërore është jo vetëm një vlerë madhore, por edhe domosdoshmëri për shëndosshjen e një qeverisje demokratike.

Përfshirja sa më e madhe e grupeve shoqërore të ndryshme si pakicat etnike apo grupet e marginalizuara, kërkon një vëmendje të veçantë në ofertat elektorale garuese që iu paraqiten qytetarëve gjatë procesit zgjedhor si dhe hapa konkretë që të sigurojnë lehtësimin e përfshirjes së këtyre grupeve në proces.

Në gjykimin e KVV-së, kufizimet e së drejtës aktive për të votuar si në rastin e personave me moshë mbi 100 vjeç të cilët duhet të paraqesin kërkesë për të votuar dhe të personave të prekur nga procesi i dekriminalizimit, përbëjnë precedentë të rrezikshëm shoqërorë.

Këto precedentë që kufizojnë vullnetin demokratik të qytetarëve përbëjnë shenja të një rregullimi ligjor me tendenca suprimuese. Tendenca që jo vetëm mbartin rrezikun për kufizime të ardhshme ligjore, por edhe nxisin një frymë tolerimi ndaj cedimeve të detyrimit universal për t'i mundësuar çdo qytetari të drejtën e votës aktive. Kjo frymë bie ndesh me garancitë madhore të dokumentave universalë të cilët afirmojnë maksimalisht vlerën absolute të votës së çdo individi.

A. Grupet shoqërore të marginalizuara

Në listën e zgjedhësve për Zgjedhjet e 25 Qershorit 2017, sipas të dhënave të përcjella prej Kryetarëve të Njësisë të Qeverisjes Vendore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, rezultuan 11 509 zgjedhës të verbër dhe 10 587 zgjedhës me aftësi të kufizuara (para dhe tetraplegjikë).

Në rang vendi, zgjedhësve me aftësi të kufizuara u përkiste të votonin në 1 524 qendra votimi të ndryshme ndërsa zgjedhësve të verbër në 2 022 qendra votimi të ndryshme.

Nga këto qendra votimi, vetëm 128 deklaruan se posedonin rampa, 255 deklaruan se nuk i kishin, ndërsa 1 141 nuk deklaruan asnjë informacion nëse posedonin apo jo rampa nëpër QV.

Mospasja e mjetit të identifikimit si pengesë për të votuar mbeti një çështje e paadresuar edhe në këtë proces zgjedhor.

Nga komunikimi me Ministrinë e Brendshme me datë 18/07/2017 u bë e ditur se ishin lëshuar 3 415 821 karta identiteti dhe 3 149 408 pashaporta biometrike për një total prej 3 452 308 zgjedhësish. Shifra këto që evidentojnë një numër shtetasish pa mjete identifikimi, por që nuk mund të japin një vlerësim të saktë se sa është numri i shtetasve që nuk i zotërojnë ato, apo që sa prej tyre nuk kanë mundur të pajisen me mjete identifikimi për shkak të pamundësisë ekonomike.

Në këtë proces zgjedhor problematika e mungesës së mjeteve të identifikimit u evidentua më së shumti tek personat që vuanin heqjen e lirisë në institucionet penitenciare, ku sipas të dhënave të Grupit Task-Forcë rezultonin 900 persona të cilët ose nuk i zotëronin kartat e identitetit ose i kishin ato të administruara si pjesë e fashikujve të Prokurorisë⁹³.

⁹³ Nga komunikimi me përgjegjësit e institucioneve penitenciare u bë e ditur mungesa e kartës së identitetit për

B. Pjesëmarrja e grave në procesin zgjedhor

Pjesëmarrja e grave në përgatitjen e proceseve zgjedhore, në zhvillimin e fushatave zgjedhore dhe, cc'është më e rëndësishmja, në përfaqësimin politik përbën një sfidë universale.

Në traditën e demokracisë shqiptare vihet re një rritje minimale e numrit të pjesëmarrjes së grave, por që vazhdon të mos jetë thelbësore, duke mbetur thjesht një rritje numerike që nuk përkon aspak në njëvlefshmëri me fuqizimin e tyre real politik.

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë i ka kushtuar vazhdimisht rëndësi çështjes së fuqizimit dhe përfaqësimit të grave në proceset zgjedhore dhe në jetën politike në vend, si dhe përfaqësimit të tyre edhe në strukturën dhe trupën e vëzhguesve të vetë rjetit.

Në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2017, 34.99% e vëzhguesve të KVV-së në të gjitha nivelet ishin gra⁹⁴.

Përsa i përket pjesëmarrjes së grave në institucionet e angazhuar në mbarëvajtjen këtij procesi zgjedhor rezultuan se: në trupën e Kolegjit Zgjedhor nga 8 anëtarë 1 është grua; në trupën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga 7 anëtarë 2 janë gra; në Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor nga 720 anëtarë 224 prej tyre ishin gra; në Bordin e Monitorimit të Mediave nga 7 anëtarë asnjë nuk ishte grua dhe në Zyrat Rajonale Zgjedhore nga 28 anëtarë 6 janë gra.

Nga totali i 2 666 kandidatëve në listat shumëemërore të 18 subjekteve zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të 25 Qershorit, rezultuan 1 088 gra (40.8 % e totalit).

Në rastet e mosrespektimit të kuotës gjinore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi sanksione me gjobë prej 1'000'000 lekësh për Partinë Socialiste dhe prej 1'000'000 lekësh për Lëvizjen Socialiste për Integrim. Ndërsa për Partinë Demokratike, sanksioni prej 5'000'000 lekësh për mosrespektimin e kuotës gjinore u diskutua në seancë pa u bërë pjesë e aktit përkatës⁹⁵.

Përsa i përket administratës zgjedhore të nivelit të dytë dhe të tretë, gratë ishin më të përfaqësuara në nivelin e dytë (komisionet zonale të administrimit zgjedhor) sesa në nivelin e tretë të tyre (komisionet e qendrave të votimit). Në total, anëtarësia e komisioneve zonale të administrimit zgjedhor kishte në përbërje të vet 224 gra, 31.11%, nga 720 anëtarë në total nga të cilët përbëhet kjo trupë⁹⁶.

rreth 10 përqind të personave që vuajnë heqjen e dënimit, të cilët ose rezultojnë të papajisur me karta identiteti ose kartat e tyre të identitetit janë pjesë e dosjeve përkatëse.

94 Në nivelin e koordinatorit të qarkut 58.33% ishin gra dhe në nivelin e vëzhguesit ofatgjatë në bashki ishin 44.26% gra.

95 Përsa i përket respektimit të kuotës gjinore 30 përqind në listat shumëemërore për çdo zonë zgjedhore të subjekteve zgjedhore, ky kriter në shtatë raste nuk u respektua. Bëhet fjalë për listat shumëemërore të Partisë Socialiste për Qarkun Berat; të Lëvizjes Socialiste për Integrim për Qarkun e Tiranës dhe Partisë Demokratike për Qarkun e Fierit, Gjirakastrës, Beratit, Kukësit dhe Elbasanit.

96 Në anëtarësinë e KZAZ-ve, anëtarësia pa funksione drejtuese ishte 35.33% gra. Në pozicionet drejtuese, kryetar dhe zëvendëskryetar, u vërejt që numri i grave pakësohej, ku 25.56% e kryetarëve të KZAZ-ve, 20% e zëvendëskryetarëve, 26.67% e sekretarëve ishin gra.

Subjekti zgjedhor që kishte angazhuar numrin më të lartë të grave si anëtare të KZAZ-ve⁹⁷ ishte Partia Demokratike me 50.37%. Partia Socialiste kishte 47.41%, Partia Republikane 17.78% dhe Lëvizja Socialiste për Integrim 12.22%. Përsa i përket angazhimit të grave në pozicionet drejtuese të KZAZ-ve rezultoi se Partia Demokratike kishte angazhuar 12 gra në krye të KZAZ-ve (26.67%) dhe Partia Socialiste 11 (24.44%). Në pozicionin e Zëvendëskryetarit dhe sekretarit të KZAZ-ve, PS kishte angazhuar më shumë gra se PD, respektivisht 22.22% përkundër 17.78% si zëvendëskryetare dhe 35.56% përkundër 17.78% si sekretare.

Në komisionet e qendrave të votimit, sipas gjetjeve të vëzhgimit nëpërmjet VBS të KVV-së, rezultoi se gratë anëtare ishin rreth 22.7%. Shumica e qendrave të votimit, konkretisht rreth 35.82% e tyre, pati 1 anëtare të komisionit të qendrës së votimit grua, e ndjekur kjo nga 2 ose asnjë komisionere grua (përkatësisht rreth 22.64% dhe rreth 21.14%). Në rreth 11.44% ka patur tre anëtare gra, dhe në më pak se rreth 9% ka patur 4, 5 ose 6 anëtare gra⁹⁸.

Zonat urbane kishin një përfaqësim më të mirë të grave në komisionet e qendrave të votimit sesa zonat rurale. Mesatarisht, në zonat urbane kishte dy gra anëtare, ndërsa në zonat rurale kishte mesatarisht një grua anëtare për KQV.

XIII. VËZHguesIT PARTIAKË, VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Në nivel global, vëzhgimi i proceseve zgjedhore nga subjekte vendase apo të huaja, më shumë se një e drejtë, përbën një garanci të proceseve zgjedhore.

Prezenca e vëzhguesve jo vetëm shërben për monitorimin e mbarëvajtjes së proceseve zgjedhore, por edhe ndihmon në sigurimin e besimit qytetar tek integriteti i këtyre proceseve.

Përpos prezencës së vëzhguesve të huaj, prezenca e vëzhguesve vendas mbart një specifikë të shtuar e cila shkon përtej procesit zgjedhor. Këta aktorë janë bashkëjetues me vijueshmërinë e proceseve zgjedhore dhe ndihmës në konsolidimin e proceseve demokratike jashtëzgjedhore.

Si të tillë, ata duhet të marrin vëmendje të veçantë, duke respektuar së paku statusin e tyre si vëzhgues sidomos në garantimin e transparencës maksimale të procesit.

⁹⁷ Burimi: faja zyrtare e KQZ-së në internet.

⁹⁸ Për përlogaritjen e saktë të përqindjes së pjesëmarrjes së grave dhe marzhit përkatës të gabimit, lutemi referojuni shtojcës së raportit.

Kuadri ligjor zgjedhor së bashku me të drejtat që i garantohen vëzhguesve, përcakton edhe procedurat e akreditimit të tyre. Subjektet jo partiakë vendas dhe të huaj i akreditojnë vëzhguesit e tyre pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa subjektet zgjedhore i akreditojnë pranë Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor.

A. Vëzhgues të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për procesin zgjedhor të datës 25 Qershor 2017 akreditoi 5 335 vëzhgues jo partiakë, përfaqësues të medias dhe përkthyes.

Vëzhgues afatgjatë ishin 912 persona nga të cilët 864 të akredituar nga tetë organizata jofitimprurëse vendase dhe 48 të akredituar nga tre organizma ndërkombëtarë, prej të cilëve dy organizma joqeveritare dhe një përfaqësi diplomatike e akredituar në vend.

Nga 3 351 vëzhgues afatshkurtër të akredituar, 2 863 vëzhgues u akredituan nga shtatë organizata jofitimprurëse vendase dhe 488 vëzhgues u akredituan nga 28 organizma ndërkombëtarë.

U akredituan gjithashtu edhe 326 përkthyes dhe 746 përfaqësues të medias, prej të cilëve 725 të mediave vendase dhe 21 gazetarë të mediave të huaja.

Në raport me dy proceset zgjedhore të fundit, procesi zgjedhor i vitit 2017 pati në total një numër relativisht më të ulët të vëzhguesve jo partiakë. Zgjedhjet vendore të vitit 2015, u vëzhguan nga 5 185 vëzhgues, nga të cilët 4 252 vëzhgues vendas⁹⁹ dhe 933 vëzhgues ndërkombëtarë¹⁰⁰. Ndërsa, zgjedhjet parlamentare të vitit 2013 u vëzhguan nga 9 174 vëzhgues, nga të cilët 8 541 vëzhgues vendas¹⁰¹ dhe 633 vëzhgues të huaj¹⁰².

B. Vëzhgues të akredituar nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor

Vëzhguesit afatshkurtër partiakë në komisionet e nivelit të dytë dhe të tretë të trupës së administrimit zgjedhor, akreditohen nga Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor.

Në këtë proces zgjedhor, për shkak të mosgarimit të asnjë koalicioni parazgjedhor dhe sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji, pranë çdo selie të Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor dhe pranë çdo Qendre Votimi mund të akreditoheshin deri në 18 vëzhgues partiakë, përpos atyre jo partiakë. Ndërkohë pranë Vendeve të Numërimit të Votave (VNV) numri i vëzhguesve partiakë mund të shkonte deri në 90 të tillë duke qenë se të 18 subjektet zgjedhore kishin të drejtë të caktonin nga një vëzhgues për çdo

⁹⁹ Prej të cilëve 1 487 vëzhgues afatgjatë, 2 082 vëzhgues afatshkurtër dhe 683 vëzhgues nga mediat.

¹⁰⁰ Prej të cilëve 88 vëzhgues afatgjatë, 638 vëzhgues afatshkurtër dhe 207 përkthyes.

¹⁰¹ Prej të cilëve 2 433 vëzhgues afatgjatë, 5 312 vëzhgues afatshkurtër dhe 796 përfaqësues të medias.

¹⁰² Prej të cilëve 128 vëzhgues afatgjatë dhe 505 vëzhgues afatshkurtër, ku 212 ishin përkthyes.

tavolinë numërimi në çdo VNV.

Duke shtuar edhe numrin e vëzhguesve jopartiakë të mundshëm pranë çdo komisioni zgjedhor mund të arrihej një numër i jashtëzakonshëm vëzhguesish. Ndërkohë, nga sa u raportua nga vëzhguesit e KVV-së, gjatë procesit zgjedhor 2017 nuk u vërejtën në masë situata ku prezenca e lartë e vëzhguesve partiakë të shndërrohej në raste cënimi ndaj procesit.

Përpjekjet e vëzhguesve të KVV-së për të marrë informacion mbi numrin e vëzhguesve politikë të akredituar prej KZAZ-ve, nuk konkluduan në ndërtimin e një pasqyre të dhënash për shkak të mos-dhënies informacion prej komisionerëve të ZAZ-ve.

Kjo mungesë totale transparence, e shoqëruar me problematika të mundshme të mbarëvajtjes së procesit dhe me prezencën e lartë të vëzhguesve partiakë, në procese zgjedhore të tjera më të ngarkuara nga konflikti politik mund të projektojnë ndërçes serioze apo pasoja të tjera më të rënda.

XIV. DITA E ZGJEDHJEVE DHE PROCESI I NUMËRIMIT

Procesi i votimit dhe ai i numërimit të fletëve të votimit përbëjnë dy momentet më formalë dhe më administrative në proceset zgjedhore për çdo vend. Këto procese do të duhej të ishin të atilla edhe në rastin Shqiptar, por për shkak të traditës së manipulimeve apo të përpjekjes manipuluese në vend, janë shndërruar në procese të rënduara në formalitete. Nga ana tjetër, këto formalitete që do të duhej të garantonin siguri mund edhe të bëhen objekt i situatave bllokuese apo të tensionuara. Situata këto që gjenerohen jo vetëm prej vullneteve të drejtuara politike, por edhe për shkak të eventualiteteve njerëzore.

A. Të dhëna mbi procesin

Në procesin zgjedhor të 25 Qershorit votuan 1 613 789 qytetarë¹⁰³ ose 46.75% e votuesve të regjistruar, nga të cilat 714 991 ose 44.31% e votuesve ishin gra¹⁰⁴.

Zona zgjedhore me përqindjen më të lartë të zgjedhësve që votuan ishte Qarku Dibër me pjesëmarrje 56.13% dhe zona zgjedhore me numrin më ulët të pjesëmarrësve ishte Qarku Vlorë, me pjesëmarrje 35.96%. Numri total i fletëve të votimit të gjetura në kuti ishte 1 614 038, nga të cilat 31 841 (1.97%) u shpallën vota të pavlefshme, ndërsa 5 871 fletë votimi rezultuan të dëmtuara gjatë ditës së votimit.

Procesi i numërimit të fletëve të votimit shënoi një precedent pozitiv në këtë proces zgjedhor, duke përfunduar brenda 48 orëve¹⁰⁵. Nga 18 subjekte zgjedhore

¹⁰³ Procesi i votimit ishte caktuar përgjatë orarit 7.00 – 19.00, por për shkak të Festës së Bajramit të besimit musliman, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi shtyrjen e procesit me një orë.

¹⁰⁴ Të gjitha shifrat në këtë paragraf dhe në atë që poson janë të bazuara në dokumenta të vendosura në dispozicion nga KQZ. Numri i grave që kanë votuar është më i lartë pasi në këto rezultate mungojnë të dhënat për votimin e grave nga 316 QV.

¹⁰⁵ Në ZAZ Nr. 42, Bashkia Kavajë, numërimi vazhdoi më gjatë për shkak se u numëruan edhe fletët e votimit për Zgjedhjet e Pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kavajë, të cilat u zhvilluan në të njëjtën ditë me Zgjedhjet Parlamentare.

garuese në proces, vetëm 5 prej tyre rezultuan si parti parlamentare.

Partia Socialiste e Shqipërisë mori 764 750 vota (48.34%) dhe 74 deputetë, Partia Demokratike 456 413 vota (28.85%) dhe 43 deputetë, Lëvizja Socialiste për Integrim 225 901 vota (14.28%) dhe 19 deputetë, Partia Social Demokrate 14 993 vota (0.95%) dhe 1 deputet dhe Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 76 069 vota (4.81%) dhe 3 deputetë.

Ndërkaq 13 subjekte zgjedhore nuk arritën të kalonin pragun për të siguruar një mandat parlamentar. Ato morën në total 44 024 vota (2.77%) në rang vendi¹⁰⁶.

B. Gjetjet për Ditën e Zgjedhjeve sipas VBS-së

Në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të 25 Qershorit 2017, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë aplikoi metodologjinë e Vëzhgimit me Bazë Statistikore (VBS) për vlerësimin e procesit gjatë ditës së zgjedhjeve, e cila është përdorur me sukses në mbi 40 vende të botës deri më sot.

KVV ka qenë e para organizatë vendore shqiptare që e ka zbatuar atë në rang vendi në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013 dhe në këto zgjedhje e aplikoi për herë të dytë.

KVV përzgjidhi rastësisht 541 qendra votimi të cilat u vëzhguan ditën e zgjedhjeve. Bazuar në këtë kampion, gjetjet mund të përgjithësohen për të gjithë vendin me një marzh gabimi deri në 4.69% dhe me një nivel konfidence prej 95%. Përlllogaritja e marzhit real të gabimit varion për çdo pyetje, në varësi të proporcioneve të përgjigjeve për secilën alternativë (*për marzhin e gabimit për secilën pyetje, referoju Shtojcës*).

Çdo qendër votimi u vëzhgua nga dy vëzhgues të stacionuar, me turne prej 7 orësh secili. Vëzhguesit e turnit të parë u paraqitën në qendrat e votimit në orën 06:00 duke vëzhguar procedurat e përgatitjes dhe të hapjes së tyre, si dhe procesin e votimit përgjatë pjesës së parë të ditës, deri në orën 13:00. Vëzhguesit e turnit të dytë vëzhguan procesin e votimit përgjatë pjesës së dytë të ditës, nga ora 13:00 deri në mbylljen e tyre, procedurat e mbylljes së qendrave të votimit si dhe dërgimin e materialeve zgjedhore dhe të kutive të votimit drejt vendeve të numërimit të votave. Rezultatet e mëposhtme bazohen në të dhënat e mbledhura nga 524 qendra votimi¹⁰⁷.

106 Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë mori 2 421 vota (0.15%); Partia Sfidë për Shqipërinë mori 3 546 vota (0.22%); Partia Republikane mori 3 225 vota (0.2%); Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar mori 924 vota (0.06%); Partia Aleanca Demokristiane morri 767 vota (0.056%); Partia Aleanca Demokratike mori 547 vota (0.03%); Partia Frymë e Re Demokratike mori 5 146 vota (0.33%); Partia Demokracia Sociale mori 2 473 vota (0.16%); Partia Aleanca Arbnore Kombëtare mori 351 vota (0.02%); Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen mori 2 287 vota (0.14%); Partia Komuniste e Shqipërisë mori 1 026 vota (0.06 %); Partia Aleanca Popullore për Drejtësi mori 1 505 vota (0.10%) dhe Partia Lista e Barabartë morri 19 806 vota (1.25%).

107 Gjatë ditës së zgjedhjeve, vëzhguesit e KVV mbuluan në mënyrë sistematike (gjatë gjithë ditës së zgjedhjeve, prej hapjes deri në dërgimin e materialeve drejt vendeve të numërimit të votave) 532 qendra votimi. Në nëntë qendra votimi vëzhguesit nuk arritën të mbulonin procesin në të gjithë elementët e vet në mënyrë të besueshme. Për këtë arsye, të dhënat e mbledhura nga këta vëzhgues nuk u përfshinë në analizën finale të të dhënave. Në mënyrë që të ruhej proporcioni i qendrave të votimit mes qarqeve të ndryshme, sipas kampionimit origjinal, i cili reflektonte proporcionin real të numrit të QV-ve për qark në totalin e QV-ve në rang vendi, të dhënat e mbledhura nga 8 qendra votimi të tjera, në qarqet e mbipërfaqësuar, u përjashtuan nga analiza finale. Tetë qendrat e votimit, të dhënat e të cilave u përjashtuan nga analiza finale u përzgjidhën në mënyrë rastësore. Në këtë mënyrë, kampioni final i qendrave të votimit reflektonte

Vëzhguesit raportuan gjetjet e tyre në katër momente gjatë ditës¹⁰⁸ nëpërmjet thirrjeve telefonike drejt Qendrës Operative, ku u angazhuan 80 operatorë; apo nëpërmjet përdorimit të një aplikacioni për telefona celularë, e cila përbëri një risi për organizatat vendase të vëzhgimit të zgjedhjeve, jo vetëm në Shqipëri.

1) Konsiderata për gjetjet

Dhuna fizike dhe verbale, brenda apo pranë ambienteve të qendrave të votimit apo të vendeve të numërimit të votave, është një fenomen i traditës elektorale në vend që edhe në këtë proces nuk mungoi. Këto situata konfliktuale apo pretendimet për raste intimidimi ose drejtimi vote, ushqyen retorikën politike jo vetëm gjatë procesit zgjedhor, madje edhe tërë konfliktualitetin politik gjatë legjislaturës së shkuar. Retorikë politike e akuzave që është mbështetur plotësisht në mungesën e një adresimi efektiv prej institucioneve përgjegjëse.

Në përgjithësi dita e zgjedhjeve procedoi e qetë, me shkelje sporadike të procedurave formale të procesit, të cilat u gjykua se nuk e afektuan për mbajtësisht dhe në mënyrë domethënëse procesin zgjedhor.

Prezenca e personave të paautorizuar brenda qendrave të votimit vazhdoi të ishte një fenomen i vërejtur në një numër jo të vogël të QV-ve.

Votimi familjar dhe fotografimi i votës ishin fenomene të cilët u vërejtën në një numër relativisht të lartë të Qendrave të Votimit. Më shqetësuese ishte toleranca e komisionerëve të Qendrave të Votimit ndaj këtyre fenomeneve, veçanërisht ndaj fotografimit të votës. Në lidhje me këtë të fundit, në shumicën e rasteve të vërejtura komisionerët nuk njoftuan Policinë e Shtetit, edhe pse i identifikuan rastet apo zgjedhësit që fotografuan votën.

Propaganda elektorale apo tentativat për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve nga militantët e partive politike gjatë ditës së zgjedhjeve, në brendësi ose në afërsi të ambienteve të qendrave të votimit, megjithëse jo një fenomen i vënë re më masë, ishte gjithashtu shqetësues.

Vështirësia apo deri pamundësia në shumë Qendra Votimi, për zgjedhësit me aftësi të kufizuara që të ushtronin të drejtën e votës mbeti një fenomen i paadresuar edhe në këto zgjedhje. Komisionerët e Qendrave të Votimit nuk i kushtuan rëndësi zbatimit të dispozitave ligjore në lidhje me asistimin e këtyre personave, apo të personave që kërkuar asistencë gjatë votimit. Sjellje në anashkalim me detyrimin për plotësimin e deklaratës përkatëse nga zgjedhësit që asistojnë të tretë, apo duke lejuar në pak raste, që një person të asistonte më shumë se një zgjedhës.

Këto fenomene theksuan nevojën për një trajnim më profesional të komisionerëve të qendrave të votimit, fushata ndërgjegjësimit dhe edukimi të zgjedhësve më proaktive dhe të targetuara specifikisht për fasha të ndryshme demografike.

peshën e secilit qark në numrin total të QV-ve në rang vendi.

108 Për procedurat e hapjes së qendrave të votimit në mëngjes, për mbarëvajtjen e votimit gjatë pjesës së parë të ditës në mesditë, për mbarëvajtjen e votimit gjatë pjesës së dytë të ditës pas mbylljes së votimit dhe për procedurat e mbylljes së qendrave të votimit pas nisjes së materialeve zgjedhore drejt vendeve të numërimit të votave.

Masa më proaktive duhen marrë gjithashtu në lidhje me garantimin e një situatë të qetë dhe pa ndikim mbi zgjedhësit gjatë ditës së votimit, jo vetëm në brendësi të qendrave të votimit, por edhe në afërsi të tyre.

2) Procedurat e hapjes së qendrave të votimit


Procedurat standarde gjatë procesit të hapjes së Qendrave të Votimit (QV) u zbatuan me përpikmëri në pjesën më të madhe të Qendrave të Votimit, ndërkohë që mosrespektimi i këtyre procedurave u vërejt në një numër shumë të vogël qendrash votimi¹⁰⁹.

Në një përmirësim të dukshëm nga tradita, në këto zgjedhje u vërejt se vetëm në 0.58% të Qendrave të Votimit pati mungesë të materialeve të nevojshme për procesin e votimit.

Në Ditën e Zgjedhjeve të 25 Qershorit u konstatua se rreth 22% e Qendrave të Votimit nuk u hapën në kohë, 18% e tyre u hapën me vonesa deri në gjysmë ore dhe rreth 4% u hapën me vonesa deri në një orë¹¹⁰. Ndërkaq, në rreth %46 të qendrave të votimit të cilat u hapën me vonesë, u vërejtën zgjedhës që prisnin për të votuar në momentin që QV-të u hapën.

Në 2.14% të Qendrave të Votimit, komisionerët nuk morën masa për të hequr materialet propagandistike pranë ambienteve të QV-së¹¹¹. Kjo shifër ishte dukshëm më e ulët se në zgjedhjet e mëparshme. Si shkak kryesor konsiderohet detyrimi ligjor i vendosur në këto zgjedhje që materialet propogandistike të kufizohen në afërsi të zyrave zgjedhore të partive politike.

PROCEDURAT E HAPJES SË QV-SË



¹⁰⁹ Në masën 1.35%, komisionerët nuk vendosën përpara nisjes së votimit "Procesverbalin e Hapjes së Qendrës" me kodet e sigurisë me të cilat u vulos kutia në kutinë e votimit. Këto shkelje procedurale kanë ardhur si pasojë e neglizhencës apo si pasojë e mosnjohjes së kuadrit ligjor.

¹¹⁰ Qendrat e votimit duhet të jenë të hapura për zgjedhësit në orën 07:00. Një problematikë e vënë në dukje edhe në zgjedhje të tjera ishte mos prezenca e komisionerëve të qendrave të votimit, veçanërisht në momentin e hapjes së tyre. Qendra e votimit mund të hapet vetëm nëse shumica e komisionerëve, pra së paku katër anëtarë, të jenë të pranishëm në momentin e hapjes. Në 79.08% të qendrave të votimit, ishin të pranishëm të gjithë komisionerët në momentin e hapjes së tyre, në 20.02% pati mungesa, nga të cilat 12.55% u hapën me 6 komisionerë, 5.38% me 5 komisionerë dhe 2.99% me katër komisionerë. Asnjë prej QV-ve nuk u hap në mungesë të Kryetarit apo Sekretarit të Komisionit të Qendrës së Votimit.

¹¹¹ Komisioni i Qendrës së Votimit ka për detyrë të heqë materialet propagandistike që mund të ndodhen në mjedisin rrethues të Qendrës së Votimit në një rreze deri në 150 metra.


Procedurat e hapjes së Qendrave të Votimit u vlerësuan nga vëzhguesit e KVV-së, si “shumë të mira” në %65.88 të QV-ve, si “të mira” në %32.55 të tyre dhe si “me probleme” në ¹¹²%1.37.

3) Procedurat e votimit

Përgjatë procesit të votimit, njësoj si në momentin e hapjes së QV-së, duhet të jenë të pranishëm shumica e komisionerëve që procesi të vijojë. U vërejt se në krahasim me momentin e hapjes së QV-ve, në vazhdim të votimit, numri i QV-ve që operuan me numrin e plotë të komisionerëve u rrit me thajse 6 pikë përqindje. Në rezultante të tërë ecurisë, në 85.96% të Qendrave të Votimit, komisionet operuan me shtatë anëtarë¹¹³.

Në kuadër të respektimit të politikave për barazinë gjinore, rezultoi se edhe në këtë proces zgjedhor përfshirja e grave në nivelin e tretë ishte problematike. Në %21.14 të Komisioneve nuk pati asnjë anëtare grua në përbërje të komisionit të qendrës së votimit, në 35.82% të tyre pati 1 anëtare grua, në %22.64 të tyre pati 2 anëtare gra dhe në 11.44% të tyre pati 3 anëtare gra. Ndërsa në më pak se %9 të Komisioneve të nivelit të tretë, mazhoranza e anëtarëve ishte gra. Në rezultante të së tërës, u vërejt se rreth %22.7 e komisionerëve të qendrave të votimit ishin gra.

PËRQINDA E QV-VE SIPAS NUMRIT TË GRAVE KOMISIONERE



Prania e personave të paautorizuar brenda qendrave të votimit vazhdoi të ishte një fenomen i vërejtur në një numër relativisht të lartë të QV-ve. Numri i Qendrave të Votimit në të cilat u vërejtën persona të paautorizuar së paku në një moment, ishte në masën 7.25%¹¹⁴.

¹¹² Vetëm në një QV vëzhguesi i vlerësoi procedurat e hapjes si shumë problematike.

¹¹³ Numri i QV-ve që operuan me më pak se shtatë anëtarë pësuan rënie gjatë procesit të votimit në të gjitha kategoritë ku 8.27% me gjashtë anëtarë, 4.42% me pesë anëtarë dhe 1.35% me 4 anëtarë komisionerë. Në asnjë rast Komisionet nuk operuan me më pak se 4 anëtarë.


¹¹⁴ Në 15 nga rastet e vërejtura, personat e paautorizuar brenda QV-së u identifikuan si përfaqësues të forcave politike dhe në 16 raste vëzhguesit nuk mundën të identifikonin se çfarë përfaqësonin.

Vëzhguesit e KVV-së vlerësuan se në 12.07% të QV-ve, pozicionimi i dhomës së fshehtë nuk lejoi që të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit të kishin një pamje të qartë të veprimeve që kryente zgjedhësi prapa saj¹¹⁵.

Ndërsa në 1.72% të rasteve, vëzhguesit e KVV-së vlerësuan se pozicionimi i dhomës së fshehtë nuk garantoj fshehtësinë e votës.

Një tjetër shqetësim i lidhur me infrastrukturën dhe organizimin e qendrës së votimit ishte mos afishimi i listës së zgjedhësve në 7.3% të qendrave të votimit.

PERSONA TË PRANISHËM NË QV DHE INFRASTRUKTURA E QV-ve



Procedurat formale të procesit të votimit u respektuan në shumicën e qendrave të votimit me përpikmëri, me devijime në një numër të vogël të QV-ve¹¹⁶.

Shkelje të vërejtura në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit kishin të bënin me përdorimin e telefonit celular brenda QV-së, që u vërejt në 8.97% të QV-ve, apo mbajtja e telefonit celular në dorë në dhomën e fshehtë, e vërejtur në 8.4% të tyre.

Të tjera shkelje procedurale të vërejtura kishin të bënin me respektimin e procedurave për zgjedhësit të cilët kërkuan asistencë gjatë procesit të votimit¹¹⁷. Një shkelje procedurale e vërejtur në një numër relativisht të lartë rastesh ishte mosplotësimi i deklaratës përkatëse nga personat që asistojnë zgjedhës që kanë nevojë për asistencë, i vërejtur në 6.3% të QV-ve, ndërsa në 2.29% të QV-ve u vërejtën persona që ndihmuan më tepër se një zgjedhës për të votuar dhe në 3.05% të tyre ishin komisionerët e QV-së që asistuan zgjedhësit.


¹¹⁵ Ekran mbrojtës pas të cilit zgjedhësit votojnë, dhoma e fshehtë, duhet të vendoset në një pozicion të tillë që të mund të shihet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe vëzhguesit, në mënyrë që të mund të shihet se çfarë veprimesh po kryen zgjedhësi pas tij. Kjo është e rëndësishme për të evituar fotografimin e votës apo të tjera mënyra manipulimi të rezultetit zgjedhor.

¹¹⁶ Si psh.: lejim i zgjedhësve që të votojnë pa u kontrolluar nëse ishin timbrosur më parë (1.53% e QV-ve) apo pa paraqitur një dokument të vlefshëm identifikimi (1.15% e QV-ve); mostimbrosje e zgjedhësve me bojën e posaçme përpara se të votojnë (1.91% e QV-ve) apo tentativa të zgjedhësve për të votuar jashtë dhomës së fshehtë (2.29% e qendrave të votimit).

¹¹⁷ Kjo është një e drejtë që u njihet zgjedhësve, por e kushtëzuar me tre rrethana. Personi që i asiston duhet të jetë një zgjedhës i asaj qendre votimi, një person mund të asistojë vetëm një zgjedhës dhe në momentin kur kërkohet asistencë, si zgjedhësi që asistohet ashtu edhe ai që asiston plotësojnë një deklaratë dhe gjeneralitetet e të dyve mbahen shënim. Anëtarët e komisionit të qendrës së votimit, në çdo rast, e kanë të ndaluar të asistojnë zgjedhës për të votuar.

Fenomen shqetësues vazhdoi të ishte votimi familjar ose në grup. Tentativa për votim familjar ose në grup janë vënë re në thuajse një të katërtën e qendrave të votimit ose në 22.52% të tyre¹¹⁸.

Shqetësues ishte fotografimi i votës prej zgjedhëseve¹¹⁹. Në %4.58 të qendrave të votimit, vëzhguesit kanë vërejtën së paku një rast të zgjedhësve që kanë fotografuar votën. Në gjysmën e qendrave të votimit ku ky fenomen u vërejt, Komisioni e vuri re dhe, përgjithësisht, mbajti shënim gjeneralitetet e zgjedhësve, por vetëm në dy QV u njoftuan organet e policisë.



Gjatë Ditës së Zgjedhjeve, në masë të vogël u vërejtën raste të ndërhyrjes apo të ushtrimit të presionit ndaj zgjedhësve apo ndaj komisionerëve të qendrave të votimit, si dhe tentativa për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve apo kryer propagandë elektorale, në afërsi apo brenda Qendrave të Votimit.

Në 2.49% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast i personave që ndërhyjnë në punën e komisionit të qendrës së votimit dhe në 1.91% të tyre u vërejtën persona që ushtruan presion mbi komisionerët. Në shumicën e rasteve, personat që ndërhyjnë në punën e komisionit apo ushtruan presion ndaj komisionerëve ishin përfaqësues të forcave politike, dhe në pak raste ishin nëpunës shtetërorë.

Raste të propagandimit elektorale apo tentativa për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve u vërejtën brenda Qendrës së Votimit në masën 3.44% dhe në afërsi të tyre në masën 4.77%.

Në një numër të kufizuar rastesh u vërejt edhe ushtrimi i presionit ndaj zgjedhësve, brenda ambienteve në 1.34% të QV-ve dhe në afërsi të tyre në 2.64% të QV-ve. Sërisht, personat që ushtruan presion mbi zgjedhësit ishin në pjesën dërrmuese militante partiakë dhe në një numër shumë të vogël rastesh nëpunës shtetërorë.


Vëzhguesit e KVV-së vlerësuan mungesën e elementëve infrastrukturorë,

118 Akoma më shqetësues mbeti fakti se komisionerët nuk e ndaluan votimin familjar në rreth 37% të qendrave të votimit ku ai është vërejtur.

119 Nëse anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit vënë re se zgjedhësi fotografon votën, duhet ta ndalojnë zgjedhësin të hedhë votën në kuti, të mbajnë shënim gjeneralitetet e zgjedhësit dhe të njoftojnë Policinë për faktin.

të cilët vështirësuan mundësinë e personave me aftësi të kufizuara të ushtronin të drejtën e votës. Infrastruktura e Qendrave të Votimit e bënte të pamundur aksesimin dhe të votuarin në mënyrë të pavarur të personave me aftësi të kufizuara fizike në %22.41 të qendrave të votimit dhe të vështirë në %37.93 të qendrave të votimit. Vetëm %39.66 e qendrave të votimit u vlerësuan nga vëzhguesit si të aksesueshme nga personat me aftësi të kufizuara fizike.

Ndërkohë, vetëm 48.06% e qendrave të votimit ishin të pajisura me fletë votimi në alfabetin Braille, që mundësonte votimin e pavarur të zgjedhësve që nuk shikojnë.



Vëzhguesit e KVV e vlerësuan në total procesin e votimit në përfundim të vëzhgimit në referencë me katër dimensione¹²⁰. Atmosfera e përgjithshme e votimit u vlerësua si “shumë e mirë” nga 49.8% e vëzhguesve dhe si “e mirë” nga 49% e tyre¹²¹. Zbatimi i procedurave të votimit prej komisionerëve u vlerësua si “shumë e mirë” nga 54.99% e vëzhguesve dhe si “e mirë” nga 41.96% e vëzhguesve¹²². Njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve u vlerësuar si “shumë e mirë” nga 22.35% e vëzhguesve dhe si “e mirë” nga 65.49% e tyre¹²³. Ndërsa kualifikimi i komisionerëve të Qendrave të Votimit u vlerësua si “shumë e mirë” nga 41.02% e vëzhguesve dhe si “i mirë” nga 56.33% e tyre¹²⁴.


120 (1) Atmosfera e përgjithshme e votimit; (2) Zbatimi i procedurave prej komisionerëve të qendrave të votimit; (3) Njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve dhe (4) Kualifikimi i anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit. Vlerësimi është kryer në shkallë “shumë mirë”, “mirë”, “problematike” dhe “shumë problematike”. Në të katër këto dimensione kanë mbizotëruar vlerësimet “shumë mirë” dhe “mirë”, dhe në përqindje fare të vogla vlerësimet “problematike” dhe “shumë problematike”.

121 Në 1.2% të qendrave të votimit atmosfera e përgjithshme e votimit u vlerësua si “problematike” dhe në asnjë QV si “shumë problematike”.

122 Në 3.05% të qendrave të votimit zbatimi i procedurave nga komisionerët u vlerësua si “problematike” dhe në asnjë QV nuk është vlerësuar si “shumë problematike”.

123 Në 12.16% të qendrave të votimit njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve u vlerësua si “problematike” dhe në tre qendra votimi si “shumë problematike”.

124 Në 2.65% të qendrave të votimi kualifikimi i komisionerëve u vlerësua si “problematik” dhe në 2 qendra votimi si “shumë problematik”.



4) Mbyllja e qendrave të votimit

Shtyrja e orarit të mbylljes së votimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe, veçanërisht, mënyra jo konsistente me të cilën komisionerët e qendrave të votimit u njoftuan për këtë shtyrje, krijoi konfuzion dhe mbyllje të QV-ve në orare të ndryshme. Normalisht, sipas Kodit Zgjedhor, qendrat e votimit do të duhej të mbylleshin në orën 19:00.

Vëzhguesit e KVV vërejtën se 3.1% e QV-ve u mbyllën përpara këtij orari, 17.9% e qendrave të votimit u mbyllën sipas orarit ligjor (19:00), 6.8% e tyre u mbyllën mes orës 19:00 dhe 19:30, 45.44% u mbyllën mes orës 19:30 dhe 20:00 dhe 26.8% e QV-ve u mbyllën në orën 20:00, sipas vendimit të KQZ-së të marrë në ditën e zgjedhjeve.

Pas shtyrjes së afatit të votimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në 13.81% të qendrave të votimit u paraqitën për të votuar zgjedhës pas orës 19:00. Por kjo shtyrje dhe mënyra jo konsistente me të cilën u njoftuan komisionerët e qendrave të votimit, solli edhe mosmarrëveshje në lidhje me mbylljen e qendrave të votimit. Konkretisht, në 5.5% të qendrave të votimit, ato u mbyllën jo me dakordësinë e të gjithë komisionerëve¹²⁵.

Përgjithësisht, procedurat e mbylljes së qendrave të votimit dhe administrimit të materialeve zgjedhore janë respektuar me përpikmëri, përveçse në një numër shumë të vogël QV-sh. Përgjithësisht shkeljet procedurale kanë patur të bëjnë me neglizhencën në numërimin e fletëve të votimit të papërdorura (%1.5 e QV-ve), të dëmtuara (2 qendra votimi) apo numërimin nënshkrimeve në listën e zgjedhësve (%0.8 e QV-ve).


Në 1.5% të qendrave të votimit jo të gjithë komisionerët ishin dakord me rezultatin e numërimit dhe në 0.97% të qendrave të votimit jo të gjithë rezultatet dhe vendimet e marra nga komisioni i qendrës së votimit u pasqyruan në procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit.

¹²⁵ Në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit komisionerët u kanë deklaruar vëzhguesve të KVV se ata nuk kishin marrë asnjë njoftim zyrtar për shtyrjen e orarit të votimit.

Nisja e materialeve zgjedhore drejt vendit të numërimit të votave është zbatuar me përpikmëri në të gjitha qendrat e votimit, por në disa prej QV-ve ka patur vonesa të vogla të makinës që do të transportonte materialet.

Në fund të procesit të vëzhgimit, vëzhguesit e KVV vlerësuan mbarëvajtjen e procesit në përgjithësi. Në 76.3% të qendrave të votimit vëzhguesit i vlerësuan procedurat e mbylljes së qendrave të votimit si “shumë të mira”, në 22.5% si “të mira” dhe në 1% si “problematike”. Vetëm në një qendër votimi, procedurat e mbylljes u vlerësuan nga vëzhguesit si “shumë problematike”.

VLERËSIMI I PROCEDURAVE TË MBYLLJES SË QV-ve



C. Votimi në institucione penitenciare

Kuadri ligjor parashikon ngritjen e qendrave të votimit në ambiente të posaçme, të cilat më së shumti janë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) si burgjet dhe paraburgimet.

Këto institucione, të kritikuar vazhdimisht për gjendjen që ofrojnë, kanë një numër të konsiderueshëm votuesish. Mbi këto institucione janë ngritur vazhdimisht akuza politike për mekanizma masivë të drejtimit të votës së të dënuarve si dhe për përdorimin politik të eksponentëve kriminalë që vuajnë dënimin në to.

Për zgjedhjet e 25 Qershorit 2017 u ngritën 21 Qendra Votimi në ambiente të posaçme, nga të cilat 19 në instucione penitenciare dhe 2 në rezidenca të tjera (një në shtëpi të moshuarish dhe një në shtëpi oficerash). Numri i votuesve në këto qendra votimi ishte 3 166 votues.

Ky proces zgjedhor shënoi për herë të parë kufizimin e të drejtës së votës aktive për zgjedhësit e prekur nga legjislacioni për dekriminalizimin.

Për shkak të ngritjes së qendrave të votimit përtej afatit ligjor, të problematikave të trashëguara në zbatim të Ligjit “Për gjendjen civile” dhe të mungesës së transparencës për zbatimin e legjislacionit për dekriminalizimin, listat e zgjedhësve në institucionet penitenciare mbartën pikëpyetje.

Në 23 Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale në vend, në afërsi të ditës së zgjedhjeve, gjendeshin 5 600 persona që vuanin heqjen e lirisë, 1 367 prej të cilëve prekeshin nga legjislacioni i dekriminalizimit. Për shkak të numrit të votuesve nën limitin e poshtëm ligjor, vetëm në 19 IEVP u ngritën Qendra Votimi¹²⁶, për t'iu dhënë 3 046 zgjedhësve mundësinë për të votuar.

Nga raportimet e vëzhguesve¹²⁷ rezultoi se në 10 QV procesi i votimit nisi në orarin e parashikuar dhe në 8 QV votimi u mbyll në orën 19:00, sipas Kodit Zgjedhor. Ecuria e votimit në këto qendra votimi u ndoq dhe nga 13 vëzhgues të subjekteve të tjera, partiakë ose jo.

Në këto qendra votuan 1 838 persona (60.34%), nga të cilët 309 ishin votues me leje votimi nga Gjykata. Ndërkaq, 108 persona nuk u lejuan të votonin, pasi 107 prej tyre nuk ishin të pajisur me kartë identiteti dhe 1 sepse nuk kishte emrin në listën e zgjedhësve.

Nga vrojtimi i kryer nga vëzhguesit rezultoi se procesi i votimit brenda qendrave të votimit ishte i qetë dhe normal. Ecuria e ditës së zgjedhjeve përsa u vëzhgua, nuk evidentoi forma intimidimi apo drejtimi të votës te personat që vuajnë heqjen e lirisë në këto institucione.

Megjithatë, shprehen rezerva për vërtetësinë e konstatimit të mësipërm, për shkak të pamundësisë së kryerjes së një vëzhgimi më të plotë dhe para-prak përpara ditës së zgjedhjeve në këto institucione.

D. Procesi i numërimit

1) Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore

Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore u zbatua në përputhje me rregullat e Kodit Zgjedhor në të gjitha Vendet e Numërimit të Votave (VNV), por u shoqërua me disa probleme që kishin të bënin me logjistikën dhe infrastrukturën. Problemet e vëna në dukje ishin: pamjaftueshmëria e hapësirës për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore në 5.5% të VNV-ve, numri i lartë i personave të pranishëm gjatë procesit të dorëzimit të materialeve në 8.5% të VNV-ve dhe radhët e gjata të krijuara gjatë këtij procesi në 42% të VNV-ve.

Në 5.5% të VNV-ve pati së paku një rast të kutive të klasifikuara si kuti të parregullta.

Në të gjitha VNV-të u zbatuan procedurat e Kodit Zgjedhor për marrjen në dorëzim dhe ruajtjen e kutive të parregullta.

2) Aktiviteti i grupeve të numërimit të votave dhe zbatimi i procedurave të numërimit

Zgjedhjet e 25 qershorit 2017 shënuan një precedent pozitiv, duke qenë se numërimi i votave përfundoi rreth 48 orë pas mbylljes së procesit të votim-

¹²⁶ Paraburgimi Vlorë, Burgu Bënc, Burgu Berat, Burgu Durrës, Burgu Sarandë, Burgu Shënkoll, Burgu Kukës, Burgu Fushë-Krujë, Burgu Patos, Burgu Elbasan, Burgu Drenovë, Burgu Tiranë, Burgu 313, Burgu Rragozhinë, Burgu Tiranë, Burgu Ali Demi, Burgu Burrel, Burgu Kukës.

¹²⁷ Në ndjekje të ecurisë së votimit në qendrat e votimit në institucionet penitenciare, për herë të parë në vend, u krye një monitorim tërësor për Zgjedhjet e 25 Qershorit. Procesi i votimit në këto qendra, gjatjet e të cilave nuk janë pjesë e gjetjeve të konkluduara nga VBS/SBO, u ndoq nga 22 vëzhgues afatshkurtër të caktuar në turne 14 orësh ose 7 orësh në varësi të qendrave të votimit.

it¹²⁸. Pavarësisht se ky proces numërimi ishte më i shpejti në shtatë procese zgjedhore të ndodhur prej vitit 2005, sërish u vërejtën ndërprerje të procesit të numërimit në një numër të konsiderueshëm të VNV-ve dhe rifillim jo në orën e paralajmëruar.

Procesi i numërimit u zhvilluar me ritme të shpejta dhe në përgjithësi me një mbarëvajtje të qetë pa cënuar rendin¹²⁹. Megjithatë, në 13.3% të VNV-ve pati së paku një rast mosmarrëveshje mes anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave (GNV) në lidhje me procedurat apo rezultatet e numërimit. Këto mosmarrëveshje vetëm në një rast u zgjidhën me konsensusin e anëtarëve të GNV-së. Në të gjitha rastet e tjera u nevojiti ndërhyrja e KZAZ-së.

Procedurat e vendosjes së fletëve të votimit përballë objektivit të kamerave përgjithësisht u zbatua me përpikmëri. Në përgjithësi, teknika mbështetëse funksionoi mirë, me përjashtim të disa rasteve sporadike¹³⁰. Në tri VNV pati ndërprerje të energjisë elektrike dhe si rrjedhim teknika mbështetëse nuk funksionoi. Në të gjitha këto raste u zbatua udhëzimi i KQZ-së për funksionimin e teknikës mbështetëse.

Në 47.7% të VNV-ve, vëzhguesit e vlerësuan procedurën e vlerësimit dhe numërimit të fletëve të votimit nga GNV-të “shumë mirë” dhe në 52.3% si “të mirë”.

3) Aktiviteti i Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor gjatë numërimit të votave

Anëtarët e Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) iu përgjigjën në kohë kërkesave të ardhura nga Grupet e Numërimit të Votave, përveç KZAZ-së Nr. 87, ku u vërejtën vonesa në reagimin e komisionerëve.

Problematike vazhdon të mbetet në një pjesë të konsiderueshme të KZAZ-ve ndërhyrja e vëzhguesve në ecurinë e punës së Grupeve të Numërimit të Votave¹³¹, duke komentuar me zë të lartë, duke iu drejtuar atyre apo edhe duke tejkaluar shiritin ndarës dhe duke hyrë në zonën ku numëroreshin votat¹³².

Identifikimi i personave të ndodhur brenda VNV-ve u evidentua sërish si një problematikë e vazhdueshme në brendësi të VNV-ve pasi një pjesë e ketyre personave nuk i mbajnë në vend të dukshëm akreditimet e tyre. Në pothuajse

¹²⁸ Prej vitit 2005, me përcaktimin e numërimit të përqendruar të votave në Shqipëri, problematikë e theksuar ka qenë tejzgjatja e numërimit. Në rastin e Zgjedhjeve Vendorë të vitit 2011, në KZAZ-në Nr. 35 - Bashkia Tiranë, numërimi i votave zgjati për gjatë ditë.

¹²⁹ Vetëm në tre VNV (VNV nr. 44, 58 dhe 66) vëzhguesit kanë vërejtur se marrja në dorëzim nga GNV-të dhe rikthimi i kutive të votimit prej tyre pas numërimit nuk është kryer në qetësi.

¹³⁰ Në VNV-të Nr. 11 dhe 78 vëzhguesit raportuan se jo në të gjithë monitorët mund të shihej me qartësi fleta e votimit. Në VNV-në Nr. 84 vëzhguesit raportuan se një prej ekraneve ishte i vendosur shtrembër dhe vështirësonte të shiheshin qartë votat.

¹³¹ Sipas ligjit zgjedhor, vëzhguesit në asnjë rast nuk kanë të drejtë t’u drejtohen numëruesve të votave. Çdo komunikim mes vëzhguesve dhe numëruesve duhet bërë nëpërmjet KZAZ-së.

¹³² Në KZAZ-në Nr. 60 u vërejt kryetari i Partisë Socialiste Rroskovec të shkante pranë njëres prej tavolinave të numërimit të votave duke prekur fletët e votimit.

të gjitha VNV-të, vëzhguesit kanë raportuar grumbullime të militantëve partiakë jashtë Vendeve të Numërimit të Votave si dhe prani të shtuar të tyre edhe brenda në VNV pa mbajtur akreditimin përkatës në vend të dukshëm.

Në 11.1% të VNV-ve¹³³, në së paku një rast ka qenë e nevojshme ndërhyrja e forcave të rendit për të rivendosur rregullin në VNV dhe për të nxjerrë jashtë persona të paautorizuar apo persona që ndërhyjnë në punën e anëtarëve të grupeve të numërimit të votave. Ndërkaq, incidente të izoluara janë vërejtur në disa VNV, por pa e ndikuar negativisht procesin e numërimit.

Në 45.5% të VNV-ve, vëzhguesit e KVV-së vlerësuan se përmbushja e detyrimeve të Kodit Zgjedhor nga anëtarët e KZAZ-ve dhe kualifikimi i tyre ishte “shumë i mirë”, në 54.3 e vlerësuan si “të mirë” dhe në 0.2% si “problematike”.

¹³³ Në KZAZ-të me numër 20, 34, 42, 56, 83, 47, 49 dhe 50, u thirrën forcat e rendit me vendim të KZAZ-së dhe në KZAZ-të me numër 5 dhe 11, forcat e rendit u thirrën nga Kryetari i KZAZ-së, por pa një vendim me shkrim të KZAZ-së.

XV. REKOMANDIME

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional mbi bazën e përvojave zgjedhore, i drejtuar nga matura dhe largpamësia, është një qasje e munguar në traditën elektorale vendase. Në përvojën demokratike vendase, problematikat apo mangësitë reale ose nuk kanë marrë adresimin e nevojshëm ose janë shndërruar në argumenta për eksperimentalizma jokontekstual.

Në vijueshmëri të ndjekjes së proceseve të përgjithshme zgjedhore dhe të zhvillimeve institucionale të lidhura ngushtësisht me proceset zgjedhore, si dhe përsa u vërejt specifikisht në këtë proces zgjedhor, renditen një tërësi rekomandimesh për të ardhmen.

Rekomandimet propozohen në frymën e një dialogu të pritshëm, i cili duhet të jetë gjithëpërfshirës. Një dialog, i cili mbi bazën e zotimeve të hershme dhe së fundmi edhe të Marrëveshjes Politike, pritet të sjellë një ripërtëritje tërësore të rregullimeve të derisotme në realizimin e proceseve zgjedhore.

Nga kjo ripërtëritje e kuadrit ligjor, për nga vetë natyra e çështjeve normative, nuk mund të priten zgjidhje perfekte. Megjithatë kjo ripërtëritje duhet të ndërtohet në terma afatgjatë të dakortësisë politike duke përfshirë edhe perspektivat e mundshme për përmirësimin e tij në të ardhmen.

Në rezultante të së tërës, thelbi i reformimit duhet të jetë garantimi i aspiratave madhore të barazisë së votës, si dhe i të drejtave e lirive politike të qytetarit.

Në këtë funksion rekomandimet e paraqitura mbi bazën e monitorimit të kryer janë të grupuara, jo sipas kriterit të rëndësisë së tyre, në dy listime si parësore dhe dytësore.

Rekomandimet parësore listojnë çështje si objektiva thelbësore të një procesi reformues si ai i përshkruar më lart dhe politikisht i zotuar. Ndërsa rekomandimet dytësore, janë alternativa ligjore si materializim i ekspertizës së KVV-së në adresimin konkret dhe jo përfundimtar të problematikave të evidentuara.

A. Rekomandime parësore

- Formula e përfaqësimit politik, pra e përcaktimit të mandateve parlamentare, duhet të rishihet në arritjen e një përfaqësimi politik sa më demokratik duke ruajtur parimin e barazisë së votës.
- Kuadri ligjor zgjedhor duhet t'i nështrohet një reformimi të thelluar dhe integral, në adresim të problematikave të përvojave zgjedhore, si një proces transparent dhe gjithëpërfshirës në diskutimin e perspektivave.
- Kuadri ligjor zgjedhor duhet të rishihet për të forcuar pavarësinë institucionale dhe për të ndaluar frymën apo sjelljen e shfaqur deri më sot të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si një trupë që mund të veprojë mbi ligjin.
- Nevojitet rishikimi i funksionimit të Kolegjit Zgjedhor në raport me

Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Gjykatën Kushtetuese, në raport me precedentët e vendosur deri tani.

- Konstituimi i anëtarësisë dhe rregullimi i punës së trupës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet t'i nënshtrohet një parashikimi të ri ligjor në sigurimin e një trupe të pavarur tërësisht nga vullnetet politike.
- Mekanizmi i transparencës dhe i kontrollit të veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore duhet t'i nënshtrohet një ristrukturimi tërësor në sigurimin e një mekanizmi efektiv.
- Është domosdoshmëri rregullimi i funksionimit të Komisioneve Zonale si institucione lokale në administrimin zgjedhor, me detyrime të qarta të transparencës
- Një hap i parë drejt eliminimit të ndikimit të partive politike mbi procesin zgjedhor mund të jetë depolitizimi i plotë i komisioneve zonale zgjedhore.
- Nevojitet të parashikohen instrumenta dhe procedura ligjore efektive në hetim të rasteve dhe të denoncimit të rasteve të drejtimit të votës.
- Grupi Task-Force si një precedent dhe model pozitiv i ndërveprimit institucional vlen të merret në konsideratë për rregullimin e funksionimit të institucioneve përgjegjëse për proceset zgjedhore, por me një kuadër ligjor të detajuar, që e garanton bashkëpunimin ndërinstitucional si dhe me një transparencë të plotë të punës.
- Raporti dhe gjetjet e Grupit Task-Force për këtë proces zgjedhor duhet të adresohen dhe ndiqen me rigorozitet nga institucionet përgjegjëse dhe të hetimit.

B. Rekomandime dytësore

- Për shkak se çdo formulë e ndërtimit të përfaqësimit politik mbart mangësitë specifike, në kontekstin shqiptar nevojitet një formulë që të ruaj pluralizmin e ofertave politike dhe hapjen ndaj lëvizjeve politike të reja në kundërvënien me establishmentin politik.
- Nevojitet një rimodelim i statutit të partive politike duke i dhënë më shumë një profil të një entiteti publik. Kjo për të lehtësuar aksesin publik në legjislacionin e brendshëm, vendimmarrjen dhe financat e partive politike.
- Infrastruktura mbështetëse në administrimin e procesit zgjedhor nevojitet të jetë një strukturë fikse e ndjekur nga administrata e Komisioni Qendror të Zgjedhjeve dhe mos të ndërtohet sërish për çdo proces zgjedhor.
- Nevojitet një ripërcaktim i organikës dhe i detyrave funksionale të

administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve brenda dhe jashtë periudhës zgjedhore, veçanërisht i atyre të lidhura ngushtë me sigurimin e transparencës.

- Vlerësohet pozitivisht mundësia e rikthimit në konstituimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të bazuar në përfaqësimin ndërinstitucional dhe me përcaktim kushtetues.
- Veprimtarisë financiare të partive politike dhe të subjekteve zgjedhore nevojitet t'i kushtohet një akt ligjor i veçantë, i detajuar në përkufizimet mbi çështjet financiare të partive politike, si dhe të parashikojë një mekanizëm kontrolli specifik mbi veprimtarinë financiare të partive politike.
- Vlerësohet se përdorimi i llogarive bankare transparente nga subjektet zgjedhore do të ndihmonte në sigurimin e transparencës së veprimtarisë financiare.
- Gjykohet i nevojshëm parashikimi i pavlefshmërisë dhe i përsëritjes së votimit në rastet e provimit të fenomenit të drejtimit të votës.
- Mundësia e përdorimit të listave të zgjedhësve në mekanizma të drejtimit dhe kontrollit të votës, bën të nevojshëm kufizimin e aksesit të tyre prej subjekteve zgjedhore apo subjekteve të tjera.
- Nevojiten masa specifike ligjore për ndalimin e ndërmarrjes së fushatës zgjedhore të parakohshme nga subjektet zgjedhore.
- Është e domosdoshme të vendosen ndalesa të mirëpërcaktuara që kufizojnë qeverisjen qendrore dhe atë lokale në veprimtarinë e tyre me efekte të mundshme elektorale.
- Ndërveprimi institucional, Task-Force ose jo, nxitet si një model efikas në përmballjen e problematikave mbi kontrollimin dhe kryerjen e transparencës së plotë të veprimtarisë financiare të subjekteve zgjedhore.

XVII. FJALORTH

AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AP	Avokati i Popullit
APD	Partia Aleanca Popullore për Drejtësi
BMM	Bordi i Monitorimit të Mediave
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
FRD	Fryma e Re Demokratike
GNV	Grupi i Numërimit të Votave
IEVP	Institucion i Ekzekutimit të Veprave Penale
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KQV	Komisioni i Qendrës së Votimit
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVV	Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
KZ	Kolegji Zgjedhor
KZAZ	Komisioni Zonal i Administrimit Zgjedhor
LIBRA	Partia Lista e Barabartë
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
MEGA	Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
ODK	Open Data Kit
PAA	Partia Ambientaliste Agrare
AAK	Partia Aleanca Arbnore Kombëtare
AD	Partia Aleanca Demokratike
ADK	Partia Aleanca Demokristiane
AP	Partia Aleanca Popullore
PBDKSH	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar
PD	Partia Demokratike
PDIU	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet
PDS	Partia Demokracia Sociale
PKDSH	Partia Kristiandemokrate e Shqipërisë
PKSH	Partia Komuniste e Shqipërisë
POV	Plani Orientues i Veprimit
PR	Partia Republikane
PS	Partia Socialiste
PSD	Partia Socialdemokrate
QV	Qendër Votimi
RKGJC	Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile
SFIDA	Partia Sfida për Shqipërinë
VBS	Vëzhgim me Bazë Statistike
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNV	Vend i Numërimit të Votave
ZAZ	Zonë e Administrimit Zgjedhor
ZGJC	Zyrë e Gjendjes Civile
ZRZ	Zyrë Rajonale Zgjedhore

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Shtojcë

**XVII. GJETJET E VËZHGIMIT TË
BAZUAR STATISTIKISHT /
STATISTICAL BASED OBSERVATION
(VBS/SBO)**

1. HYRJE

Për vëzhgimin e Ditës së Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të 25 Qershorit 2017, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë aplikoi metodologjinë e Vëzhgimit të Bazuar Statistikisht (VBS), e përdorur me sukses deri më sot në mbi 40 vende të botës.

Në Shqipëri kjo metodologji, e përdorur për të vlerësuar mbarëvajtjen e procesit gjatë Ditës së Votimit, u zbatua për herë të tretë. Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë ishte e para organizatë vendore që e zbatoi në rang vendi në Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2013 dhe aplikimi i tij edhe në Zgjedhjet e 25 qershorit 2017 shënon përvojën e dytë të KVV-së në zbatimin e kësaj metodologjie.

Vëzhgimi i Ditës së Zgjedhjeve sipas metodologjisë VBS, mbështetet në vëzhgimin e një numri Qendrash Votimi, të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Përzgjedhja rastësore e tyre, garanton që këto qendra votimi të jenë përfaqësuese të të gjitha qendrave të votimit të vendit dhe kështu gjetjet e vëzhgimit mund të përgjithësohen për të gjithë vendin, me një nivel të lartë konfidence dhe brenda një marzhi gabimi.

2. METODOLOGJIA E VËZHGIMIT

a) Përzgjedhja e qendrave të votimit

Për vëzhgimin e ditës së zgjedhjeve të 25 qershorit 2017, KVV përzgjodhi rastësisht 541 Qendra Votimi (QV) si kampion vëzhgimi. Bazuar në këtë kampion prej 541 QV-sh, gjetjet e dala mund të përgjithësohen për të gjithë vendin me një marzh gabimi deri në 4% dhe një nivel konfidence prej 95%. Përlllogaritja e marzhit real të gabimit varion për çdo pyetje, në varësi të proporcionit të përgjigjeve për secilën alternativë. *(Më poshtë në secilin rast, përbri të dhënave për pyetjet është evidentuar marzhi i gabimit).*

Për të garantuar që i gjithë territori i vendit të përfaqësohet në mënyrë të barabartë dhe mos të rezultojnë Zona Zgjedhore të mbipërfaqësuar apo nënpërfaqësuar, qendrat e votimit u përzgjodhën specifikisht sipas metodologjisë së “kampionimit rastësor të shtresëzuar”. Sipas kësaj teknike, brenda çdo Zone Zgjedhore (Qarku) u përzgjodhën rastësisht një numër qendrash votimi, proporcionalisht me peshën që ai qark kishte në totalin e qendrave të votimit në rang vendi¹.

¹ Shpërndarja e qendrave të votimit të përzgjedhura sipas qarqeve ishte: Elbasan 55; Berat 31; Dibër 26; Vlorë 45; Korçë 47; Fier 60; Gjirokastrë 24; Durrës 46; Shkodër 42; Kukës 18; Tiranë 121 dhe Lezhë 26.

b) Metodatat e vëzhgimit dhe raportimit

Qendrat e votimit u vëzhguan, kryesisht, nga dy vëzhgues të stacionuar, me turne prej 7 orësh secili. Vëzhguesit e turnit të parë u paraqitën në qendrat e votimit në orën 06:00 dhe vëzhguan procedurat e përgatitjes dhe të hapjes së tyre, si dhe procesin e votimit përgjatë pjesës së parë të ditës, deri në orën 13:00. Vëzhguesit e turnit të dytë vëzhguan procesin e votimit përgjatë pjesës së dytë të ditës, nga ora 13:00 deri në mbylljen e tyre, si dhe procedurat e mbylljes së qendrave të votimit dhe dërgimin e materialeve zgjedhore e të kutive të votimit drejt vendeve të numërimit të votave.

Të gjithë vëzhguesit e angazhuar nënshkruan “*Deklaratën e Angazhimit dhe Paanësisë*”, e cila përbën një zotim të tyre në respektimin e parimeve dhe vlerave të Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë. Këta vëzhgues iu nënshtruan trajnimit me objekt parimet bazë të vëzhgimit të zgjedhjeve nga grupet qytetare, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej të qenit vëzhgues i pavarur, elementët kryesorë të procesit gjatë ditës së zgjedhjeve, problematikat më tipike që vëzhguesit mund të hasnin gjatë ditës së zgjedhjeve, si dhe metodologjinë apo metodat që do të përdornin vëzhguesit gjatë ditës së zgjedhjeve për të mbledhur dhe transmetuar të dhënat drejt Qendrës Operative (QO) të KVV-së.

Në funksion të mbledhjes, regjistrimit dhe sistematizimit të gjetjeve gjatë Ditës së Zgjedhjeve, vëzhguesit përdorën një set formularësh të standardizuar:

- i. *Formulari për procedurat e hapjes së Qendrës së Votimit;*
- ii. *Formulari për procedurat e votimit;*
- iii. *Formulari për procedurat e mbylljes së Qendrës së Votimit;*
- iv. *Formulari i incidenteve.*

Vëzhguesit e Turnit të Parë u paraqitën në qendrat e votimit në orën 06:00 dhe vëzhguan procesin e përgatitjes për hapjen e qendrës. Pasi qendrat e votimit u hapën, vëzhguesit plotësuan “*Formularin për procedurat e hapjes së Qendrës së Votimit*” dhe transmetuan të dhënat drejt Qendrës Operative. Në përfundim të Turnit të Parë, në orën 13:00, vëzhguesit plotësuan formularin për procedurat e votimit për pjesën e parë të ditës dhe i transmetuan të dhënat drejt QO-së. Vëzhguesit e Turnit të Dytë plotësuan “*Formularin për procedurat e votimit*” për pjesën e dytë të ditës në momentin kur qendra e votimit u mbyll dhe i transmetuan të dhënat drejt qendrës operative.

Pas përfundimit të procedurave të mbylljes së Qendrave të Votimit dhe nisjes së materialeve zgjedhore drejt Vendeve të Numërimit të Votave, vëzhguesit plotësuan “*Formularin për procedurat e mbylljes së Qendrës së Votimit*” dhe transmetuan të dhënat drejt QO-së. Nëse në Qendrat e Votimit ku ishin përcaktuar vëzhgues ndodhën eventualisht incidente, vëzhguesit plotësuan “*Formularin e incidenteve*” dhe e transmetuan informacionin menjëherë drejt QO-së.

Në Qendrën e Mbledhjes së të Dhënave u angazhuan në total 80 operatorë gjatë Ditës së Zgjedhjeve, të ndarë me nga 40 operatorë në secilin turn. Nga

këta, 36 operatorë ishin përgjegjës për mbledhjen dhe hedhjen në sistem të të dhënave nga vëzhguesit e stacionuar në QV-të e përzgjedhura rastësisht. Ndërsa 4 operatorë ishin përgjegjës për linjën e dedikuar për incidentet dhe raportimet speciale nga vëzhguesit e lëvizshëm apo vëzhguesit në nivelin e KZAZ-ve.

Për të transmetuar të dhënat, u përdorën dy mënyra komunikimi ndërmjet vëzhguesve dhe Qendrës Operative. Kryesisht u komunikua me anë të thirrjeve telefonike sipas një rendi ciklik nga operatorët e QO-së, të cilët i pasqyronin të dhënat në një sistem *on line*, i ndërtuar në faqen *Web Ona Systems*. Një mënyrë kjo e përdorur me sukses në disa procese të përgjithshme apo të pjesshme nga KVV, që prej vitit 2007.

Mënyrë tjetër alternative komunikimi ishte përdorimi i aplikacionit për telefona Android (ODK Collect), me anë të cilit vëzhguesit mund të plotësonin formularët e vëzhgimit direkt në telefonin e tyre celular, duke bërë që të dhënat të ngarkoheshin në mënyrë automatike në sistemin online të mbledhjes së të dhënave. Kjo mënyrë e përcjelljes së të dhënave gjatë Ditës së Zgjedhjeve u përdor nga rreth 10% e totalit të vëzhguesve. Kjo përvojë shënoi në këtë proces zgjedhor, herën e parë të përcjelljes së të dhënave sipas kësaj teknologjie dhe përbëri një risi për organizatat vendase të vëzhgimit të zgjedhjeve në rang global.

c) Mënyra si janë prezantuar gjetjet

Të dhënat e mbledhura nga vëzhguesit u integruan dhe u analizuan nga ekipi i analistëve të të dhënave të KVV-së në bashkëpunim me DI (Democracy International).

Gjatë Ditës së Zgjedhjeve, vëzhguesit e angazhuar mbuluan në mënyrë sistematike 532 Qendra Votimi, prej nisjes së procesit të votimit deri në dërgimin e materialeve drejt Vendeve të Numërimit të Votave. Në 9 Qendra Votimi, për arsye të ndryshme, vëzhguesit nuk arritën të mbulonin procesin në të gjithë elementët në mënyrë të besueshme. Për këtë arsye, të dhënat e mbledhura nga këta vëzhgues nuk u përfshinë në analizën finale të të dhënave.

Në mënyrë që të ruhej proporcioni i qendrave të votimit mes qarqeve të ndryshme, sipas kampionimit origjinal, që reflektonte proporcionin real të numrit të QV-ve për çdo qark, në totalin e QV-ve në rang vendi u përjashtuan nga analiza finale të dhënat e mbledhura nga 8 qendra votimi të tjera të cilat ishin pjesë e qarqeve të mbipërfaqësuar. Tetë qendrat e votimit, të dhënat e të cilave u përjashtuan nga analiza finale u përzgjedhën në mënyrë rastësore. Në këtë mënyrë, kampioni final i Qendrave të Votimit reflektoi peshën e secilit qark në numrin total të QV-ve në rang vendi. Kësisoj, rezultatet e mëposhtme bazohen në të dhënat e mbledhura nga 524 Qendra Votimi.

Më poshtë janë prezantuar rezultatet e secilit aspekt të vëzhguar gjatë Ditës së Zgjedhjeve. Këto të dhëna, të cilat mund të përgjithësohen për të gjithë vendin, gjenden në tabelat përgjatë tesktit, së bashku me marzhin përkatës të gabimit.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Përpos sa më sipër, në tekst gjenden të dhëna edhe për situata apo veprime të varura nga pyetjet primare, të cilat kanë marrë përgjigje vetëm në ato qendra votimi ku ka patur një fenomen që kërkonte përgjigje ndaj tyre. Për shkak se këto Qendra Votimi nuk ishin përzgjedhur në mënyrë rastësore, të dhënat e marra prej tyre nuk mund të përgjithësohen në rang vendi.

Tabelat përbëhen nga pesë elementë të cilët janë “*alternativat e pyetjes*” (Kolona 1), “*vlera e vërejtur*”, e cila i referohet përqindjes së qendrave të votimit në të cilat një fenomen është vërejtur (Kolona 2), “*marzhi i gabimit*”, i cili i referohet marzhit të gabimit mbi dhe nën përqindjen e raportuar të përlogaritur për secilën pyetje (Kolona 3) dhe “*kufiri i poshtëm dhe i sipërm*”, i cili i referohen përqindjes reale të fenomenit përkatës në rang vendi, me nivel konfidence 95% (Kolona 4 dhe 5).

3. G JETJET NGA VËZHGIMI ME BAZË STATISTIKORE

Në total, në këtë analizë përfshihen gjetjet nga 524 qendra votimi, të shpërndara në mënyrë proporcionale sipas zonave zgjedhore të vendit (qarqe). Në Tabelën 1 paraqitet shpërndarja e numrit të qendrave të votimit të përfshira në analizë sipas qarqeve.

Tabela 1 - Shpërndarja e qendrave të votimit të përfshira në analizë, sipas qarqeve

Qarku	Numri i qendrave të votimit të mbuluara	Proporcioni i qendrave të votimit të mbuluara në totalin e qendrave të votimit të vendit
Berat	30	5.73%
Dibër	25	4.77%
Durrës	45	8.59%
Elbasan	53	10.11%
Fier	58	11.07%
Gjirokastrë	23	4.39%
Korçë	46	8.78%
Kukës	17	3.24%
Lezhë	25	4.77%
Shkodër	41	7.82%
Tiranë	117	22.33%
Vlorë	44	8.40%
Totali	524	100%

Paraqitja e gjetjeve është bërë sipas linjës kohore që ndjek procesi i votimit, ku ishin bazuar edhe formularët që përdorën vëzhguesit për të regjistruar gjetjet.

Në seksionin 2.1. janë paraqitur të dhënat mbi procedurat e hapjes së qendrave të votimit; në seksionin 2.2. të dhënat mbi procedurat e votimit dhe në seksionin 2.3 të dhëna mbi procedurat e mbylljes së qendrave të votimit.

a. Procedurat e hapjes së qendrave të votimit

a1) Orari i hapjes së qendrave të votimit

Sipas përcaktimit ligjor, Qendrat e Votimit duhet të hapen për zgjedhësit në orën 07:00.

Rezultoi se 78.31% e Qendrave të Votimit u hapën në kohën e caktuar, 17.66% u hapën me vonesa deri në gjysmë ore dhe 3.26% u hapën me vonesa deri në një orë. Një numër shumë i vogël Qendrash Votimi, në 0.77%, u hapën me vonesa të konsiderueshme, deri në një orë e gjysmë pas orarit të përcaktuar.

Në 44 prej qendrave të votimi që u hapën pas orës 07:00, u vërejtën zgjedhës në radhë që prisnin për të votuar në momentin e hapjes dhe në 51 prej tyre nuk kishte zgjedhës në radhë.

Tabela 2 - Ora e hapjes së qendrave të votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Qendra u hap në orën 07:00	78.31%	3.54%	74.77%	81.85%
B) Qendra u hap mes orës 07:00 dhe 07:30	17.66%	3.27%	14.38%	20.93%
C) Qendra u hap mes orës 07:30 dhe 08:00	3.26%	1.53%	1.74%	4.79%
D) Qendra u hap mes orës 08:00 dhe 08:30	0.77%	0.75%	0.02%	1.52%
E) Qendra u hap mes orës 08:30 dhe 09:00	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
F) Qendra nuk u hap deri në orën 09:00	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

a2) Prezenca e komisionerëve të qendrave të votimit në momentin e hapjes

Numri i komisionerëve të Qendrave të Votimit është shtatë dhe procesi i votimit mund të nisë vetëm nëse së paku katër prej tyre janë të pranishëm.

Në 79.08% të Qendrave të Votimit ishin të pranishëm të gjithë komisionerët në momentin e nisjes së procesit të votimit. Në 12.55% të QV-ve, procesi nisi në prezencë të 6 komisionerëve, në 5.38% nisi në prezencë

të pesë komisionerëve dhe në 2.99% me numrin minimal të komisionerëve të kërkuar nga ligji. Në asnjë QV, procesi i votimit nuk nisi në kundërshtim me ligjin, me më pak se katër komisionerë.

Asnjë prej QV-ve nuk u hap në mungesë të Kryetarit apo të Sekretarit të komisionit të Qendrës së Votimit, pra në të gjitha QV-të mungesat ishin të anëtarësisë. Rezultoi se nga komisionerët që nuk ishin prezentë gjatë momentit të hapjes së Qendrave të Votimit, 32 përfaqësonin Partinë Demokratike, 14 Partinë Socialiste, 15 Lëvizjen Socialiste për Integrim dhe 15 Partinë Republikane.

Tabela 3 - Sa anëtarë të Komisionit ishin të pranishëm në momentin e hapjes së Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
7 anëtarë	79.08%	3.56%	75.53%	82.64%
6 anëtarë	12.55%	2.90%	9.65%	15.45%
5 anëtarë	5.38%	1.97%	3.41%	7.35%
4 anëtarë	2.99%	1.49%	1.50%	4.48%
3 anëtarë	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

a3) Organizimi dhe infrastruktura e Qendrave të Votimit

Gjatë përgatitjes së Qendrave të Votimit duhet që tryezat, karriget dhe dhoma e fshehtë të vendosen në pozicion të tillë që të garantohet lëvizja e lirshme e zgjedhësve, në mënyrë që të mos krijohen problematika gjatë votimit.

Në 98.7% të QV-ve, vëzhguesit vlerësuan se organizimi i ambientit të brendshëm siguronte lëvizje të lirshme të personave.

Tabela 4 - A gjykoni se tryezat, karriget dhe dhoma e fshehtë u vendosën në mënyrë që të sigurohej lëvizja e lirshme e zgjedhësve?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.70%	0.97%	97.73%	99.67%
B) Jo	1.30%	0.97%	0.33%	2.27%

Si pjesë e procedurave të hapjes së Qendrës së Votimit, komisioni ka për detyrë të garantojë që materialet propagandistike që mund të ndodhen brenda qendrës apo në mjedisin rrethues të saj, në një rreze deri në 150 metra, të hiqen.

Në 1.93% të Qendrave të Votimit, komisionerët nuk morën masa që të mos kishte materiale propagandistike brenda QV-së dhe në 2.14% të Qendrave të Votimit nuk u morën masa që të mos kishte materiale propagandistike në një rreze prej 150 metrash.

Tabela 5 - A i hoqi Komisioni i Qendrës së Votimit materialet propagandistike që mund të ndodheshin brenda Qendrës?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	71.48%	3.88%	67.60%	75.37%
B) Jo	1.93%	1.18%	0.74%	3.11%
C) NA	26.59%	3.80%	22.79%	30.39%

Tabela 6 - A i hoqi Komisioni i Qendrës së Votimit materialet propagandistike që mund të ndodheshin në një rreze prej 150 metrash nga Qendra?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	69.51%	3.98%	65.54%	73.49%
B) Jo	2.14%	1.25%	0.89%	3.38%
C) NA	28.35%	3.89%	24.46%	32.24%

a4) Respektimi i procedurave standarde gjatë hapjes së qendrave të votimit

Përpara nisjes së votimit, komisionerët plotësojnë Procesverbalin e Hapjes së Qendrës së Votimit.

Rezultoi se vetëm në një Qendër Votimi, “Procesverbali i hapjes së Qendrës së Votimit” nuk u plotësua nga anëtarët e Komisionit.

Tabela 7 - A u plotësua Procesverbali i Hapjes së Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.81%	0.38%	99.42%	100.19%
B) Jo	0.19%	0.38%	-0.19%	0.58%

Kutia e votimit duhet të kontrollohet në prani të të gjithë anëtarëve dhe të vëzhguesve të pranishëm në QV, përpara vulosjes së saj dhe hapjes së QV-së.

Në 1.35% të QV-ve, kutia e votimit nuk u kontrollua në prani të të gjithë anëtarëve dhe vëzhguesve. Në 3 prej këtyre Qendrave të Votimit, vëzhguesit gjykuan se procedura nuk u përmbush pasi komisionerët nuk i njihnin procedurat dhe në 3 prej tyre ata gjykuan se ishte pasojë e neglizhencës së komisionerëve.

Tabela 8 - A u kontrollua kutia e votimit në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit dhe vëzhguesve?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.65%	0.99%	97.66%	99.64%
B) Jo	1.35%	0.99%	0.36%	2.34%

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

KVV

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

Komisioni i Qendrës së Votimit e vulosë kutinë e votimit me 4 kode sigurie përpara nisjes së procesit të votimit dhe votimi nuk mund të nisë pa u siguruar kutia.

Në të gjitha Qendrat e Votimit, kutitë e votimi u mbyllën me katër kodet e sigurisë para nisjes së procesit të votimit.

Tabela 9 - A u mbyllën dhe vulosën kutitë me kodet e sigurisë përpara fillimit të votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	100%	0.00%	0.00%	100%
B) Jo	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Kodet e sigurisë të vulave, të cilat mbyllet kutia e votimit, shënohen në Procesverbalin e Hapjes së Qendrës së Votimit, i cili vendoset brenda në kutinë e votimit përpara se votimi të nisë.

Në 1.35% të Qendrave të Votimit, "Procesverbali i hapjes së Qendrës së Votimit" nuk u vendos brenda në kutinë e votimit. Në këto raste, në dy prej QV-ve, vëzhguesit gjykuan se arsyeja ishte neglizhencë e komisionerëve, në dy se ishte mosnjohje e kuadrit ligjor dhe në tre raste vëzhguesit nuk dhanë gjykim nëse ishte neglizhencë apo mosnjohje e kuadrit ligjor.

Tabela 10 - A u fut Procesverbali i Hapjes së Qendrës së Votimit me kodet e sigurisë me të cilat u vulos kutia e votimit brenda në kuti përpara fillimit të votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.65%	0.99%	97.66%	99.64%
B) Jo	1.35%	0.99%	0.36%	2.34%

a5) Materialet e nevojshme për procesin e votimit

Në 0.58% të Qendrave të Votimit munguan materialet e nevojshme për nisjen e votimit në momentin e hapjes. Në njërin rast mungonte boja për timbrosje, në një rast mungonin procesverbalet dhe në një rast mungonte boja për vulat.

Tabela 11 - A ishte e pajisur Qendra me të gjitha materialet e nevojshme për procesin e votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.42%	0.66%	98.76%	100.08%
B) Jo	0.58%	0.66%	-0.08%	1.24%

a6) Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të hapjes së qendrave të votimit

Vëzhguesit i vlerësuan procedurat e hapjes së Qendrave të Votimit si “shumë të mira” në 65.88% të QV-ve, si “të mira” në 32.55% të tyre dhe si “me probleme” në 1.37%. Në vetëm 1 QV, vëzhguesi i vlerësoi procedurat e hapjes si “shumë problematike”.

Tabela 12 - Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të hapjes së Qendrës së Votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Shumë mirë	65.88%	4.11%	61.77%	70.00%
B) Mirë	32.55%	4.07%	28.48%	36.62%
C) Me probleme	1.37%	1.01%	0.36%	2.38%
D) Shumë problematike	0.20%	0.38%	-0.19%	0.58%

b. Procedurat e votimit

b1) Persona që ndodhen në Qendrën e Votimit

Në 85.96% të Qendrave të Votimit, komisionet funksionuan me numrin e plotë të komisionerëve, pra 7 anëtarë. Në 8.27%, funksionuan me gjashtë anëtarë, 4.42% me pesë anëtarë dhe 1.35% me numrin minimal të për një procedure korrekte, 4 komisionerë. Në asnjë QV, komisionet nuk funksionuan me më pak se 4 anëtarë.

Tabela 13 - Numri i anëtarëve të Komisionit të Qendrave të Votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
3 anëtarë	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
4 anëtarë	1.35%	0.99%	0.36%	2.34%
5 anëtarë	4.42%	1.77%	2.66%	6.19%
6 anëtarë	8.27%	2.37%	5.90%	10.64%
7 anëtarë	85.96%	2.99%	82.98%	88.95%

Në kuadër të respektimit të politikave për barazinë gjinore, rezultoi se edhe në këtë proces përfshirja e grave në komisionet e nivelit të tretë ishte problematike. Shumica e Komisioneve të Qendrave të Votimit, në 35.82%,

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

patën në përbërje të anëtarësisë një grua, në 22.64% patën në përbërje 2 anëtarë gra dhe në 11.44% patën në përbërje 3 anëtarë gra.

Në 8.96% të Qendrave të Votimit, mazhoranca e komisioneve u përbë nga anëtarë gra, nga të cilat në 5.97% të QV-ve komisionet përbëheshin me 4 anëtarë gra, në 2.59% me 5 anëtarë gra dhe në 0.50% me 6 anëtarë gra. Në asnjë nga Qendrat e Votimit nuk rezultoi se anëtarësia e komisionit ishte e tëra me gra.

Tabela 14 - Numri i grave anëtare në Komisionet e Qendrave të Votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
0 anëtarë	21.14%	3.99%	17.15%	25.14%
1 anëtarë	35.82%	4.69%	31.13%	40.51%
2 anëtarë	22.64%	4.09%	18.55%	26.73%
3 anëtarë	11.44%	3.11%	8.33%	14.55%
4 anëtarë	5.97%	2.32%	3.65%	8.29%
5 anëtarë	2.49%	1.52%	0.97%	4.01%
6 anëtarë	0.50%	0.69%	-0.19%	1.19%
7 anëtarë	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Kodi Zgjedhor rregullon se cilët janë personat që mund të qendrojnë në ambientin e brendshëm të Qendrës së Votimit. Personat që mund të qendrojnë përgjatë procesit të votimit janë Anëtarët dhe Sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit, zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre dhe vëzhguesit e akredituar, të cilat janë të pajisur me dokumentin përkatës të akreditimit.

Në 7.25% të Qendrave të Votimit, u vërejt në së paku një rast prezencë e personave të paautorizuar brenda ambienteve të votimit. Në asnjë prej rasteve, personat e paautorizuar nuk ishin pjesë forcave të rendit. Në 15 nga rastet e vërejtura, personat e paautorizuar brenda QV-së u identifikuan si përfaqësues të një force politike dhe në 24 raste vëzhguesit nuk mundën të identifikonin se çfarë përfaqësonin.

Tabela 15 - A u vërejtën persona të paautorizuar në ambientin e brendshëm të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	7.25%	2.22%	5.03%	9.47%
B) Jo	92.75%	2.22%	90.53%	94.97%

b2) Organizimi dhe infrastruktura e qendrës së votimit

Ekrani mbrojtës pas të cilit zgjedhësit votojnë, në dhomën e fshehtë, duhet të vendoset në një pozicion të tillë që të gjithë anëtarët e komisionit dhe vëzhguesit të shohin çfarë veprimesh kryejnë zgjedhësit. Gjithashtu, ai duhet të vendoset në një pozicion të atillë që të mund të garantohet fshehtësia e votës, pra komisionerët dhe vëzhguesit duhet të jenë në gjendje të shohin veprimet që kryen zgjedhësi ndërkohë që voton, por pa arritur të identifikojnë zgjedhjen e tij në Fletën e Votimit.

Në 87.93% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit vlerësuan se pozicioni i dhomës së fshehtë nuk lejonte të kontrolloheshin veprimet që kryenin zgjedhësit brenda saj. Ndërsa në 1.72% të QV-ve u vlerësua se vendosja e dhomës së fshehtë lejonte që të identifikoheshin zgjedhja e votuesit në Fletën e Votimit.

Tabela 15 - A ishte vendosur dhoma e fshehtë në pozicion të tillë që të mund të shihej nga të gjithë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	87.93%	2.79%	85.14%	90.73%
B) Jo	12.07%	2.79%	9.27%	14.86%

Tabela 16 - A ishte e vendosur dhoma e fshehtë në mënyrë të tillë që të mund të sigurohej fshehtësia e votës?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.28%	1.11%	97.16%	99.39%
B) Jo	1.72%	1.11%	0.61%	2.84%

Në të njëjtën mënyrë si dhoma e fshehtë, edhe kutia e votimit duhet të vendoset në një pozicion të tillë që të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit të mund ta shohin atë lirisht.

Në 6.3% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit vlerësuan se vendosja e kutisë së votimit nuk ishte e vendosur në një pozicion të tillë që të gjithë komisionerët dhe vëzhguesit ta shihnin atë lirisht.

Tabela 17 - A ishte vendosur kutia e votimit në pozicion të tillë që të mund të shihej nga të gjithë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	93.70%	2.08%	91.62%	95.78%
B) Jo	6.30%	2.08%	4.22%	8.38%

Komisioni i Qendrës së Votimit ngarkohet të afishojë posterat me udhëzimet mbi procedurat e votimit në një vend të dukshëm dhe të

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

KQV

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë

përshtatshëm brenda Qendrës së Votimit.

Në 7.46% të Qendrave të Votimit, rezultoi se posterat me udhëzimet mbi procedurat e votimit nuk u afishuan në ambientin e Qendrës së Votimit.

Tabela 18 - A ishin të afishuar posterat për të shpjeguar procedurat e votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	92.54%	2.25%	90.29%	94.79%
B) Jo	7.46%	2.25%	5.21%	9.71%

Kuadri ligjor rregullon se Lista e Zgjedhësve duhet të jetë e afishuar në një vend të dukshëm jashtë Qendrës së Votimit.

Rezultoi se në 7.29% të Qendrave të Votimit, Lista e Zgjedhësve nuk u afishuan në afërsi të Qendrës së Votimit.

Tabela 19 - A ishte e afishuar Lista e Zgjedhësve?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	92.71%	2.23%	90.47%	94.94%
B) Jo	7.29%	2.23%	5.06%	9.53%

b3) Respektimi i procedurave të votimit

Para se zgjedhësit t'i jepet Fleta e Votimit, ajo vuloset në pjesën e pasme të saj nga Sekretari me Vulën e KQV-së dhe Kryetari me Vulën e Kryetarit të KQV-së. Vetëm në një Qendër Votimi, vëzhguesi vërejt një rast në të cilin fleta e votimit nuk u vulos me të dyja vulat.

Tabela 20 - A pati raste kur fleta e votimit nuk u vulos me vulën e Kryetarit të KQV-së dhe vulën e QV-së?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	0.19%	0.37%	-0.18%	0.57%
B) Jo	99.81%	0.37%	99.43%	100.18%

Në momentin që zgjedhësit paraqiten në Qendrën e Votimit, një anëtar i Komisionit i kontrollon ata në të dy duart nëse janë timbrosur me bojën e posaçme me të cilën ata timbrosen përpara se të votojnë.

Në 1.53% të Qendrave të Votimit u vërejt se kjo procedurë nuk u respektua

në së paku një rast. Në total, rezultoi se kjo procedurë nuk u respektua për 16 zgjedhës.

Tabela 21 - A pati raste kur zgjedhësit u pajisën me fletën e votimit përpara se të kontrolloheshin në të dy duart nëse ishin timbrosur më parë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.53%	1.05%	0.48%	2.58%
B) Jo	98.47%	1.05%	97.42%	99.52%

Në momentin që zgjedhësi hyn në ambientin e Qendrës së Votimit, identifikohet me emrin e tij pranë komisionerit përkatës dhe paraqet një dokument të vlefshëm identifikimi.

Në 1.15% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast kur zgjedhësit u lejuan të votojnë pa paraqitur një dokument të vlefshëm identifikimi. Në total, rezultoi se kjo u vërejt për 8 zgjedhës.

Tabela 22 - A pati raste të zgjedhësve që u lejuan të votojnë pa paraqitur dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose kartë identiteti)?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.15%	0.91%	0.23%	2.06%
B) Jo	98.85%	0.91%	97.94%	99.77%

Përpara se të pajiset me Fletën e Votimit, zgjedhësi duhet të timbrosset me bojën e posaçme.

Në 1.91% të Qendrave të Votimit, u vërejt së paku një rast i zgjedhësve që u lejuan të votojnë pa u timbrosur me bojën e posaçme. Në total u vërejtën 18 raste të zgjedhësve që u lejuan të votojnë pa u timbrosur me bojën e posaçme.

Tabela 23 - A pati raste të zgjedhësve që u lejuan të votojnë pa u timbrosur me bojën e posaçme?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.91%	1.17%	0.74%	3.08%
B) Jo	98.09%	1.17%	96.92%	99.26%

Në Regjistrin e Zgjedhësve, i cili administrohet nga Kryetari i KQV-së, çdo zgjedhës përpara se të pajiset me fletën e votimit duhet të nënshkruajë në krahu të emrit të tij.

Në 6.68% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast ku zgjedhësit nuk firmosën vetë në Regjistrin e Zgjedhësve. Në total, u vëzhguan 90 raste të tilla.



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Tabela 24 - A pati raste kur dikush tjetër firmosi për një zgjedhës në listë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	6.68%	2.14%	4.54%	8.82%
B) Jo	93.32%	2.14%	91.18%	95.46%

Kur në Qendrën e Votimit paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është i regjistruar në Listën e Zgjedhësve, por është i pajisur me vendim gjykate për të votuar në atë Qendër Votimi, ai ka të drejtë të votojë. Sekretari i KOV-së shënon në Regjistrin e Posaçëm emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen e zgjedhësit, numrin e vendimit të Gjykatës të paraqitur dhe numrin e dokumentit të identifikimit.

Në 5.53% të Qendrave të Votimit, u paraqit së paku një zgjedhës që nuk e kishte emrin në listë, i pajisur me një vendim gjykate. Në total u paraqitën 39 zgjedhës të tillë në të gjitha Qendrat e Votimit të vërejtura. Për vetëm 3 nga këta shtetas nuk u mbajtën shënimet përkatëse në Regjistrin e Posaçëm.

Tabela 25 - A u paraqitën për të votuar zgjedhës që nuk e kishin emrin në listën e zgjedhësve, me vendim gjykate?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	5.53%	1.96%	3.58%	7.49%
B) Jo	94.47%	1.96%	92.51%	96.42%

Çdo votues duhet të futet në Dhomën e Fshtehtë për të shenjuar në Fletën e Votimit subjektin zgjedhor. Nëse votuesi voton jashtë Dhomës së Fshtehtë, Fleta e Votimit konsiderohet e pavlefshme dhe Kryetari i jep një tjetër fletë votimi. Nëse veprimi përsëritet, qytetari nuk lejohet më të votojë dhe rasti mbahet shënim në librin e protokollit.

Në 2.29% të Qendrave të Votimit, u vërejt së paku një zgjedhës që shenjoji Fletën e Votimit jashtë Dhomës së Fshtehtë. Në total, rezultuan se 16 raste ku zgjedhësit shenjuan Fletën e Votimit jashtë Dhomës së Fshtehtë.

Tabela 26 - A pati raste të zgjedhësve që votuan jashtë dhomës së fshtehtë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	2.29%	1.28%	1.01%	3.57%
B) Jo	97.71%	1.28%	96.43%	98.99%

Përdorimi i telefonit celular brenda Qendrës së Votimit është i ndaluar, me përjashtim të Sekretarit të Qendrës së Votimit i cili është i lejuar si përgjegjës për komunikimin e Komisionit me jashtë.

Në 8.97% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një zgjedhës që përdori telefonin celular në ambientin e brendshëm. Në total, u vërejtën 129 raste të tilla.

Tabela 27 - A vërejtët ndonjë zgjedhës që përdori telefonin celular në ambientin e Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	8.97%	2.45%	6.52%	11.42%
B) Jo	91.03%	2.45%	88.58%	93.48%

Brenda Dhomës së Fshehtë, zgjedhësi nuk duhet të përdorë ose të disponojë aparat celular.

Në 8.4% të Qendrave të Votimit u vërejtën zgjedhës që u lejuan të qendronin në Dhomën e Fshehtë duke mbajtur në dorë aparat telefonik. Në total, u vërejtën 76 raste të zgjedhësve që qendruan në Dhomën e Fshehtë duke mbajtur në dorë aparat telefonik.

Tabela 28 - A vërejtët ndonjë zgjedhës me telefon celular në dorë në dhomën e fshehtë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	8.40%	2.37%	6.02%	10.77%
B) Jo	91.60%	2.37%	89.23%	93.98%

Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë shenjimin e Fletës së Votimit apo tjetër, mund të kërkojë ndihmën e një familjari që e ka emrin në listën e zgjedhësve, ose të një zgjedhësi tjetër në listën e QV-së. Çdo person që ndihmon një zgjedhës duhet të plotësojë deklaratën përkatëse dhe identiteti i tij mbahet shënim nga komisionerët.

Në 6.3% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast ku persona të tretë asistuan zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike për të votuar.

Tabela 29 - A vërejtët raste kur personi që shoqëronte zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike nuk plotësoi deklaratën përkatëse?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	6.30%	2.08%	4.22%	8.38%
B) Jo	93.70%	2.08%	91.62%	95.78%

Çdo person ka të drejtë të ndihmojë vetëm një zgjedhës tjetër për të votuar, në rast të kushteve të pamundësisë fizike të personit.

Në 2.29% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast, ku një person asistoi më tepër se një zgjedhës për të votuar. Në total, u vërejtën 16 raste të tilla.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Tabela 30 - A vërejtët raste kur ndonjë person ndihmoi më shumë se një zgjedhës me aftësi të kufizuara për të votuar?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	2.29%	1.28%	1.01%	3.57%
B) Jo	97.71%	1.28%	96.43%	98.99%

Anëtarët e Komisionit të QV-së nuk lejohen të ndihmojnë votuesit në asnjë rrethanë.

Në 3.05% të Qendrave të Votimit u vërejtën anëtarë të Komisionit, të cilët asistuan zgjedhës për të votuar. Në total, u vërejtur 35 raste të tilla.

Tabela 31 - A vërejtët ndonjë anëtar të komisionit të Qendrës së Votimit të ndihmonte për të votuar zgjedhës me aftësi të kufizuara për të votuar?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	3.05%	1.47%	1.58%	4.53%
B) Jo	96.95%	1.47%	95.47%	98.42%

Zgjedhësit nuk duhet të lejohen të votojnë në asnjë rrethanë, nëse ata nuk disponojnë një dokument të vlefshëm identifikimi, refuzojnë të timbrosen me bojën e posaçme, nuk kanë emrin në Listën e Zgjedhësve ose nuk kanë një vendim gjykatë që i lejon të votojnë.

Në 32.44% të Qendrave të Votimit, u vërejt së paku një rast i personave të cilët nuk u lejuan të votonin për shkaqe ligjore. Në total, u vërejtën 218 persona të cilët nuk u lejuan të votonin për shkaqe ligjore nga komisionerët. Prej tyre, 94 persona nuk dispononin një dokument të vlefshëm identifikimi, 107 persona nuk ishin pjesë e Listës së Zgjedhësve të Qendrës së Votimit, 4 persona refuzuan t'iu timbrohej gjishti dhe 13 nuk u lejuan për arsye të tjera.

Tabela 32 - A pati zgjedhës që u paraqitën në Qendrën e Votimit dhe nuk mundën të votonin?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	32.44%	4.01%	28.43%	36.45%
B) Jo	67.56%	4.01%	63.55%	71.57%

Në rrethanat, kur në Qendrën e Votimit pamundësohet vijimi normal i procedurave të votimit, për shkak të eventualiteteve, Komisioni i QV-së merr vendim për të ndërprerë votimin deri në një moment të dytë kur merr zgjidhje situata që e pamundësoi procesin e votimit.

Në 4.4% të Qendrave të Votimit, votimi u ndërpre së paku një herë gjatë Ditës së Zgjedhjeve.

Tabela 33 - A u ndërpre votimi në ndonjë moment gjatë kohës së vëzhgimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	4.40%	1.76%	2.64%	6.15%
B) Jo	95.60%	1.76%	93.85%	97.36%

b4) Parregullësi në votim

Në Dhomën e Fshehtë, zgjedhësit duhet të qendrojnë individualisht përveçse në rastet kur me kërkesë të tyre kërkojnë që të asistohen nga të tretë.

Në 22.52% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast i tentativave të zgjedhësve për të hyrë në Dhomën e Fshehtë më shumë se një person. Në total, u vërejtën 617 raste të tilla.

Nga vëzhgimi rezultoi se në 31 QV, sjellja e komisionerëve u përpoq t'i ndalonte këto raste, ndërsa në 51 QV, sjellja e komisionerëve i toleroi këto raste.

Tabela 34 - A vërejtët raste kur në dhomën e fshehtë futeshin më shumë se një person?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	22.52%	3.58%	18.94%	26.10%
B) Jo	77.48%	3.58%	73.90%	81.06%

Në 2.67% të Qendrave të Votimit u vërejtën zgjedhës të timbrosur më parë, të cilët u paraqitën për të votuar. Në total u vërejtën 19 raste zgjedhësish të tillë. Në tre prej QV-ve, zgjedhësit u lejuan të votojnë nga anëtarët e KQV-së dhe në 11 nuk u lejuan. Në tre QV emri dhe gjeneralitetet e këtyre personave u mbajtën shënim në Librin e Protokollit, në tre QV të tjera nuk u mbajtën shënim dhe në tetë QV vëzhguesit nuk mundën të marrin informacion nëse ky veprim ishte kryer.

Tabela 35 - A u verifikua ndonjë rast i ndonjë zgjedhësi të timbrosur që u paraqit për të votuar?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	2.67%	1.38%	1.29%	4.05%
B) Jo	97.33%	1.38%	94.95%	98.71%

Në 2 Qendra Votimi u vërejtën zgjedhës që votuan më shumë se një herë. Në total u vërejtën 2 raste të tilla, një për çdo qendër votimi.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Tabela 36 - A vërejtët raste kur ndonjë person votoi më shumë se një herë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	0.38%	0.53%	-0.15%	0.91%
B) Jo	99.62%	0.53%	99.09%	100.15%

Në 6.87% të Qendrave të Votimit u vërejt së paku një rast i zgjedhësve që votuan për persona të tretë, të cilët ishin të pranishëm në Qendrën e Votimit. Në total u vërejtën 108 raste të tilla.

Tabela 37 - A vërejtët raste kur ndonjë person votoi për persona të tjerë që ishin të pranishëm?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	6.87%	2.17%	4.70%	9.04%
B) Jo	93.13%	2.17%	90.96%	95.30%

Në 2 qendra votimi u vërejtën persona që votuan për të tretë, të cilët nuk ishin të pranishëm në Qendrën e Votimit. Në total u vërejtën 2 raste të tilla, një në çdo Qendër Votimi.

Tabela 38 - A vërejtët raste kur u votua për person tjetër që nuk ishte i pranishëm?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	0.4%	0.5%	-0.1%	0.9%
B) Jo	99.6%	0.5%	99.1%	100.1%

Nëse anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit konstatojnë raste të fotografimit apo të tentativës për fotografim të Fletës së Votimit, ndalojnë votimi e personit, shpallin të pavlefshme Fletën e Votimit, mbajnë shënim gjeneralitetet e zgjedhësit dhe njoftojnë policinë.

Në 4.58% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit konstatuan së paku një rast të zgjedhësve që ë fotografuar votën. Në total, u vërejtën 28 raste të tilla. Në 12 nga QV-të ku u bë konstatimi, vëzhguesit vlerësuan se anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit e konstatuan fotografimin e Fletës së Votimit dhe në 12 raste të tjera jo. Nga 12 QV-të ku komisionerët e konstatuan fotografimin, në nëntë prej tyre u mbaj shënim eventualiteti, por vetëm në dy QV u bë njoftimi i organeve të Policisë.

Tabela 39 - A vërejtët ndonjë zgjedhës që fotografoi votën?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	4.58%	1.79%	2.79%	6.37%
B) Jo	95.42%	1.79%	93.63%	97.21%

Kryetari KQV-së mund të largohet për periudha të shkurtra kohe nga QV-ja, por vula e Kryetarit të KQV-së në asnjë rast nuk duhet të dalë jashtë saj. Në rastin kur largohet nga QV-ja, Kryetari i kalon Vulën e Kryetarit për përdorim anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike deri në çastin e rikthimit të tij.

Në 12.95% të Qendrave të Votimit, Kryetari u largua nga Qendra e Votimit pa e kaluar vulën për përdorim. Në 12.95% të QV-ve kryetari e ka lënë vulën në QV në momentin kur është larguar dhe në 18.13% të rasteve nuk është larguar nga QV-ja.

Tabela 40 - A ia kaloi vulën e Kryetarit të QV-së për përdorim anëtarit tjetër me të njëjtën përkatësi politike Kryetari i Komisionit në momentet kur u largua nga Qendra e Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	68.92%	4.05%	64.88%	72.97%
B) Jo	12.95%	2.94%	10.01%	15.89%
C) NA	18.13%	3.37%	14.76%	21.50%

b5) Situata e përgjithshme në të cilën u zhvillua votimi

Në 14.31% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit gjykuan se në QV u cënua mbarëvajtja e qetë dhe në rend e procesit. Në 26 prej këtyre rasteve, sipas gjykimit të vëzhguesve situata u krijua nga numri i madh i zgjedhësve në QV dhe në 47 raste nga paaftësia e komisionerëve për të menaxhuar situatën.

Tabela 41 - A pati momente kur në Qendrën e Votimit u krijua kaos apo rrëmujë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	14.31%	3.00%	11.31%	17.31%
B) Jo	85.69%	3.00%	82.69%	88.69%

Në 1.91% të Qendrave të Votimit, gjatë votimit u vërejtën materiale propagandistike në ambientet e brendshme. Në 3 raste materialet propagandistike ishin të Partisë Demokratike, në 6 raste të Partisë Socialiste, në 2 raste të Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe në 1 rast ishin të një partie tjetër.

Tabela 42 - A vërejtët në ndonjë moment gjatë votimit materiale propagandistike brenda Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.91%	1.17%	0.74%	3.08%
B) Jo	98.09%	1.17%	96.92%	99.26%

Në 2.49% të Qendrave të Votimit, u vërejt së paku një rast i personave që ndërhyjnë në punën e anëtarëve të komisionit të votimit. Në total kjo u vërejt

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

në 13 raste, në 9 prej të cilëve ishin përfaqësues të forcave politike, në dy raste nëpunës shtetërorë dhe në 2 raste ishin persona, për të cilët nuk u bë i mundur identifikimi prej vëzhguesit. Përfaqësuesit e partive politike që ndërhyjnë në punën e komisionit, në 4 raste ishin përfaqësues të Partisë Demokratike, në 3 raste të Partisë Socialiste dhe në dy raste të Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Tabela 43 - A vërejtët ndonjë person që ndërhyri në punën e Komisionit të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	2.49%	1.33%	1.15%	3.82%
B) Jo	97.51%	1.33%	96.18%	98.85%

Askush, përveç kryetarit të komisionit të qendrës së votimit nuk ka të drejtë të drejtojë punën e komisionit.

Në 2 QV, vëzhguesit vërejtën persona të paautorizuar që drejtonin punën e komisionit. Një prej rasteve ishte përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim dhe në rastin tjetër ishte një nëpunës shtetëror.

Tabela 44 - A vërejtët ndonjë person të paautorizuar që drejtonte punën e Komisionit të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	0.38%	0.53%	-0.15%	0.91%
B) Jo	99.62%	0.53%	99.09%	100.15%

Në 1.91% të Qendrave të Votimit, u vërejtën persona që ushtruan presion mbi anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit. 7 nga këto raste ishin përfaqësues të forcave politike (2 PD, 3 PS dhe 2 LSI). Në një rast ishte nëpunës shtetëror dhe në dy raste ishin persona të tjerë, të paidentifikuar nga vëzhguesit.

Tabela 45 - A vërejtët ndonjë person që ushtroi presion mbi anëtarët e Komisionit të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.91%	1.17%	0.74%	3.09%
B) Jo	98.09%	1.17%	96.91%	99.26%

Gjatë ditës së zgjedhjeve propaganda elektorale është e ndaluar.

Në 3.44% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit vërejtën persona të cilët kryen fushatë zgjedhore apo u përpoqën të ndikonin vullnetin e zgjedhësve brenda QV-së. Në total u vërejtën 18 raste të tilla, 15 prej të cilëve ishin përfaqësues të forcave politike, 2 ishin nëpunës shtetërorë dhe për 1 rast nuk u bë i mundur identifikimi prej nga vëzhguesit. 4 prej përfaqësuesve të forcave politike që kanë bërë fushatë brenda qendrës së votimit ishin të Partisë Demokratike, 6 të Partisë Socialiste dhe 5 të Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Tabela 46 - A vërejtët persona që bënin fushatë apo përpiqeshin të ndikonin në vullnetin e zgjedhësve brenda Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	3.44%	1.56%	1.88%	4.99%
B) Jo	96.56%	1.56%	95.01%	98.12%

Në afërsi të 4.77% të Qendrave të Votimit, u vërejtën raste të propagandimit elektoral apo tentativa për të ndikuar vullnetin e zgjedhësve. Në total u vërejtën 25 raste të tilla, në 22 prej të cilave personat që bënin fushatë apo përpiqeshin të ndikonin vullnetin e zgjedhësve përfaqësonin parti politike (5 Partia Demokratike, 10 Partia Socialiste, 6 Lëvizja Socialiste për Integrim), 1 ishte nëpunës shtetëror dhe 2 raste ishin të tjerë, të pidentifikuar nga vëzhguesit.

Tabela 47 - A vërejtët persona që bënin fushatë apo përpiqeshin të ndikonin në vullnetin e zgjedhësve në afërsi të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	4.77%	1.83%	2.95%	6.60%
B) Jo	95.23%	1.83%	93.40%	97.05%

Në 1.34% të Qendrave të Votimit, u vërejtën persona që intimidonin zgjedhësit në ambientin brenda Qendrës së Votimit. Në total u vërejtën 8 raste të tilla, në 6 prej të cilëve ishin përfaqësues partiakë dhe 1 nëpunës shtetëror. Në një rast nuk u bë e mundur që të identifikohet personi. Përfaqësuesit e partive politike që i bënin presion zgjedhësve brenda qendrës së votimit, në 1 rast përfaqësonin Partinë Demokratike, në 1 rast Partinë Socialiste dhe në 3 raste Lëvizjen Socialiste për Integrim.

Tabela 48 - A vërejtët ndonjë person që u bënte presion zgjedhësve brenda Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.34%	0.98%	0.35%	2.32%
B) Jo	98.66%	0.98%	97.68%	99.65%

Në 2.67% të Qendrave të Votimit, u vërejt së paku një episod presioni ndaj zgjedhësve në afërsi të tyre. Në total u vërejtën 19 episode të tilla, në 16 prej të cilave personi që intimidoi zgjedhësit ishte përfaqësues i një force politike (3 raste nga Partia Demokratike, 7 raste nga Partia Socialiste, 5 raste nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe 1 rast nga një tjetër parti). Në një rast personi që intimidonte zgjedhësit ishte nëpunës shtetëror, në 1 rast ishte pjesëtar i forcave të rendit dhe në një rast vëzhguesi nuk mundi ta identifikonte këtë person.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Tabela 49 - A vërejtët ndonjë person që u bënte presion zgjedhësve në afërsi të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	2.67%	1.38%	1.29%	4.05%
B) Jo	97.33%	1.38%	95.95%	98.71%

Në hapësirën 150 metra rreth Qendrës së Votimit nuk duhet të ketë materiale propagandistike gjatë Ditës së Zgjedhjeve.

Në 2.86% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit vërejtën materiale propagandistike në një distancë më pak se 150 metra dhe në 97.14% të tyre nuk pati materiale propagandistike në afërsi të QV-ve.

Tabela 50 - A kishte materiale propagandistike në hapësirën rreth 150 m nga Qendra e Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	2.86%	1.43%	1.43%	4.29%
B) Jo	97.14%	1.43%	95.71%	98.57%

Në asnjë QV nuk u vërejtën persona të armatosur brenda ambientit të Qendrës së Votimit. Megjithatë, në afërsi të dy qendrave të votimit u vërejtën persona të armatosur, të cilët nuk ishin forca të rendit.

Tabela 51 - A vërejtët ndonjë person të armatosur brenda Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
B) Jo	100%	0.00%	0.00%	0.00%

Tabela 52 - A vërejtët ndonjë person të armatosur në afërsi të Qendrës së Votimit, përveç forcave të Rendit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	0.38%	0.53%	-0.15%	0.91%
B) Jo	99.62%	0.53%	99.09%	100.15%

Vëzhguesit raportuan se në afërsi të 5.92% të Qendrave të Votimit u vërejtën grumbullime jo të zakonit të forcave të rendit.

Tabela 53 - A vërejtët grumbullim të forcave të rendit në afërsi të Qendrës së Votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	5.92%	2.02%	3.90%	7.94%
B) Jo	94.08%	2.02%	92.06%	96.10%

b6) Aksesit i personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit

Përshtatshmëria e Qendrave të Votimit për të mundësuar aksesin për zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike ishte e ndërtuar me tri alternativa, “Po”, “Pjesërisht” dhe “Jo”. Alternativa “Po” i referohej rasteve kur një person me aftësi të kufizuara fizike mund të hynte vetë deri brenda Qendrës së Votimit pa vështirësi. Nëse zgjedhësi me aftësi të kufizuara fizike kishte mundësi t’ua aksesonte qendrën e votimit me ndihmë minimale, qendra kategorizohej si “pjesërisht” e përshtatur dhe nëse infrastruktura e godinës e pamundësonte totalisht aksesin e personave me aftësi të kufizuara fizike pa ndihmën e konsiderueshme të personave të tjerë, ajo kategorizohej si e paaksesueshme.

Në 39.66% të Qendrave të Votimit, ambientet u vlerësuan si të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara fizike, 37.93% si pjesërisht të aksesueshme dhe 22.41% si të paaksesueshme.

Tabela 54 - A ishte Qendra e përshtatur për të mundësuar lehtësi aksesit dhe lëvizjeje për zgjedhës me aftësi të kufizuara fizike?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	39.66%	4.20%	35.46%	43.85%
C) Pjesërisht	37.93%	4.16%	33.77%	42.09%
B) Jo	22.41%	3.58%	18.84%	25.99%

Në 65.33% të Qendrave të Votimit, u paraqit së paku një zgjedhës me aftësi të kufizuara fizike. Në total, vëzhguesit identifikuan 540 zgjedhës të tillë në të gjitha qendrat e votimit. Vetëm në 15 QV këta zgjedhës u akomoduan nga komisionerët e Qendrës së Votimit në mënyrë të tillë që të mund të votonin vetë. Ndërsa në pjesën tjetër, këta persona votuan me asistencën e personave të tretë.

Tabela 55 - A u paraqitën zgjedhës me aftësi të kufizuara fizike për të votuar gjatë kohës së vëzhgimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	34.67%	4.08%	30.59%	38.76%
B) Jo	65.33%	4.08%	61.24%	69.41%

Në 48.6% e Qendrave të Votimit, rezultoi se ishin të pajisura me Fletë Votimi në alfabetin *Braille* për zgjedhësit e verbër. Në 51.4% të qendrave të votimit nuk kishte të tilla.

Tabela 56 - A ishte e pajisur Qendra me fletë votimi *Braille* për zgjedhësit e verbër?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	48.60%	4.41%	44.19%	53.01%
B) Jo	51.40%	4.41%	46.99%	55.81%

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Në 71% të Qendrave të Votimit, u paraqit së paku një zgjedhës i verbër për të votuar gjatë Ditës së Zgjedhjeve. Në total, në të gjitha QV-të u paraqitën 469 zgjedhës të verbër. Në 14 QV zgjedhësit e verbër përdorën fletët e votimit Braille, ndërkohë që në pjesën tjetër të tyre votuan me asistencën e personave të tretë.

Tabela 57 - A u paraqitën zgjedhës të verbër për të votuar gjatë kohës së vëzhgimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	28.79%	3.89%	24.90%	32.68%
B) Jo	71.21%	3.89%	67.32%	75.10%

Në 11.6% të Qendrave të Votimit, u paraqit së paku një zgjedhës që nuk dëgjonte. Në total, në të gjitha qendrat e votimit u paraqitën 131 zgjedhës të tillë.

Tabela 58 - A u paraqitën zgjedhës që nuk dëgjonin për të votuar gjatë kohës së vëzhgimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	11.66%	2.75%	8.91%	14.41%
B) Jo	88.34%	2.75%	85.59%	91.09%

b7) Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të votimit

Vëzhguesit e KVV kanë vlerësuar procesin e votimit në total në përfundim të tumit të vëzhgimit, në referencë me katër dimensione: (1) Atmosfera e përgjithshme e votimit; (2) Zbatimi i procedurave prej komisionerëve të qendrave të votimit; (3) Njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve dhe (4) Kualifikimi i anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit. Vlerësimi është kryer në shkallët: “shumë mirë”, “mirë”, “problematike” dhe “shumë problematike”. Në të katërt këto dimensione kanë mbizotëruar vlerësimet “shumë mirë” dhe “mirë”, dhe në përqindje fare të vogla vlerësimet “problematike” dhe “shumë problematike”.

Konkretisht, atmosfera e përgjithshme e votimit është vlerësuar si “shumë e mirë” nga 49.8% e vëzhguesve dhe si “e mirë” nga 49% e tyre. Në 1.2% të QV-ve atmosfera e përgjithshme e votimit u vlerësua si “problematike” dhe në asnjë QV si “shumë problematike”.

Tabela 59 - Atmosfera e përgjithshme e votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Shumë mirë	49.80%	4.39%	45.41%	54.19%
C) Mirë	49.00%	4.39%	44.61%	53.39%
B) Me probleme	1.20%	0.96%	0.25%	2.16%
B) Shumë problematike	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Zbatimi i procedurave të votimit prej komisionerëve u vlerësua si “shumë e mirë” nga 54.99% e vëzhguesve, si “e mirë” nga 41.96% e vëzhguesve, si “problematike” nga 3.05% dhe në asnjë QV nuk u vlerësua si “shumë problematike”.

Tabela 60 - Zbatimi i procedurave prej komisionerëve

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Shumë mirë	54.99%	4.40%	50.59%	59.39%
C) Mirë	41.96%	4.37%	37.59%	46.32%
B) Me probleme	3.05%	1.52%	1.53%	4.58%
B) Shumë problematike	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve u vlerësua si “shumë e mirë” nga 22.35% e vëzhguesve, si “e mirë” nga 65.49% e tyre, si “me probleme” nga 12.16% e vëzhguesve dhe si “shumë problematike” në 3 qendra votimi.

Tabela 61 - Njohja e rregullave të votimit prej zgjedhësve

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Shumë mirë	22.35%	3.62%	18.74%	25.97%
C) Mirë	65.49%	4.13%	61.36%	69.62%
B) Me probleme	12.16%	2.84%	9.32%	14.99%
B) Shumë problematike	0.59%	0.66%	-0.08%	1.25%

Kualifikimi i komisionerëve të Qendrave të Votimit, u vlerësua si “shumë e mirë” nga 41.02% e vëzhguesve, si “e mirë” nga 56.33% e tyre, si “problematik” nga 2.65% dhe si “shumë problematik” në 2 qendra votimi.

Tabela 62 - Kualifikimi i anëtarëve të komisionit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Shumë mirë	41.02%	4.36%	36.67%	45.38%
C) Mirë	56.33%	4.39%	51.93%	60.72%
B) Me probleme	2.65%	1.42%	1.23%	4.08%
B) Shumë problematike	0.41%	0.56%	-0.16%	0.97%

b8) Sjellja ndaj vëzhguesve

Vëzhguesit e akredituar të proceseve zgjedhore kanë të drejtë të kenë akses në të gjitha aspektet e procesit, sipas legjislacionit shqiptar.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Rezultoni së në 1.73% të QV-ve, vëzhguesit raportuan se u penguan në vëzhgimin e procesit zgjedhor nga komisionerët e Qendrave të Votimit dhe 98.27% e tyre nuk hasën pengesa.

Tabela 63 - A u penguat në procesin e vëzhgimit në ndonjë mënyrë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.73%	1.12%	0.61%	2.85%
B) Jo	98.27%	1.12%	97.15%	99.39%

c. Mbyllja e qendrave të votimit

c1) Orari i mbylljes së qendrave të votimit

Sipas Kodit Zgjedhor, Qendrat e Votimit do të duhej të mbylleshin në orën 19:00. Shtyrja me një orë e mbylljes së Qendrave të Votimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe veçanërisht mënyra jo konsistente me të cilën komisionerët u njoftuan për këtë shtyrje, krijoi konfuzion dhe mbyllje të procesit të votimit në orare të ndryshme.

U vërejt se në 3.1% të QV-ve, votimi u mbyll përpara orës 19:00 dhe në 17.9% të QV-ve u mbyll sipas orarit të zakonshëm ligjor 19:00. Ndërsa në pjesën tjetër, rezultoi se votimi në 6.8% të QV-ve u mbyll ndërmjet fashës 19:00-19:30, në 45.44% e QV-ve u mbyll ndërmjet fashës 19:30-20:00 dhe në 26.8% të QV-ve u mbyll në orën 20:00.

Në katër prej Qendrave të Votimit që u mbyllën përpara orës 19:00, u vërejtën zgjedhës në radhë të cilët prisnin të votonin, të cilët nuk mundën të votojnë. Vëzhguesit vlerësuan se rreth 15 zgjedhës nuk mundën të votojnë pasi Qendra e Votimit u mbyll para kohe. Në 11.9% të Qendrave të Votimit u paraqitën për të votuar zgjedhës pas orës 19:00.

Tabela 64 - Ora e mbylljes së Qendrave të Votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Qendra u mbyll përpara orës 19:00	3.11%	1.50%	1.61%	4.61%
B) Qendra u mbyll në orën 19:00	17.86%	3.31%	14.56%	21.17%
C) Qendra u mbyll mes orës 19:00 dhe 19:30	6.80%	2.17%	4.62%	8.97%
D) Qendra u mbyll mes orës 19:30 dhe 20:00	45.44%	4.30%	41.14%	49.74%
E) Qendra u mbyll në orën 20:00	26.80%	3.83%	22.97%	30.62%

Shtyrja e orarit të votimit me një orë dhe mënyra jo konsistente me të cilën u njoftuan Komisionet e Qendrave të Votimit, solli edhe mosmarrëveshje ndërmjet anëtarëve në lidhje me mbylljen e votimit.

Në 5.5% të Qendrave të Votimit, ato u mbyllën jo me dakordësinë e të gjithë komisionerëve.

Tabela 65 - A ishin dakord të gjithë anëtarët e Komisionit për mbylljen e votimit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	94.54%	1.97%	92.58%	96.51%
B) Jo	5.46%	1.97%	3.49%	7.42%

c2) Persona që ndodhen në Qendrën e Votimit gjatë procedurave të mbylljes

Gjatë procedurave të mbylljes së Qendrës së Votimit personat që lejohen të jenë të pranishëm janë vetëm komisionerët dhe vëzhguesit e akredituar.

Në 1.8% të Qendrave të Votimit, gjatë procedurave të mbylljes, u vërejtën persona brenda QV-ve të cilëve nuk iu evidentohej bexha e akreditimit. Në 8 raste, u bë e ditur se personat ishin përfaqësues të forcave politike dhe në një rast vëzhguesi nuk mundi të informohet se cilin subjekt përfaqësonte personi në ambientet e QV-së.

Tabela 66 - A kishte persona të paautorizuar në Qendrën e Votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	1.78%	1.15%	0.63%	2.94%
B) Jo	98.22%	1.15%	97.06%	99.37%

c3) Procedurat për administrimin e materialeve të votimit

Në pak raste, komisionerët nuk i zbatuan me përpikmëri të gjitha hapat e procedurës së mbylljes së Qendrave të Votimit. Në 0.8% të Qendrave të Votimit, kutitë e materialeve zgjedhore nuk u mbyllën me kodin e sigurisë nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të komisionit; në 0.8% nuk u numëruan nënshkrimet në Listën e Zgjedhësve; në 1.5% nuk u numëruan fletët e votimit të papërdorura dhe në dy qendra votimi nuk u numëruan fletët e votimit të dëmtuara.

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Tabela 67 - A u vulosën kutitë e materialeve zgjedhore me kodin e sigurisë nën vëzhgimin e të gjithë anëtarëve të Komisionit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.22%	0.76%	98.47%	99.98%
B) Jo	0.78%	0.76%	0.02%	1.53%

Tabela 68 - A u numëruan të gjithë nënshkrimet e hedhura në listën e zgjedhësve?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.23%	0.75%	98.49%	99.98%
B) Jo	0.77%	0.75%	0.02%	1.51%

Tabela 69 - A u numëruan fletët e votimit të papërdorura?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.46%	1.06%	97.41%	99.52%
B) Jo	1.54%	1.06%	0.48%	2.59%

Tabela 70 - A u numëruan fletët e votimit të dëmtuara?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.62%	0.53%	99.08%	100.15%
B) Jo	0.38%	0.53%	-0.15%	0.92%

Në 1.5% të Qendrave të Votimit, jo të gjithë komisionerët ishin dakord me rezultatin e numërimit. Ndërsa në 0.97% të Qendrave të Votimit, jo të gjithë rezultatet dhe vendimet e marra nga Komisioni i Qendrës së Votimit u pasqyruan në "Procesverbalin e mbylljes së qendrës së votimit".

Tabela 71 - A ishin dakord të gjithë anëtarët e komisionit për rezultatet e numërimeve?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.46%	1.06%	97.40%	99.52%
B) Jo	1.54%	1.06%	0.48%	2.60%

Tabela 72 - A u pasqyruan në proces verbal të gjithë rezultatet dhe vendimet e marra?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.03%	0.84%	98.19%	99.88%
B) Jo	0.97%	0.84%	0.12%	1.81%

Zarfet me materialet zgjedhore u vulosën në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit në të gjitha qendrat e votimit.

Tabela 73 - A u mbyllën dhe vulosën zarfet me materialet përkatëse në prani të gjithë anëtarëve të Komisionit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	100.00%	0.00%	100.00%	100.00%
B) Jo	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%

Lidhur me pajisjen ose jo të vëzhguesve me kopje të “Procesverbalit të mbylljes së Qendrës së Votimit”, rezultoi se në 7.3% të Qendrave të Votimit, jo të gjithë vëzhguesit u pajisën me kopje të këtij procesverbali.

Tabela 74 - A morën kopje të Proces Verbalit të Mbylljes së Votimit të gjithë anëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	90.69%	2.53%	88.16%	93.23%
B) Jo	7.33%	2.27%	5.05%	9.60%

c4) Nisja e materialeve për në KZAZ

Në 1 qendër votimi jo të gjitha materialet zgjedhore që parashikohen në Kodin Zgjedhor u futën në kutinë e materialeve zgjedhore. Konkretisht, materiali që nuk u fut në kutinë e materialeve zgjedhore ishte Regjistri i Posaçëm i Zgjedhësve.

Tabela 75 - A u futën në kutinë e materialeve zgjedhore të gjithë materialet që parashikohen në Kod?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.81%	0.38%	99.42%	100.19%
B) Jo	0.19%	0.38%	-0.19%	0.58%

Në tre qendra votimi, procesverbali me rezultatet e numërimit të fletëve të votimit dhe nënshkrimeve nuk u fut në kutinë e votimit.

Tabela 76 - A u fut në kutinë e votimit proces verbali me rezultatet e numërimit të fletëve të votimit dhe nënshkrimeve?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.42%	0.65%	98.76%	100.07%
B) Jo	0.58%	0.65%	-0.07%	1.24%

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I VËZHGIMIT

Në 1.6% të qendrave të votimit punonjësi i policisë ose furgoni që do të transportonin materialet drejt vendit të numërimit të votave u paraqit me vonesë, ndërkohë që në një qendër votimi materialet nuk u shoqëruan drejt vendit të numërimit të votave nga të gjithë personat që e kishin detyrim ligjor.

Tabela 77 - A u paraqit në kohë punonjësi i policisë dhe furgoni që do të transportonte materialet?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	98.45%	1.07%	97.38%	99.51%
B) Jo	1.55%	1.07%	0.49%	2.62%

Tabela 78 - A u shoqëruan materialet drejt VNV-së nga Kryetari, sekretari i Qendrës dhe punonjësi i policisë?

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Po	99.81%	0.38%	99.43%	100.18%
B) Jo	0.19%	0.38%	-0.18%	0.57%

c5) Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të mbylljes së qendrave të votimit

Në fund të procesit të vëzhgimit, vëzhguesit vlerësuan procesin në përgjithësi.

Në 76.3% të Qendrave të Votimit, vëzhguesit i vlerësuan procedurat e mbylljes si “shumë të mira”, në 22.5% si “të mira” dhe në 1% si “problematike”. Në një Qendër Votimi, procedurat e mbylljes u vlerësuan si “shumë problematike”.

Tabela 79 - Vlerësim i përgjithshëm i procedurave të mbylljes së Qendrës së Votimit

	Vlera e vërejtur	Marzhi i Gabimit	Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
A) Shumë mirë	76.30%	3.66%	72.64%	79.96%
B) Mirë	22.54%	3.60%	18.95%	26.14%
C) Me probleme	0.96%	0.84%	0.12%	1.80%
D) Shumë problematike	0.19%	0.38%	-0.18%	0.57%

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 25 qershor
2017 : raporti përfundimtar i vëzhgimit : nëntor
2016-korrik 2017 / Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë
. - Tiranë : KRIIK Albania, 2017
... f. . ; ... cm.

ISBN 978-99927-868-3-3

1.Zgjedhje 2.Raporte 3.Shqipëri

324(496.5) "2017" (047)